DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INSTITUCIONEVE QENDRORE

RAPORTI PËRFUNDIMTAR MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AKTIVITETIN E AUTERITETIT RRUGOR SHQIPTAR

Objekti: "Auditim i përputhshmërisë".
Subjekti: Autoriteti Rrugor Shqiptar.
Përgatitur nga data 01.8.2017 deri më 8.8.2017
Auditimi është kryer në bazë të programit të auditimit nr. 1,192/2, datë 14.3.2017, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Auditimi ka filluar më 15.3.2017
Auditimi ka përfunduar më 31.5.2017

Tiranë, Gusht 2017

PËRMBAJTJA	Faqe
Hyrje	3- 6
Rezultatet e auditimit:	6-95
1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm. *2. Mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit.* *3. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.* *4. Prokurimi i fondeve publike.* *5. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar e kontrollit dhe vlerësimi i auditit të brendshëm.*	6-9 9-14 14-25 25-87 87-89
Gjetjet nga auditimi dhe rekomandimet.	89-95
Tabela e Shkurtimeve**.**	96

Hyrje

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi përputhshmërinë e aktivitetit të Autoritetit Rrugor Shqiptar (këtu e në vazhdim ARRSH) Tiranë, duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore, në menaxhimin financiar dhe kontrollin, në hartimin dhe zbatimin e buxhetit, në miratimin e respektimin e strukturës organike dhe të nivelit të pagave sipas klasifikimit të funksioneve, në organizimin

dhe mbajtjen e kontabilitetit, në administrimin e vlerave materiale e monetare, në prokurimin e fondeve publike etj.

Qëllimi i auditimit

Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që ARRSH u ka bërë fondeve të çelura, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së tij dhe planeve strategjike të miratuara nga strukturat përkatëse. Auditimi jonë ka për qëllim ***promovimin e transparencës*** duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse jane administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi; ***promovimin e përgjegjshmërisë*** ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.
Gjithashtu auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë. *(sipas ISSAI 400, p 18).*

Subjekti i audituar

Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH) u krijua me Ligjin Nr.10164, date 15/10/2009, "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar".
Misioni i ARRSH është organizimi, zhvillimi, shfrytezimi mirembajtja, riveshja dhe realizimi i programit te investimeve ne rrjetin rrugor kombëtar në përputhje me përcaktimet e Kodit Rrugor dhe Ligjit "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar". Për vitin 2016, fondet publike të alokuara për Autoritetin Rrugor Shqiptar ishin në masën 9,040,869 mijë lekë.

Qëllimi i këtij auditimi nga ana e KLSH, është sigurimi se aktiviteti i ARRSH është kryer në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore nga të cilat rregullohet aktiviteti i tij, me fokus përdorimin me eficencë të fondeve publike të alokuara për këtë qëllim.

Kriteret e vlerësimit

Qasja e punës audituese në Autoritetin Rrugor Shqiptar, u orientua bazuar në:
- Nenet 162-163 të Kushtetutës së Shqipërisë ku përcaktohet se: Neni 162 : Kontrolli i Larte i Shtetit eshte institucioni me i larte ekonomik financiar .
- Neni 163: Kontrolli i Larte i Shtetit kontrollon:

a) veprimtarinë ekonomike të institucioneve shteterore e të personave të tjerë juridike shtetërore;
b) përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe atij vendor;
c) veprimtarinë ekonomike të personave juridike, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve ose të aksioneve, ose kur huat, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti;

- **Ligjin 154/2014, "Per organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"**, neni 3, pika 5, percakton se: *"Auditim i përputhshmërisë" nënkupton dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregullorëve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord,* ndërsa neni 12 thekson se:

"Ne auditimet e përputhshmërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit duhet të përcaktojë:

a) nëse të ardhurat dhe shpenzimet kanë qenë në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet parkatase ligjore e nanligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
b) nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik".
*Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.*07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar; Ligji nr. 160/2014, datë 27.11.2014 "*Për buxhetin e vitit 2015*", i ndryshuar; Ligji nr. 147/2015, datë 17.12.2016 "*Për buxhetin e vitit 2016*", me ndryshime; Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",* ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006; Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 "*Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar; Ligji nr. 10383, datë 24.02.2011 *"Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 "*Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik"*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28.06.2006 "*Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore*"; VKM nr. 545, datë 11.08.2011 *"Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit",* i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 717, datë 23.06.2009 "*Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", me ndryshime.*
Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 8, datë 29.03.2012 "*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm*", si dhe udhëzimet vjetore të hartimit të buxhetit.
Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012 "*Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit*", i ndryshuar, si dhe udhëzimet vjetore për zbatimin e buxhetit; UMF nr. 7, datë 11.02.2015 "*Për procedurat standarde të përcaktimit dhe zbatimit të limiteve të angazhimit"*; nr. 1, datë 04.06.2014, "*Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit"*, etj.
Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 *"Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, vendore dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj, etj",* ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007 dhe nr. 10, datë 27.02.2008, etj.
- ISSAI 100 – (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik)*
- ISSAI 400 (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë)*

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200[1]) e shpenzimeve:
Nga auditimi mbi përputhshmërinë, sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti – Autoriteti Rrugor Shqiptar, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo

termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime materiale në:
1.Në fushën e prokurimeve publike u konstatua dëm ekonomik në vlerën **202,536,373 lekë** gjithsej, nga i cili: **i arkëtueshëm 58,227,347 lekë,** për të cilin kërkohet të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

2.Dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi në vlerën **144,309,026 lekë.** Ky dëm është evidentuar në procedurën e tenderit me objekt "*Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" "Shtesë kontrate"* me fond limit 173,498,482 lekë, i zhvilluar në vitin 2016 , për të cilin është lidhur shtesë kontrate nr. 7244, datë 14.9.2016 me Bashikim e Operatorëve Ekonomikë (BOE) "Rosi" spa Albania & "Everest" sh.p.k.

3. Shpenzime pa efektivitet me vlerë 106,409 mijë lekë në procedurën e tenderit me objekt "Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e korridorit Veri Jug dhe lidhja me qytetin" (shërbim konsulence), i zhvilluar në vitin 2016.

Veç sa më sipër, në procedurën e zhvillimit të tenderit me objekt *"Implementimi i sistemit të menaxhimit të trafikut",* me fond limit rreth 53,667 mijë lekë u konstatuan parregullsi, mos përputhshmëri ligjore kryesisht në vendosjen e kritereve të veçanta të kualifikimit, të cilat në tërësi kanë ndikuar negativisht në *nxitjen e konkurrencës, rritjen e eficencës dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik etj.*

Konkluzion:
Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Autoriteti Rrugor Shqiptar rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë **dhënien e një opinioni të modifikuar dhe me siguri të arsyeshme.**

1.ISSAI 4100 – *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.*

2.ISSAI 4200 - *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.*
3. Mbeshtetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

Rezultatet e auditimit.

1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit të mëparshëm të ushtruar nga KLSH.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve u krye në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit*" dhe të Udhëzimit të Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016, *"Mbi procedurat që duhen të ndiqen në lidhje me ndjekjen e zbatimit të masave të rekomanduara dhe dokumentacion që hartohet në auditimin e verifikimit të zbatimit rekomandimeve të KLSH*".

Nga auditimi i ushtruar në *Autoritetin Rrugor Shqiptar*, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, dërguar me shkresën nr. 1115/71, datë 23.01.2017, konstatohet se:
Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se, janë rekomanduar gjithsej:

*a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **3 masa organizative**, të cilat janë pranuar plotësisht **3**, nga të pranuarat është zbatuar 1, janë në proces **2 rekomandime**.*
*b. Për **shpërblim dëmi** janë lënë **5 rekomandime**, nga të cilat janë pranuar plotësisht **5,** nga të pranuarat **1** është zbatuar plotësisht, **2** janë në proces dhe 2 të pa zbatuar.*

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon

A. MASA ORGANIZATIVE

Rekomandimi 5.

Marrjen e masave për të pasqyruar në kontabilitet dhe në bilancin kontabël përmbledhës të vitit 2015 gjatësinë e akseve rrugore konform përcaktimeve të "*Kodit Rrugor*" në një *data base* të hollësishëm gjatësinë dhe vlerën respektive të çdo aksi rrugor, me qëllim që ARRSH të disponojë të dhëna për koston e 1 km rrugë sipas kategorive të mësipërme. Këto të dhëna duhet të konsiderohen jo vetëm si tregues i rëndësishëm për programimi e shpenzimeve të institucionit, por lidhen edhe me për përmbushjen e objektivit të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 "*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", përgjegjësitë menaxheriale dhe të strukturave administrative për planifikimin, zbatimin, kontrollin e shpenzimeve të fondeve publike për hartimin e projektit, preventivit dhe të fondit limit për projektime, ndërtime apo sistemim të akseve rrugore.

Menjëherë

Përgjigja e subjektit
Në zbatim të rekomandimit të KLSH dhe Urdhrit t e Ministrit Nr. 3056, datë 28.07.2016 "Për identifikimin dhe kategorizimin e rrugëve kombëtare është ngritur grupi i punës i cili po bën përpunimin përfundimtar të të dhënave mbi saktësinë e inventarit kilometrik në m2 dhe përpilimin e të dhënave në sistemin ËEB-GIS.

Komenti i KLSH
Në lidhje me këtë pikë u krye edhe shqyrtimi i dokumentacionit përkatës në mbështetje të cilësimit të rekomandimit si i pranuar dhe në proces.

Rekomandimi 6.

Marrjen e masave për miratimin e inventarit të akseve rrugore nga MTI, me qëllim mbylljen e llogarive 202 dhe 231 në shumën prej 206,814,512 mijë lekë dhe debitimin e AQT-ve të përfunduara dhe të kolauduara në llogarinë 213, "*Rrugë dhe rrjete rrugore*".

Menjëherë

Përgjigja e subjektit
Nuk ka përfunduar inventarizimi i rrugëve të përfunduara dhe të marra në sasi km/m2 dhe në vlerë.

Komenti i KLSH
Ky rekomandim konsiderohet i pa zbatuar.

Rekomandimi 14.
Të ketë një praktikë të kujdesshme në ndjekjen dhe likuidimin e shpenzimeve të shpronësimit, të zbatohet parimi FIFO në pagimin e tyre dhe të monitorohen proceset gjyqësore duke nxjerrë gjithmonë përgjegjësi individuale për sa është lejuar kalimi i çështjeve në gjykatë, fakt që krijon kosto shtesë të panevojshme. Rastet e vendimmarrjeve të gabuara të gjykatës të ndiqen deri në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, duke qenë ruajtës të financave publike deri në fund.

Menjëherë dhe në vijimësi

Përgjigjja e subjektit
Drejtoria e ZHPHBSH dhe Drejtoria Juridike janë duke e zbatuar vazhdimisht një praktikë të kujdesshme në ndjekjen dhe likuidimin e shpenzimeve të shpronësimit.

Komenti i KLSH
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, në proces.

C. *Masa shpërblim dëmi*.
Rekomandimi 1.
Të kërkohet shpërblimi i dëmit të konstatuar nga auditimi i kryer pas prokurimit me objekt *"Supervizim dhe auditim për verifikimin e cilësisë së punimeve të objekteve të rrugëve",* nga shoqëritë sipërmarrëse, për vlerën e plotë të detyrimeve të rezultuara, kolauduar dhe marrë në dorëzim në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, date 05.09.1994, i ndryshuar "*Për kolaudimin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*". Të ndiqen të gjithë hapat ligjorë, administrativë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurës administrative*" pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe Kodin Civil, neni 640. Detyrimi në vlerën 495,500,480 lekë, të mbahet nga detyrimet që mund të ketë ARRSH ndaj operatorëve të cilët kanë përfituar nga vëllimi i punimeve të raportuara.
ARRSH të ndjekë procedurat për të siguruar shpërblimin e dëmit të shkaktuar **93,999,102**lekë për subjektet.

1. "CCC" për vlerën 50,149,236 lekë.
2. "*TTT*" për vlerën 35,278,897 lekë.
3. "*TTT*" në vlerën 1,142,099 lekë.
4. "*AAA*" për vlerën 5,895,131 lekë.
5. "*TTT*" për vlerën 1,533,739 lekë.

Menjëherë

Përgjigja e subjektit
Drejtoria juridike ka hapur padi në gjykatën e shkallës së parë Tiranë, për shpërblim dëmi në datën 24.04.2017.

Komenti i KLSH
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, në proces, megjithëse në tejkalim të afatit të përcaktuar në rekomandimin fillestar.

Rekomandimi.
Të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën prej **7,159,032 lekë**, për sa përfituar padrejtësisht nga shoqëritë sipërmarrëse të mëposhtme:
a. Shoqëria "EEE" në vlerën prej 720,000 lekë;

b. Shoqëria "*GGG*" në vlerën prej 5,939,032 lekë;
c. Shoqëria "*GKK*" në vlerën prej 500,000 lekë.
Të ndiqen të gjithë hapat ligjorë, administrativë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurës administrative*" pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe Kodin Civil, neni 640. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqen në vijimësi.

Përgjigja e subjektit
Drejtoria juridike për subjektin "EEE" dhe "*GKK*" janë subjekte në proces gjyqësor.

Komenti i KLSH
Ky rekomandim konsiderohet i pranuar, në proces.

Menjëherë

Rekomandimi 4.
Të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën e paargumentuar nga grupi për hartimin e termave të referencës EN, EE dhe SE, për llogaritjen e fondit limit më tepër, pasi në preventiv janë parashikuar zëra që tejkalojnë afatin ligjor të kryerjes së shërbimit të vendosur në DST (*termat e referencës*) për tenderin me objekt "*Supervizim dhe auditim për verifikimin e cilësisë së punimeve të objekteve të rrugëve"*, duke sjellë si pasojë rritjen artificiale të tij. Nga llogaritjet e grupit të auditimit vlera minimale e shtuar arrin në **1,120,000 lekë**. Të ndiqen të gjithë hapat ligjorë, administrativë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurës administrative*" pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe Kodin Civil, neni 640. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi.

Menjëherë

Rekomandimi 5.
Të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën **2,728,166 lekë**, nga hartuesit e fondit limit respektivisht; SE, D.D. A.A. Të ndiqen të gjithë hapat ligjorë, administrativë, bazuar në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "*Kodi i Procedurës administrative*" pjesa V, Kreu IV, nenet 105-109 dhe Kodin Civil, neni 640. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi.

Menjëherë

Koment i KLSH
Në lidhje me këtë rekomandim informacioni i ARRSH nuk është i qartë dhe as i dokumentuar, konsiderohet i pa zbatuar.

Rekomandimi 6.
Të kërkohet shpërblimi i dëmit në vlerën **4,050,000 lekë**, respektivisht nga Z.Z. Të paraqitet ky detyrim në kontabilitet dhe të ndiqet në vijimësi, arkëtimi i vlerës së mësipërme.

Menjëherë

Përgjigja e subjektit
Është ndalur tatimi në burim i pa mbajtur për 9 vjet në vlerën 4.050.000 lekë si edhe vlera 984.375 lekë mbi shumën e detyrimit sipas dispozitivit të titullit ekzekutiv. Vlera totale prej 5.034.375 lekë është xhiruar në sektorin e tatimeve të tjera.

Komenti i KLSH
Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar.

2. Mbi hartimin dhe zbatimin e planit të buxhetit të shtetit në përputhje le ligjin organik të buxhetit.

Programimi dhe Realizimi i Buxhetit në Autoritetit Rrugor Shqiptar ka qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e rrjetit rrugor kombëtar, të korridoreve rrugore, të rrugëve me destinacione kufitare dhe turistike, përmirësimin e mirëmbajtjes dhe të sigurisë së qarkullimit rrugor, me synim arritjen e standardeve bashkohore. Për realizimin e këtyre objektivave ARrSH programon dhe detajon fonde publike dhe financime të huaja sipas programit për çdo projekt të infrastrukturës rrugore, nëpërmjet procedurave për administrimin e fondeve buxhetore të akorduara, përdorimin e fondeve sipas legjislacionit në fuqi dhe kontrollin e vazhdueshëm për përdorimin me efektivitet të tyre.

Për realizimin e këtij auditimi ka shërbyer si bazë vlerësimi:
Neni 11, i Ligjit nr.10164, datë 5.10.2009 " Për Autoritetin Rrugor Shqiptar ", ku përcaktohet se Bordi i ARRSH, miraton programet e brendshme vjetore dhe të buxhetit të ARRSH.
Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
Ligjit Nr. 147, datë 17.12.2015 "Për Buxhetin e vitit 2016".
Udhëzimit Nr. 2, datë 06.02.2012, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave nr 1, datë 15.01.2016 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016".
Akti Normativ Nr.2, 16.12.2016, "Për disa ndryshime në Ligjin 147/2015 "Për buxhetin e vitit 2016", i ndryshuar etj.

Mbi kontrollin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit të shtetit.
- Projekt-Buxheti Afatmesëm vitit 2014-2016.
Për vitet 2014 dhe 2016, ARRSH, ka hartuar PBA-në konform udhëzimeve për hartimin e buxhetit. Hartimi i kërkesave buxhetore kryhet mbështetur në Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) i cili është dokumenti bazë për planifikimin e shpenzimeve buxhetore. Kjo deklaratë, është hartuar mbështetur në dokumenta si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, Strategjia Sektoriale të Rrugëve, rekomandime të dhëna nga ekspertë të huaj gjatë zhvillimit të projekteve të ndryshme në "Transportin Rrugor", si dhe standarde të ndërtuara nga vetë institucioni, mbështetur në eksperiencën disa vjeçare të aktivitetit të tij. Në këtë dokument, përcaktohet politika, qëllimi që synohet të arrihet, objektivat afatmesme dhe afatshkurtra në funksion të arritjes së këtij qëllimi si edhe standardet mbi të cilat do të mbështeten këto objektiva. Objektivat e përcaktuara në projekt buxhet janë detajuar në produkte të veçanta, duke synuar realizimin e tyre në funksion të arritjes se objektivave.
Ky proces udhëhiqet nga Grupi për Buxhet Strategji dhe Integrim (GSBI), ose Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), i ngritur me urdhrin nr.39, datë 28.03.2012 të ish Titullarit të MPPT "Për krijimin e ekipeve të menaxhimit të programeve për përgatitjen e PBA-së".
Ky projekt buxhet, është hartuar për periudhën 2014-2016, proces i cili është realizuar në dy faza: në muajin Maj dhe muajin Gusht. Projekt-buxheti i paraqitur nga ARSH, u analizua nga specialistët e MPPT, anëtarë të EMP (Ekipi i Menaxhimit të Programit) dhe pas miratimit hap pas hapi nga GMS (Grupi për Menaxhimin Strategjik), dokumenti përfundimtar i kërkesave buxhetore për Transportin Rrugor PBA u paraqit në Ministrinë e Financave, brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave për përmbylljen e fazës së parë të këtij procesi.
Faza e parë e hartimit të PBA përfundoi në muajin prill 2014, e cila është paraqitur në ministri me shkresën nr. 2225, datë 24.04.2014. Hartimi i PBA është përfunduar me fazën e dytë në

muajin Gusht, sipas përcaktimeve në aktet ligjore e nënligjore në këtë drejtim dhe PBA është dërguar në MTI me shkresën nr. 5823, datë 29.08.2014 për periudhën 2015-2017, në të cilën janë parashikuar shpenzimet sipas grupeve dhe nëngrupeve.

Nga auditimi i zbatimit të Buxhetit për vitin 2016 për objektet e reja të parashikuara në Buxhetin 2016 paraqiten të detajuara si më poshtë:

1- Ndërtim rruga by Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë Loti 10 (shtesë punimesh),
Buxheti në fund të vitit 2016 ishte 25,100,000 lekë
Financimi në fund të vitit 2016 ishte 25,100,000 lekë.

2- Rikonstruksion i rrugës Shkodër(mbikalimi i trenit)- Mes (shtesë punimesh)
Buxheti në fund të vitit 2016 ishte 70,952,196 lekë
Financimi në fund të vitit 2016 ishte 70,952,196 lekë.

3- Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, km 4 deri 21.
Buxheti në fund të vitit 2016 ishte 100,000 lekë
Financimi në fund të vitit 2016 ishte 0 lekë.

4- Riveshje Sistemim Asfaltimi Rruga Elbasan-Banjë, Loti 1 (shtesë kontrate).
Buxheti në fund të vitit 2016 ishte 2,700,000 lekë
Financimi në fund të vitit 2016 ishte 2,700,000 lekë.

5- Riveshje Sistemim Asfaltimi Rruga Elbasan-Banjë, Loti 3 (shtesë punimesh)
Buxheti nëfund të vitit 2016 ishte 2,700,000 lekë
Financimi në fund të vitit 2016 ishte 2,700,000 lekë.

6- Supervizor Punimesh Pjesa e mbetur e punimeve në segmentin Lin-Pogradec, km 4 deri 21.
Buxheti në fund të vitit 2016 ishte 50,000 lekë
Financimi në fund të vitit 2016 ishte 0 lekë.

7- Supervizion Punimesh Ndërtim rruga by Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë Loti 10 (shtesë punimesh).
Buxheti në fund të vitit 2016 ishte 10,000 lekë
Financimi në fund të vitit 2016 ishte 0 lekë.

Burimi i të dhënave: ARSH.

Nga auditimi i ushtruar për respektimin e afateve të dorëzimit të projekt-buxhetit në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit rezultoi se kërkesat për buxhet për vitet 2014-2015, së bashku me programet buxhetore afatmesme, janë dërguar në këtë Institucion, brenda afatit të përcaktuar nga kjo Ministri. Autoriteti Rrugor Shqiptar, në mbështetje të projekteve me burime financimi të huaja, në kërkesat për buxhet ka parashikuar dhe fondet për Kosto Lokale e TVSH. Kërkesat buxhetore për periudhën 2016 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në 000 lekë

Emërtimi	2016		
	Limiti (tavanet PBA faza II 2015)	Kërkesa	Çelje nga buxheti

Shpenzime personeli	107,400	125,140	110,462
Sigurime shoqërore	15.590	20,830	18,237
Shpenzime operative dhe Transferta për buxhetet Familjare dhe individët	1.469.170	2,582,700	1,802,551
Investime (230 + 231)	5,752,650	**5.752.650** Detajuar PBA sipas tavaneve **13,000,913** paraqitur ne kerkesat shtese per vitin 2016 **(shuma 18,753,563)**	3,752,650
Investime e huaja	15,400,00		8,782,000
Totali			

Burimi i të dhënave: ARSH.

Për vitin 2016

Autoriteti Rrugor Shqiptar, ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore, sipas programit të miratuar, **nr**. *04520, me emërtesë programi "Transporti Rrugor".*

Me Ligjit Nr. 147, datë 17.12.2015 "Për Buxhetin e vitit 2016" dhe shkresën e Ministrisë së Financave nr. 3092/1 datë 03.03.2016 është miratuar buxheti për Transportin Rrugor për vitin 2016, në vlerë 3.752.650.000 lekë.

Buxheti i miratuar për Transportin Rrugor për vitin 2016 së bashku me kërkesat paraqitet si më poshtë:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2016	Buxheti i miratuar për vitin 2016 në fund të 2016	Realizimi	Në %
1	Shpenzime personeli	107,400	110,462	110,074	99.6 %
2	Sigurime Shoqërore	15,590	19,007	18,238	96 %
2	Mallra dhe shërbime	1,469,170	1,802,551	1,786,248	99 %
3	Investimet kapitale	3,752,650	9,040,869	8,946,365	99 %
	Transferime				
4	**Totali i Buxhetit të Shtetit**				
5	Investimi huaj	8,782,000	4,716,731	-	
	TOTALI				

Burimi i të dhënave: ARSH.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të ARRSH-së, programimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2016 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Fatura të papaguara ne fund të 2016	%
1	Paga	70,285	70,282	0	99.9 %
2	Sigurime shoqërore	12,200	11,612	0	95 %
3	Shpenzime operative	595,060	594,600	607,642	99.9 %
4	Punime civile	6,337,024	6,297,195	1,272,833	99.4 %

5	Kosto Lokale	490,666	468,445	314,029	95.5%
6	TVSH	846,702	816,582	32,103	96.4%
7	Studime projektime	730,998	729,871	148,945	99.8%
8	Fondi i ndihmës				
	Totali				

Burimi i të dhënave: ARSH..

Programi nr. 04520 me emërtimin "Transporti Rrugor" për zërin investime viti 2016

Në 000/lekë

Artikulli Kodi	**Emri**	**Buxheti Plan 2016 Fillim të vitit**	**Buxheti i rishikuar Plan 2016**	**Fakti Plan 2016**	**Diferenca Plan 2016**
230	**Kapitale të Patrupëzuara**				
	(Studim projektime)	300,000	730,998	729,871	1,127
231	**Kapitale të Trupëzuara në total**				
	Ndërtime rrugësh	455,596	3,089,603	3,063,137	26,466
	Sistemim asfaltime	409,912	2,284,978	2,284,834	144
	Rrëshqitje	67,119	220,139	208,516	11,623
	Ndërtim urash	4,257	3,288	3,288	0
	Sinjalistika Rrugore	140,000	681,187	681,186	1
	Garanci objektesh	700	0	0	0
	Vendime gjyqësore	40,000	318,957	318,957	0
	Leje mjedisore	0	0	0	0
	Shpronësime	90,000	255,428	254,222	1,205
	Supervision	24,066	57,828	56,235	1,593
	Kosto Lokale	200,000	490,666	468,445	22,221
	TVSH	2,000,000	846,702	816,582	30,120
Totali	**TOTALI I INVESTIMEVE**				

Burimi i të dhënave: ARSH.

Nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme, si dhe nga konfirmimet e marra nga degët e thesarit, shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm) të këtij programi, u realizuan në masën 8,946,365,000 lekë, ose e shprehur në përqindje 99 % e planit të buxhetit të vitit 2016.
Për vitin 2016 fondet e planifikuara janë 9,040,869,000 lekë dhe kanë ngelur pa u financuar 94,504,000 mijë lekë.

Në terma të përqindjes kjo vlerë monetare e pashpenzuar, 1% nga buxheti total nuk është e konsiderueshme, por e trajtuar në vlerë monetare është e konsiderueshme për buxhetin e shtetit dhe për përdorimin e kësaj vlere në entitete të tjera apo në zëra të tjerë shpenzues brenda ARRSH.
Rekomandojmë që planifikimi të jetë më realist, në suport të një alokimi më eficiënt të Buxhetit të Shtetit në tërësi.

Nga të dhënat e Formatit 8 dhe 9 "Raporti i realizimit të produkteve dhe i shpenzimeve faktike të programit sipas produkteve" rezulton se:

Grupi i produktit "Ndërtim Rruge" i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2016 është realizuar ndaj planit vjetor përkatësisht 96 % (ose 5,68 km) dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 99 % ose 4,302,937,000 lekë.

Për zërin "Ndërtim rruge" është akorduar fond për kontratat në vazhdim.
Grupi i produktit "Rikonstruksion Rruge" i shprehur në sasi (km) për 12 mujorin e vitit 2016 është realizuar rreth 100 % ndaj planit vjetor të vitit 2016 (ose 28.94 km), dhe i shpenzimeve faktike për këtë produkt 100 % ose 2,720,841,000 lekë.
Shpenzimet e këtij grupi janë planifikuar për financimin e rrugëve Tip C2 me dy korsi.
Produktet e shprehur në terma sasiorë (km) sipas tipeve për rikonstruksionin e rrugëve (tip C2 & B' me dy korsi dhe A2' 2x2 me trotuare dhe ndriçim), janë planifikuar për 12 mujorin e vitit 2016.

Grupi i shpenzimeve për Shpronësime dhe Vendime gjyqësore, garanci objekti, leje mjedisore dhe ura, të tjera i detajuar paraqiten si më poshtë:

	Planifikuar	**Realizuar**	**%**
Ura	3,288,095	3,288,095	100
Vendime Gjyqësore	318,957,484	318,957,484	100
Shpronësime	255,428,217	254,222,826	99.5
Implementimi I sistemit të menaxhimit të trafikut	39,373,800	39,373,800	100
Instalimi I ËEB-GIS	19,400,000	19,400,000	100
Blerje pajisje kompjuterike	2,318,432	2,318,432	100
Shpenzime kapitale për TVSH dhe kosto lokale	1,337,368,650	1,285,026,531	96

Financimi i Huaj
Buxheti i financimit të huaj për vitin 2016 është 4,716,731,000 lekë. Në 12 mujorin e vitit 2016 ky buxhet është financuar në vlerën 3,295,794,000 lekë ose 69.8 % e planit.
Në sasi në zërin ndërtim rrugësh janë planifikuar 27.83 km dhe janë realizuar 13.69 km ose 49.2 % të planit total të çelur të këtij zëri.
Më poshtë po rendisim komentet tona mbi realizimin e produkteve dhe të shpenzimeve të tyre për 12-mujorin e vitit 2016:

- Ndërtim Rruge Tip A
Për tipin e rrugës A janë planifikuar fonde të huaja në vlerën 1,473,548,000 lekë dhe në sasi 1.05 km. Realizimi i shenzimeve për tipin e rrugës A është 1,748,897,000 lekë.
Në sasi jane realizuar 1.05 km ose 93.1 % të planit total të celur të këtij tipi rruge.
- Ndërtim Rruge Tip B
Për tipin e rrugës B janë planifikuar fonde në vlerën 2,928,210,000 lekë dhe në sasi 1.36 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës A është 1,425,004,000 lekë.
Në sasi jane realizuar 9.38 km ose 45.7 % të planit total të celur të këtij tipi rruge.
- Ndërtim Rruge Tip C

Për tipin e rrugës C janë planifikuar fonde në vlerën 273,215,000 lekë dhe në sasi 1.36 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës A është 63,817,000 lekë.
Në sasi jane realizuar 0.61 km ose 20.0 % të planit total të celur të këtij tipi rruge.
Ndërtim Rruge Tip Kategori të Ndryshme
Për tipin e rrugës Kategori të Ndryshme janë planifikuar fonde në vlerën 41,758,000 lekë dhe në sasi 1.36 km. Realizimi i shpenzimeve për tipin e rrugës A është 58,075,000 lekë.
Në sasi jane realizuar 0.30 km ose 48.3 % të planit total të celur të këtyre kontratave rruge.

Detyrimet e prapambetura deri më 31.12.2016

Në lekë

Zërat e shpenzimeve	Art.	Shuma e pa paguar deri më 31.12.2016	Shuma e faturës së deklaruar
Investime të brendshme	231	1,272,833,214	1,272,833,214
Studim projektime	230	148,945,132	148,945,132
Shpronësime	231	315,778,521	315,778,521
Vendime gjyqësore	231	282,790,401	282,790,401
Tvsh dhe kosto lokale	231	346,132,574	346,132,574
Totali		**2,366,478,842**	**2,366,478,842**

Burimi i të dhënave: ARRSH.

Vlerësojmë me rëndësi që pojektbuxhetet afatmesme dhe vjetore duhet të hartohen konform kërkesave të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", duke mbajtur në vëmendje që realizimi në raport me planifikimin të jenë sa më afër realizimit në masën 100%.
Duke marrë në konsideratë mos realizimin e buxhetit të ARRSH për vitin 2016 në vlerën 1% që në pamje të parë duket e pakonsiderueshme por e trajtuar si vlerë monetare për Buxhetin e Shtetit merr tjetër rëndësi; mund të realizohej përdorimi i kësaj vlere në entitete të tjera apo edhe në zëra të tjerë shpenzues brenda ARRSH.
Rekomandojmë që planifikimi të jetë më realist, në suport të një alokimi më eficiënt të Buxhetit të Shtetit në tërësi.

3. Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit.

3.1. Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, bankës në lekë dhe veprimeve në valutë për periudhën objekt auditimi.
3.2. Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.
3.3. Mbi administrimin e pronës shtetërore, zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen,dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

- *Inventarizimi i pronës shtetërore.*

Inventarizimit të aktiveve në ARRSH, për vitin 2016, është kryer në zbatim të urdhrit të titullarit të ARrSH nr.10601, datë 23.12.2016, sipas të cilit është ngritur komisioni për inventarizimin fizik të aktiveve, në zbatim të nenit 12, pika 2 b dhe nenit 15/ pika 4 të Ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 73, 74 dhe pika 81, si dhe të nenit 7 (Inventari i aktiveve dhe detyrimeve) të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", me ndryshimet.
Komision përbëhet nga:

1-Reshit Kuqi, kryetar
2-Daniela Thomollari, anëtare
3-Vilma Papa, anëtare
4-Tauta Pasku, anëtarë
5-Vitjola Tona, anëtare

Në përfundim të inventarizimit komisioni ka hartuar relacionin mbi përfundimin e inventarizimit, ku është konstatuar, gjendja e paraqitur në tabelën në vazhdim:

Në lekë

Nr	Emërtimi i aktiveve	Viti 2016	Viti 2015
1.	**Ndërtesa**	**34,520,916**	**34,520,916**
2.	**Automjete**	**144,177,897**	**149,584,080**
2.1	-Automjete në përdorim	13,803,850	
2.2	-Automjete në ruajtje	88,479,897	
2.3	-Automjete për t'u shitur në ankand	13,394,804	
2.4	-Automjete shitje për skrap	21,447,227	
2.5	-Automjete në ruajtje	7,052,119	
3	**Inventari ekonomik**	**239,536,609**	**235,891,024**
4	**Inventari i imët**	**4,773,420**	**2,304,350**
5	**Materiale**	**2,474,164**	**3,118,105**
	S H U M A	**425,483,006**	**425,418,475**

Nga verifikimi i kryer në dokumentacionin e administruar për kryerjen e inventarëve u konstatua se, komisioni për kryerjen e inventarëve ka vepruar konform Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, në germën "a" dhe "c", pika 85. Në përfundim të rezultatit të inventarëve nuk janë konstatuar diferenca. Nga verifikimi i kryer në llogarinë 218 "Inventari ekonomik", konstatohet se, në fletën e inventarit me numër rendor 34, në llogarinë aktive janë fizikisht një"Fabrikë prodhim asfalti" në vlerën prej 69,820,000 lekë, nr. rendor 202, është gjendje një vinç cjap" "me vlerë 5,585,600 lekë, nr. rendor 81 "dy mjete asfaltshtrues" me vlerë 16,756,800 lekë, për të cilat nuk ka asnjë të dhënë në se janë në gjendje pune apo jashtë përdorimit.
Në llogarinë 215, sipas fletës së inventarit janë në përdorim dhe gjendje të mirë teknike 5 autovetura me vlerë 13,803 mijë lekë, jashtë përdorimit dhe në ruajtje 14 autovetura me vlerë 93,059 mijë lekë, 8 autovetura të klasifikuara për t'u shitur në ankand me vlerë 21,273 mijë lekë dhe 9 autovetura jashtë përdorimit për t'u shitur në formë skrapi me vlerë inventari 21,447 mijë lekë. Për këto pajisje të vlerësuara në total në shumën 219,562 mijë lekë, ndonëse në raportin e mëparshëm është rekomanduar marrja e masave për verifikimin e gatishmërisë së tyre por deri më sot nuk është marrë asnjë masë dhe fillimin e procedurave të privatizimit apo shitjes konform dispozitave ligjore nëpërmjet ankandit, apo transferimin kapital në ato institucione publike ku mund të gjejnë përdorim.

3.4. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit

Mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Autoritetin Rrugor Shqiptar për vitin 2016, është bërë në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, VKM nr.248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e

ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998". Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.

Hartimi i Bilancit të Autoritetit Rrugor Shqiptar për vitin 2016 është kryer në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.

Nga verifikimi i llogarive të bilancit rezulton se, llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike dhe me pasqyrat financiare te Aktivit dhe të Pasivit.

Janë bërë rakordimet e situacionit të shpenzimeve me Degën e Thesarit Tiranë dhe rakordimet e të ardhurave të cilat paraqiten në bilanc me vlerën e tyre reale.

Veprimet kontabël janë kryer konform plani kontabël dhe në bazë të Projektit SETS, nga auditimi konstatohet se veprimet në përmjet bankës bankën", "Hyrjet dhe Daljet e magazinës", veprimet lidhur me "Pagat" dhe veprimet lidhur me shpenzimet operative dhe për investime, janë të rregullta. Të gjitha sistemimet dhe mbylljet e llogarive të regjistruara në ditarin e "Veprimeve të ndryshme", janë kryer konform dispozitave ligjore dhe Udhëzimit nr. 2, datë 10.01.2002 të Ministrisë së Financave.

Sipas Bilancit Kontabël të Autoritetit Rrugor Shqiptar, rezulton se llogaritja dhe kontabilizimi i amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara është kryer konform akteve nënligjore në fuqi. Rubrikat dhe postet e bilanceve kontabël të këtij institucioni janë përmbledhur në një të vetëm. Aktivet e Autoritetit Rrugor Shqiptar, sipas zërave paraqiten në tabelën e mëposhtme:

AKTIVI *Në 000/lekë*

LLOGARITË	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2016	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2015
AKTIVE TË QËNDRUESHME	**262,267,051**	**253,558,031**
AKTIVE TË PATRUPËZUARA	4,624,361	3,894,490
Studime dhe kërkime	697,368	697,368
Shpenzime për rritjen e aktiveve	3,926,992	3,197,121
AKTIVE TË TRUPËZUARA	209,278,891	230,730,202
Toka dhe terrene	545,880	545.880
Nga kjo,rrugë dhe vepra rrugore	23,986,789	23,986,789
Shpenzime në proces për rritjen e AQT	232,954,644	224,984,436
AKTIVE QARKULLUESE	**8,052,639**	**4,967,533**
GJENDJA E INVENTARIT	7,428	6,125
LLOGARITË FINANCIARE	2,982,953	1,670,705
MARRËDHËNIE ME SHTETIN	2,981,053	1,670,705
LLOGARI TË TJERA AKTIVE	5,062,256	3,290,522
T O T A L I	**270,319,690**	**258,525,385**

-Llogaria Aktive të Qëndrueshme në datën 31.12.2016 në aktiv të bilancit paraqitet me vlerë 262,267,051 mijë lekë ose me tepër 8,079,020 lekë krahasuar me vitin 2015, shtesë e cila ka ardhur si rrjedhojë e përfundimit dhe kolaudimit të investimeve në rrugë, si dhe i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura nga vitet e kaluara.

-Llogaria 202, "Studime dhe kërkime" me vlerë me vlerë 697,368 mijë lekë, përfaqëson vlerën e mbartur të shpenzimeve për studime projektime të rrugëve të mbartura nga vitet e kaluara.

-Llogaria 210, " Toka, troje dhe terrene" me vlerë 545,880 mijë lekë, përfaqëson vlerën e mbartur nga viti 2006 të shpenzimeve për shpronësime likuiduar pronarëve të trojeve ku është bërë shpronësimi për segmentet rrugore

-Llogaria 230, "Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara" me vlerë 3,926,992 mijë lekë, shtuar gjatë vitit 2016 me vlerën prej 729,871 mijë lekë, përfaqëson studime projektime të mbartura nga vitet e kaluara për segmente të ndryshme ligjore.

Nga verifikimi i kryer në aktivin e bilancit llogaria 213 "Rrugë,rrjete,vepra ujore", konstatohet se në datën 31.12.2016 kjo llogari është pasqyruar në bilanc në vlerën prej 23,986,789 mijë lekë, gjatë vitit 2016, ndonëse kanë përfunduar, janë marrë në dorëzim investime të përfunduara nuk janë kontabilizuar dhe pasqyruar në rritje të aktiveve të trupëzuara, kështu përmendim:
-Llogaria 4342 "marrëdhënie me shtetin debitor" në fund të vitit 2016 paraqitet ne bilanc në shumën 2,981,053 mijë lekë e cila përfaqëson detyrime të lindura gjatë vitit 2016 për paga, sigurime shoqërore dhe tatim mbi të ardhurat si detyrime të prapambetura të muajit dhjetor 2016.
-Llogaria 230 "Studime e projektime" në vlerën prej 697,368 mijë lekë paraqitet në bilanc e pandryshuar si në vitin 2016 ashtu edhe në vitet e mëparshme 2013 dhe 2014. Kjo llogari në kundërshtim me planin kontabël nuk është krediituar sipas objekteve të përfunduara dhe të kolauduara për çdo objekt të marrë në dorëzim në debi të llogarisë aktive të trupëzuara.

Nga auditimi i aktivit të bilancit konstatohet se, nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm në lidhje më rakordimin e llogarive të aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, kështu:
Nuk janë sistemimin e llogaritë 202, 210 dhe 230 që përfaqësojnë vlerën e studime projektimeve, dhe shpronësimeve në shumën gjithsej prej 5,170,248 mijë lekë, e cila duhet të sistemohet në debi të llogarisë 213, po kështu edhe llogaria 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT me vlerë 232,984,644 mijë lekë për vlerën e investimeve të përfunduara dhe të kolauduara duhet të sistemohet në debi të llogarisë 213 " Rrugë, rrjete, vepra ujore ", e cila përfaqëson vlerën e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara të pandryshuar prej viteve të kaluara në shumën prej 23,986,739 mijë lekë.
ARrSH me shkresën nr. 5756, datë 11.02.2014 ka paraqitur në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, evidencën e inventarit kilometrik sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për shtimin dhe pakësimin e akseve rrugore në ngarkim të ARrSH-së, të emërtuara me numra respektivë të çdo aksi rrugor, sipas të cilit gjatësia e përgjithshme e rrugëve është **3,794.35 km**.
Nga të dhënat që disponohen në aktivet e qëndrueshme të ARrSH-së rrugët e ndara sipas programeve dhe produkteve buxhetore dhe klasifikimeve të përcaktuara në nenin 2 të Kodit Rrugor paraqiten sipas kategorive dhe gjatësive të mëposhtme:
B. Rrugë interurbane kryesore gjatësia 233.16 km;
C. Rrugë interurbane dytësore gjatësia 2,882.96 km;
E. Rrugë urbane dytësore me gjatësi 33.38 km;
F. Rrugë lokale kategoria F me gjatësi 655.15 km
Totali i të gjitha kategorive ne gjatësinë 3,804.65 km.
Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e Standardeve, me shkresën nr. 5756/3, datë 11.02.2014 ka dërguar në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, inventarin e rrugëve në dy variante, respektivisht:
a. Inventari kilometrik sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për shtimin dhe pakësimin e akseve rrugore në ngarkim të ARrSH-së
b. Inventari kilometrik sipas numrave (ekzistues) të akseve rrugore.
Sipas variantit "a" gjatësia e përgjithshme e rrugëve në pronësi të ARrSH-së është 3,794.35 km, i ndarë sipas rretheve dhe të emërtuara me numra të veçantë dhe klasifikimit të përcaktuar në Kodin Rrugor.
Sipas variantit 'b" gjatësia e rrugëve rezulton 3,873.38 km, ose 79.03 km më tepër se varianti "a", me një diferencë prej 10 km, për të cilën duhet bërë rakordim midis të dhënave të dy varianteve për saktësimin e kësaj diference.

Nga auditimi konstatohet se, në Raportin Përfundimtar të mëparshëm, ndonëse është lenë rekomandim për miratimin e kategorive dhe gjatësive të akseve rrugore, përsëri nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës nuk është marrë asnjë masë për miratimin e ndarjes së rrugëve sipas cilësimeve të përcaktuara në "Kodin Rrugor Shqiptar".
Sipas të dhënave kontabile vlera e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara nënzëri "Rrugë, rrjete, ura", në bilancin kontabël të datës 21.12.2016 të Autoritetit Rrugor Shqiptar, ka në pronësi Aktivet e Qëndrueshme të ndara në dy kategori të cilat paraqiten si më poshtë:
-Në llogarinë 213 "Rrugë dhe rrjete rrugore" paraqiten në vlerën prej 23,986,730,7821 lekë;
-Në llogarinë 231 Shpenzime në proces për rritjen e AQT-ve paraqiten në vlerën prej 232,954,644,972 lekë, nga 224,984,,436,272 lekë që ishin në fund të vitit 2015, me një shtesë prej 7,970,208,600 lekë.
Përsëri edhe në fund të vitit 2016 nuk ka të dhëna për gjatësinë e rrugëve të përfunduara dhe të kolauduara që sipas planit kontabël të cilat duhej të pasqyroheshin në analiza të veçanta sipas ndarjes së përcaktuar në "Kodin Rrugor Shqiptar" të analizuara në llogarinë 213 "Rrugë,rrjete dhe vepra ujore".
Burimet e krijimit të aktiveve për Autoritetin Rrugor Shqiptar paraqiten si më poshtë:
Pasivi i bilancit

Në 000/lekë

LLOGARITË	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2016	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2015
FONDET	**253,188,912**	**233,710,419**
FONDE TË VETA		
PJESËMARRJE TË INST.NË INVESTIME PËR TË TRETË		
REZULTATI I MBARTUR		
DETYRIME AFATSHKURTRA	**8,043,310**	**4,961,203**
Sigurime shoq.+ shëndetësore	1,650	1,663
Nga këto personeli	4,863	
Nga këto: Detyrimet për Kreditore te ndryshëm	8,036,378	4,954,198
T O T A L I	**270,319,690**	**258,525,385**

Nga analiza bilancit konstatohet se në llogarinë "Detyrime afatshkurtra" në datën 31.12.2016 është pasqyruar vlera prej 8,043,310 mijë lekë e cila përfaqëson investime të pa likuiduara deri në datën 31.12.2016, dhe pagat e muajit dhjetor 2016 në vlerën prej 4,055,262 lekë, të cilat janë likuiduar në muajin janar 2017.
-llogaria 435 dhe 436 "sigurime shoqërore + shëndetësore" në vlerën prej 1,650 mijë lekë përfaqëson kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2016 që janë likuiduar në muajin janar 2017.
-Llogaria 466 dhe 467 me vlerë totale prej 8,036,378 mijë lekë përfaqëson mjete në rruajtje për garancitë e punimeve që aplikohen gjatë zbatimit të kontratave në vlerën prej 2,300,944 mijë lekë, dhe borxhin gjatë vitit 2015 prej 5,735,384 mijë lekë me emërtimin detyrime të palikuiduara ndaj operatorëve ekonomikë për punime të përfunduara dhe të kolauduara.

Aktivet dhe burimet e krijimit të tyre për Drejtoritë Rajonale të Autoritetit Rrugor Shqiptar, paraqiten si më poshtë:
Drejtoritë Rajonale të ARRsh-së për periudhën objekt auditimi kanë paraqitur në Drejtorinë e Buxhetit të ARRSH-së bilancet kontabël për mbylljen e aktivitetit ekonomiko-financiar të vitit 2016, të cilat paraqiten si mëposhtë:

Bilanci Kontabël i Rajonit Verior Shkodër.

Në 000/lekë

LLOGARITË	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2016	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2015
AKTIVE TË QËNDRUESHME	**5,051,323**	**5,051,762**
AKTIVE TË PATRUPËZUARA		
Studime dhe kërkime		
Shpenzime për rritjen e aktiveve		
AKTIVE TË TRUPËZUARA		
Toka dhe terrene	1,538	1,538
Nga kjo,rrugë dhe vepra rrugore	5,048,751	5,048751
Shpenzime në proces për rritjen e AQT		
AKTIVE QARKULLUESE	**551,463**	**72,913**
GJENDJA E INVENTARIT	3,902	3,441
LLOGARITË FINANCIARE		
MARRËDHËNIE ME SHTETIN	544,131	64,940
LLOGARI TË TJERA AKTIVE	**2,834**	**4,532**
T O T A L I	**5,602,787**	**5,124676**

Për Drejtorinë Rajonale Shkodër konstatohet se është evidentuar në mënyrë të saktë gjatësia e akseve rrugore dhe vlera kontabël e tyre .
Llogaria 4342 "Marrëdhënie me shtetin" përfaqëson detyrime ndaj subjekteve private për punime të përfunduara por të palikuiduara

Bilanci i Drejtorisë Rajonale Qendër Tiranë.

Në 000/lekë

LLOGARITË	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2016	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2015
AKTIVE TË QËNDRUESHME	**2,169,289**	**2,209,652**
AKTIVE TË PATRUPËZUARA		
Studime dhe kërkime		
Shpenzime për rritjen e aktiveve		
AKTIVE TË TRUPËZUARA	2,169,289	2,209,652
Toka dhe terrene	-	
Nga kjo,rrugë dhe vepra rrugore	2,334,602	2,334,602
Shpenzime në proces për rritjen e AQT	-	
AKTIVE QARKULLUESE	**312,555**	**65,314**
GJENDJA E INVENTARIT	55,469	57,169
LLOGARITË FINANCIARE	**3,134**	**5,827**
MARRËDHËNIE ME SHTETIN	253,950	2,317
LLOGARI TË TJERA AKTIVE		
T O T A L I	**2,481,844**	**2,274,966**

-Llogaria 213 paraqitet si në fillim dhe në fund të vitit me të njëjtën vlere prej 2,334,602 lekë, pasi nuk ka patur investime të reja dhe të përfunduara, por vetëm shpenzime mirëmbajtje.
-Llogaria "marrë dhënie me shtetin" në vlerën prej 253,950 lekë përfaqëson detyrime të palikuiduar në fund të vitit ndaj furnitorëve dhe shoqërive sipërmarrëse për mirëmbajtje rutinë të rrugëve.

Bilani i Drejtorisë Rajonale Jug Gjirokastër.

Në 000/lekë

LLOGARITË	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2016	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2015

AKTIVE TË QËNDRUESHME	**6,516,013**	**6,519,361**
AKTIVE TË PATRUPËZUARA		
Studime dhe kërkime		
Shpenzime për rritjen e aktiveve		
AKTIVE TË TRUPËZUARA	6,516,013	6,519,361
Toka dhe terrene	41	41
Nga kjo,rrugë dhe vepra rrugore	6,524,764	6,524,764
Shpenzime në proces për rritjen e AQT	-	
AKTIVE QARKULLUESE	**150,358**	**48,231**
GJENDJA E INVENTARIT	13,170	11,006
LLOGARITË FINANCIARE	**6,725**	**6,725**
MARRËDHËNIE ME SHTETIN	112,715	12,752
LLOGARI TË TJERA AKTIVE		
T O T A L I	**6,666,371**	**6,567,592**

-Llogaria 213 paraqitet si në fillim dhe në fund të vitit me të njëjtën vlere prej 6,524,764 lekë, pasi nuk ka patur investime të reja dhe të përfunduara, por vetëm shpenzime mirëmbajtje.

-Llogaria "marrëdhënie me shtetin" në vlerën prej 112,715 lekë përfaqëson detyrime të palikuiduar në fund të vitit ndaj furnitorëve dhe shoqërive sipërmarrëse për mirëmbajtje rutinë të rrugëve.

Bilanci i Përmbledhës i Drejtorive Rajonale Veri, Qendër dhe Jug.

Në 000/lekë

LLOGARITË	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2016	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2015
AKTIVE TË QËNDRUESHME	**13,736,6263**	**13,780,775**
AKTIVE TË PATRUPËZUARA		
Studime dhe kërkime	-	-
Shpenzime për rritjen e aktiveve	-	-
AKTIVE TË TRUPËZUARA	13,736,6263	13,780,775
Toka dhe terrene	1,579	1,579
Nga kjo,rrugë dhe vepra rrugore	13,908,118	13,908,118
Shpenzime në proces për rritjen e AQT	-	-
AKTIVE QARKULLUESE	**1,014,409**	**186,459**
GJENDJA E INVENTARIT	72,542	71,616
LLOGARITË FINANCIARE	**6,725**	**6,725**
MARRËDHËNIE ME SHTETIN	910,797	67,858
LLOGARI TË TJERA AKTIVE	12,694	17,085
T O T A L I	**14,751,036**	**13,697,235**

Nga auditimi i bilanceve përmbledhës, konstatohet se ndryshe nga bilanci i Autoritetit Rrugor Shqiptar, Drejtoritë Rajonale kanë kryer veprimet kontabile të mbylljes së shpenzimeve në proces dhe kalimit të tyre në aktive të qëndrueshme të trupëzuara, pra nuk ka investime në proces në llogarinë 231, fakt që tregon për respektim të planit kontabël nga ana e Drejtorive Rajonale.

Nga Autoriteti rrugor Shqiptar nuk janë marrë masa për mbylljen e llogarisë 202 "Studime dhe projektime" në vlerën prej 697,368,228 lekë e cila përfaqëson shpenzimet për e këtij zëri për ARrSH dhe Drejtoritë Rajonale duke krediturar këtë llogari në debi të llogarisë 213 për Drejtoritë vartëse dhe ARRSH, të cilat kapin vlerën totale prej 37,894,857,780 lekë të ndara

respektivisht Drejtoritë Rajonale 13,908,118,000 lekë dhe ARRSH në shumën prej 23,986,739,781 lekë.

3.1. Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës konstatohet se:
Veprimet e kryera nëpërmjet bankës janë mbajtur në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, VKM nr.248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998".
Megjithatë duhet theksuar se në disa raste dokumentacioni justifikues për kruesen e pagesave është hartuar me mangësi, e konkretisht:

3.1.1. Për periudhën objekt auditimi konstatohen se janë lidhur gjithsej 83 kontratat me objekt "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë" me gjatësi 3796 km, nga verifikimi i kryer në zërat e punimeve të paraqitura në situacionet e mirëmbajtjes së akseve rrugore konstatohen se disa prej zërave kryesorë janë të pamatshëm, pasi njësia e matjes së tyre (volumet e punës) janë përcaktuar me njësinë "muaj" dhe jo me volumin e punimeve m^3, m^2, ose metër linear, kjo mënyrë nuk pasqyron realisht volumin e punës së kryer por krijon mundësi përfitimi të padrejtë nga shoqëritë kontraktuese, për faktin se vlera e përgjithshme e këtyre kontratave është e konsiderueshme në shumën prej 4,200,000 mijë lekë. Pesha specifike që zënë këto zëra punimi është rreth 25 % të vlerës së kontraktuar.

3.1.2. Me urdhër shpenzimin nr. 169, datë 14.04.2016 në shumën prej 4,835,265 lekë është likuiduar diferenca e mbetur nga fatura përfundimtare nr. 40, datë 10.06.2015, sipas kontratës së lidhur nr. 7466/6, datë 16.01.2016 me vlerë totale prej 43,453.800 lekë, me objekt *"Studim fizibiliteti i aksit rrugor "Skrapar-Përmet-Korçë" me kontraktues shoqërinë "ITP".* Nga verifikimi i kryer në të dhënat e këtij shërbimi dhe ligjshmërinë për pagesën e kryer u konstatua se, dokument bazë për likuidimin e këtij shërbimin ka shërbyer oferta e fituesit, dhe jo situacioni për punën dhe shërbimin e kryer në fakt. Nga analiza e kryer në zërat e shpenzimit, u konstatua se në këtë dokument është vendosur edhe një zë shpenzimi me emërtimin "Matje trafiku në terren" me vlerën prej **2,100,000 lekë**, për të cilin mungon njësia e matjes, sasi dhe çmimin për njësi. Likuidimi i situacionit së bashku me këtë zë shpenzimi në shumën prej 2,100,000 lekë është në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 " Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", kapitulli "Standardet dhe rregullat kontabël" pika 2.2 "Rregullat e përgatitjes së dokumentave justifikuese, për shpenzimet e kryera, ku është përcaktuar se:
-Çdo veprim kontabël ose ngjarje tjetër përshkruhet në një dokument të shkruar i cili përbën dokumentin justifikues bazë të regjistrimeve fillestare në kontabilitet.
-Dokumenti justifikues bazë përgatitet në kohën kur kryhet veprimi ose kur ndodh ngjarja.
Çdo dokument justifikues duhet të përmbajë:
- emërtimin e saktë të mallrave dhe furniturave apo të punimeve e shërbimeve të kryera;
-sasitë e faturuara.
-çmimin e faturimit për njësi;
Nga ballafaqimi i kryer me z.Vladimir Gojashi në cilësinë e personit të autorizuar ka nënshkruar një dokument fotokopje me emetimin "Ofertë Financiare" dhe jo situacion për punime të kryera në fakt, tregon për volume pune të pakryera, pasi në rastin konkret ky shërbim kryhet në një gjurmë rruge verore që pas përfundimit të studimit do të kryhet tender me objekt ndërtim aksi rrugor nacional për komunikimin automobilistik midis këtyre 4 rretheve. Në këto kushte vendosja e këtij zëri në shumën prej ***2,100,000 lekë është e pajustifikuar dhe e paargumentuar pasi në mungesë të trafikut të mjeteve motorike, ky zë shpenzimi është formal dhe përbën dëm***

ekonomik për buxhetin e shtetit dhe përfitim të padrejtë nga shoqëria sipërmarrëse "ITP" shpk.

-Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës, bankës në lekë dhe veprimeve në valutë për periudhën objekt auditimi.
-Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.
-Mbi administrimin e pronës shtetërore, zbatimi i dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen,dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare.

4. Mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit
Mbajtja e kontabilitetit dhe mbyllja e llogarive vjetore në Autoritetin Rrugor Shqiptar për vitin 2016, është bërë në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, VKM nr.248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998". Dokumentet justifikuese për kryerjen e veprimeve ekonomike, janë plotësuar konform dispozitave ligjore në fuqi.
Hartimi i Bilancit të Autoritetit Rrugor Shqiptar për vitin 2016 është kryer në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi.
Nga verifikimi i llogarive të bilancit rezulton se, llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike dhe me pasqyrat financiare te Aktivit dhe të Pasivit.
Janë bërë rakordimet e situacionit të shpenzimeve me Degën e Thesarit Tiranë dhe rakordimet e të ardhurave të cilat paraqiten në bilanc me vlerën e tyre reale.
Veprimet kontabël janë kryer konform plani kontabël dhe në bazë të Projektit SETS, nga auditimi konstatohet se veprimet në përmjet bankës bankën", "Hyrjet dhe Daljet e magazinës", veprimet lidhur me "Pagat" dhe veprimet lidhur me shpenzimet operative dhe për investime, janë të rregullta. Të gjitha sistemimet dhe mbylljet e llogarive të regjistruara në ditarin e "Veprimeve të ndryshme", janë kryer konform dispozitave ligjore dhe Udhëzimit nr. 2, datë 10.01.2002 të Ministrisë së Financave.

Sipas Bilancit Kontabël të Autoritetit Rrugor Shqiptar, rezulton se llogaritja dhe kontabilizimi i amortizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara është kryer konform akteve nënligjore në fuqi. Rubrikat dhe postet e bilanceve kontabël të këtij institucioni janë përmbledhur në një të vetëm. Aktivet e Autoritetit Rrugor Shqiptar, sipas zërave paraqiten në tabelën e mëposhtme:
AKTIVI *Në 000/lekë*

LLOGARITË	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2016	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2015
AKTIVE TË QËNDRUESHME	**262,267,051**	**253,558,031**
AKTIVE TË PATRUPËZUARA	4,624,361	3,894,490
Studime dhe kërkime	697,368	697,368
Shpenzime për rritjen e aktiveve	3,926,992	3,197,121
AKTIVE TË TRUPËZUARA	209,278,891	230,730,202
Toka dhe terrene	545,880	545.880
Nga kjo,rrugë dhe vepra rrugore	23,986,789	23,986,789
Shpenzime në proces për rritjen e AQT	232,954,644	224,984,436
AKTIVE QARKULLUESE	**8,052,639**	**4,967,533**
GJENDJA E INVENTARIT	7,428	6,125
LLOGARITË FINANCIARE	2,982,953	1,670,705

MARRËDHËNIE ME SHTETIN	2,981,053	1,670,705
LLOGARI TË TJERA AKTIVE	5,062,256	3,290,522
T O T A L I	**270,319,690**	**258,525,385**

-Llogaria Aktive të Qëndrueshme në datën 31.12.2016 në aktiv të bilancit paraqitet me vlerë 262,267,051 mijë lekë ose me tepër 8,079,020 lekë krahasuar me vitin 2015, shtesë e cila ka ardhur si rrjedhojë e përfundimit dhe kolaudimit të investimeve në rrugë, si dhe i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura nga vitet e kaluara.
-Llogaria 202, "Studime dhe kërkime" me vlerë me vlerë 697,368 mijë lekë, përfaqëson vlerën e mbartur të shpenzimeve për studime projektime të rrugëve të mbartura nga vitet e kaluara.
-Llogaria 210, " Toka, troje dhe terrene" me vlerë 545,880 mijë lekë, përfaqëson vlerën e mbartur nga viti 2006 të shpenzimeve për shpronësime likuiduar pronarëve të trojeve ku është bërë shpronësimi për segmentet rrugore
-Llogaria 230, "Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara" me vlerë 3,926,992 mijë lekë, shtuar gjatë vitit 2016 me vlerën prej 729,871 mijë lekë, përfaqëson studime projektime të mbartura nga vitet e kaluara për segmente të ndryshme ligjore.

Nga verifikimi i kryer në aktivin e bilancit llogaria 213 "Rrugë,rrjete,vepra ujore", konstatohet se në datën 31.12.2016 kjo llogari është pasqyruar në bilanc në vlerën prej 23,986,789 mijë lekë, gjatë vitit 2016, ndonëse kanë përfunduar, janë marrë në dorëzim investime të përfunduara nuk janë kontabilizuar dhe pasqyruar në rritje të aktiveve të trupëzuara, kështu përmendim:
-Llogaria 4342 "marrëdhënie me shtetin debitor" në fund të vitit 2016 paraqitet ne bilanc në shumën 2,981,053 mijë lekë e cila përfaqëson detyrime të lindura gjatë vitit 2016 për paga, sigurime shoqërore dhe tatim mbi të ardhurat si detyrime të prapambetura të muajit dhjetor 2016.
-Llogaria 230 "Studime e projektime" në vlerën prej 697,368 mijë lekë paraqitet në bilanc e pandryshuar si në vitin 2016 ashtu edhe në vitet e mëparshme 2013 dhe 2014. Kjo llogari në kundërshtim me planin kontabël nuk është krediturar sipas objekteve të përfunduara dhe të kolauduara për çdo objekt të marrë në dorëzim në debi të llogarisë aktive të trupëzuara.

Nga auditimi i aktivit të bilancit konstatohet se, nuk janë marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm në lidhje më rakordimin e llogarive të aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, kështu:
Nuk janë sistemimin e llogaritë 202, 210 dhe 230 që përfaqësojnë vlerën e studime projektimeve, dhe shpronësimeve në shumën gjithsej prej 5,170,248 mijë lekë, e cila duhet të sistemohet në debi të llogarisë 213, po kështu edhe llogaria 231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT me vlerë 232,984,644 mijë lekë për vlerën e investimeve të përfunduara dhe të kolauduara duhet të sistemohet në debi të llogarisë 213 " Rrugë, rrjete, vepra ujore ", e cila përfaqëson vlerën e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara të pandryshuar prej viteve të kaluara në shumën prej 23,986,739 mijë lekë.
ARrSH me shkresën nr. 5756, datë 11.02.2014 ka paraqitur në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, evidencën e inventarit kilometrik sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për shtimin dhe pakësimin e akseve rrugore në ngarkim të ARrSH-së, të emërtuara me numra respektivë të çdo aksi rrugor, sipas të cilit gjatësia e përgjithshme e rrugëve është **3,794.35 km**.
Nga të dhënat që disponohen në aktivet e qëndrueshme të ARrSH-së rrugët e ndara sipas programeve dhe produkteve buxhetore dhe klasifikimeve të përcaktuara në nenin 2 të Kodit Rrugor paraqiten sipas kategorive dhe gjatësive të mëposhtme:
B. Rrugë interurbane kryesore gjatësia 233.16 km;

C. Rrugë interurbane dytësore gjatësia 2,882.96 km;
E. Rrugë urbane dytësore me gjatësi 33.38 km;
F. Rrugë lokale kategoria F me gjatësi 655.15 km
Totali i të gjitha kategorive ne gjatësinë 3,804.65 km.

Nga auditimi konstatohet se, Drejtoria e Standardeve, me shkresën nr. 5756/3, datë 11.02.2014 ka dërguar në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, inventarin e rrugëve në dy variante, respektivisht:

c. Inventari kilometrik sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për shtimin dhe pakësimin e akseve rrugore në ngarkim të ARrSH-së

d. Inventari kilometrik sipas numrave (ekzistues) të akseve rrugore.

Sipas variantit "a" gjatësia e përgjithshme e rrugëve në pronësi të ARrSH-së është 3,794.35 km, i ndarë sipas rretheve dhe të emërtuara me numra të veçantë dhe klasifikimit të përcaktuar në Kodin Rrugor.

Sipas variantit 'b" gjatësia e rrugëve rezulton 3,873.38 km, ose 79.03 km më tepër se varianti "a", me një diferencë prej 10 km, për të cilën duhet bërë rakordim midis të dhënave të dy varianteve për saktësimin e kësaj diference.

Nga auditimi konstatohet se, në Raportin Përfundimtar të mëparshëm, ndonëse është lenë rekomandim për miratimin e kategorive dhe gjatësive të akseve rrugore, përsëri nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës nuk është marrë asnjë masë për miratimin e ndarjes së rrugëve sipas cilësimeve të përcaktuara në "Kodin Rrugor Shqiptar".

Sipas të dhënave kontabile vlera e Aktiveve të Qëndrueshme të Trupëzuara nënzëri "Rrugë, rrjete, ura", në bilancin kontabël të datës 21.12.2016 të Autoritetit Rrugor Shqiptar, ka në pronësi Aktivet e Qëndrueshme të ndara në dy kategori të cilat paraqiten si më poshtë:

-Në llogarinë 213 "Rrugë dhe rrjete rrugore" paraqiten në vlerën prej 23,986,730,7821 lekë;

-Në llogarinë 231 Shpenzime në proces për rritjen e AQT-ve paraqiten në vlerën prej 232,954,644,972 lekë, nga 224,984,,436,272 lekë që ishin në fund të vitit 2015, me një shtesë prej 7,970,208,600 lekë.

Përsëri edhe në fund të vitit 2016 nuk ka të dhëna për gjatësinë e rrugëve të përfunduara dhe të kolauduara që sipas planit kontabël të cilat duhej të pasqyroheshin në analiza të veçanta sipas ndarjes së përcaktuar në "Kodin Rrugor Shqiptar" të analizuara në llogarinë 213 "Rrugë,rrjete dhe vepra ujore".

Burimet e krijimit të aktiveve për Autoritetin Rrugor Shqiptar paraqiten si më poshtë:

Pasivi i bilancit

Në 000/lekë

LLOGARITË	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2016	GJENDJE NË FUND TË VITIT 2015
FONDET	**253,188,912**	**233,710,419**
FONDE TË VETA		
PJESËMARRJE TË INST.NË INVESTIME PËR TË TRETË		
REZULTATI I MBARTUR		
DETYRIME AFATSHKURTRA	**8,043,310**	**4,961,203**
Sigurime shoq.+ shëndetësore	1,650	1,663
Nga këto personeli	4,863	
Nga këto: Detyrimet për Kreditore te ndryshëm	8,036,378	4,954,198
T O T A L I	**270,319,690**	**258,525,385**

Nga analiza bilancit konstatohet se në llogarinë "Detyrime afatshkurtra" në datën 31.12.2016 është pasqyruar vlera prej 8,043,310 mijë lekë e cila përfaqëson investime të pa likuiduara deri

në datën 31.12.2016, dhe pagat e muajit dhjetor 2016 në vlerën prej 4,055,262 lekë, të cilat janë likuiduar në muajin janar 2017.
-llogaria 435 dhe 436 "sigurime shoqërore + shëndetësore" në vlerën prej 1,650 mijë lekë përfaqëson kontributin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2016 që janë likuiduar në muajin janar 2017.
-Llogaria 466 dhe 467 me vlerë totale prej 8,036,378 mijë lekë përfaqëson mjete në rruajtje për garancitë e punimeve që aplikohen gjatë zbatimit të kontratave në vlerën prej 2,300,944 mijë lekë, dhe borxhin gjatë vitit 2015 prej 5,735,384 mijë lekë me emërtimin detyrime të palikuiduara ndaj operatorëve ekonomikë për punime të përfunduara dhe të kolauduara.

Nga Autoriteti rrugor Shqiptar nuk janë marrë masa për mbylljen e llogarisë 202 "Studime dhe projektime" në vlerën prej 697,368,228 lekë e cila përfaqëson shpenzimet për e këtij zëri për ARrSH dhe Drejtoritë Rajonale duke krediturë këtë llogari në debi të llogarisë 213 për Drejtoritë vartëse dhe ARRSH, të cilat kapin vlerën totale prej 37,894,857,780 lekë të ndara respektivisht Drejtoritë Rajonale 13,908,118,000 lekë dhe ARRSH në shumën prej 23,986,739,781 lekë.

Në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare dhe mbajtjes së kontabilitetit, rezulton se nuk ka raste mospërputhjesh materiale dhe se vlerësimi i këtij aspekti të auditimit është në përputhje me kriteret e vlerësimit: Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, VKM nr.248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësive që varen prej tyre", ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 "Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998".
Konkludojmë se opinioni për këtë pikë të programit është i pamodifikuar dhe me siguri të arsyeshme.

4. Prokurimi i fondeve publike.

Realizimi i procedurave të prokurimit publik, gjatë periudhës objekt auditimi i strukturuar në numër, vleftë dhe sipas llojeve të prokurimit gjithsej, jepen nga tabela në vijim (në mijë lekë):

Nr	Lloji procedurës		2015			2016		
			nr	F L	fituar	nr	F L	fituar
1	**Blerje të vogla**							
2	**Negoci pa shpallje**		**16**	1,944,345	1,944,325	**8**	977,324	977,324
	Shtesa 20 %							
	Te tjera neni 33/b							
3	**Kerkese per propoz**		**2**	2,635	2,196	**3**	6,700	5,909
	Diferenca %							
4	**Hapur**		**18**	6,038,380	5,731,281	**27**	2,694,211	2,243,955
5	**Neni 5 ligji 9643**		**-**	-	-	**-**	-	-
6	**Shërbi konsulence**		**23**	925,582	911,441	**13**	212,787	207,668
	Shuma 1 deri 6		**59**	8,910,944	8,589,245	**51**	3,891,023	3,434,859
	Diferenca				321,699			456,164

- Nga tabela konstatohet se në ARRSH gjatë periudhës 1.1.2015 deri 31.12.2016 janë zhvilluar/realizuar 110 procedura prokurimi me fond limit 12,801,967 mijë **lekë**, me vlerë të

fitimit të tenderëve 12,024,104 mijë lekë dhe *efekt të garës 777,865 mijë lekë (ulje ndaj fondit limit), ose rreth 6 për qind* e fondit limit të prokuruar.

Në përfundim të auditimit me zgjedhje të procedurës së zhvillimit dhe zbatimit të tenderëve, u konstatuan parregullsi të shoqëruara me **dëm në shumën 202,536,373 lekë,** nga i cili tenderin me objekt:

4.1. "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" "Shtesë kontrate" me fond limit 173,498,482 lekë (vlerë e plotë 208,198,211 lekë), i zhvilluar në vitin 2016 lidhur shtesë kontrate nr. 7244, datë 14.9.2016 me Bashikim e Operatorëve Ekonomikë (BOE) "Rosi spa Albania & Everest" sh.p.k.

Sipas dokumentacionit:
Arrsh në vitin 2015 ka zhvilluar tenderin me objekt "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" me fond limit 980,844,927 lekë. Tenderi është fituar nga Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë (BOE) "RRR & EEE" sh.p.k. me fond limit 949,840,681 lekë dhe vlerë të kontratës së lidhur 1,139,808,817 lekë. Kontrata midis palëve është lidhur datë 4.8.2015. Në nenin 3/3 të kontratës "*Afati i kontratës*" është përcaktuar se .... *afati maksimal i përfundimit të punimeve është 18 muaj nga data e lidhjes ë kontratës, sipas grafikut të punimeve bashkëlidhur kësaj kontrate* (4 shkurt 2017).
Në preventivin e objektit të paraqitur nga BOE, në kapitullin e II është përcaktuar kryerja e punimeve me emërtim *"Zgjerimi i urës së Sulovës"* me fond limit 118,348,975 lekë.
Drejtues i projektit (mbikëqyrës i punimeve) është caktuar subjekti "GGG" sh.p.k.

4.1.1. Parregullsi e konstatuar:
Autoriteti kontraktor (AK), ka pranuar/lejuar:
- Ndryshime thelbësore të projektit të paktën për urën e Sulovës (mbi lumin Vjosë) dhe rritjen me 208,198,680 lekë, ose mbi 18 për qind të vlerës së kontratës bazë nëpërmjet 'Shtesës së punimeve",
- Ndryshimin e projektit për segmentin Gostimë – Mollas, saktësisht "Ura e re e Sulovës" hartuar (firmosur dhe vulosur) nga BOE "RRR" sh.p.k, në kundërshtim me pikën 7 të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.5.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit" në të cilin është përcaktuar se ...
Pika 7 ***Sipërmarrës****i nuk mund të ndryshojë me nismën e vet, të subjektit projektues a mbikëqyrës, projektin dhe përshkrimet teknike të tij.*
7.1 Sipërmarrësi është i detyruar të zbatojë çdo ndryshim të urdhëruar me shkrim nga investitori ose persona të autorizuar prej tij, që nuk ndryshon, në thelb, ***kushtet kryesore të projektit, të kontratës*** *dhe* ***nuk rrit vleftën e saj****.*
*7.2 Propozimet për rritjen e vleftës së kontratës dhe zgjatjen e afatit të punimeve i paraqiten investitorit, nëpërmjet mbikëqyrësit të punimeve, kur ato përmirësojnë treguesit e veprës****, vijnë nga shkaqe pamundësisht të paparashikueshme,*** *në kohën e duhur dhe nuk janë në kundërshtim me kushtet e kontratës.*
7.3 Ndryshimet e miratuara nga investitori sipas pikave 7.1 e 7.2 të këtij kreu, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm teknik, ekonomik e administrativ, i dorëzohen zyrtarisht, sipërmarrësit.

Argumentim:
Kronologjikisht, sipas dokumentacionit:

4.1.1.1. Projekti i "Zgjerimit të urës së Sulovës" është pjesë e tenderit "Studim projektim riveshje sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë" fituar/realizuar nga BOE "PNI – 2001" & "G 7 K" me drejtues ligjor përkatësisht A.A, me gradë shkencore prof. i asociuar dhe D.D inxhinier, me vlerë të kontratës së lidhur 35,214,000 lekë.

Për këtë urë, qysh në fazën e Projekt Idesë, është propozuar zgjerimi i saj duke marrë në konsideratë faktin që ky zgjerim, të punojë si urë më vete e pavarur nga ura ekzistuese duke i lënë të ndara me fugë gjatësore me distancë 20 cm, si edhe për të mos penguar mundësinë e ndërhyrjeve të mëvonshme. Ky propozim është pasqyruar më pas në projekt zbatimin e këtij zgjerimi.

Oponenca teknike e projektzbatimit është kryer nga Instituti i Ndërtimit dhe me shkresë nr. 128/2, datë 23.3.2015 i është dërguar ARRSH, e cila me vendim të Këshillit Teknik nr. 15, datë 30.3.2015 ka vendosur ... Të miratojë në parim projektzbatimin e objektit *"Studim projektim riveshje sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë". Projekti i zbatimit të ndahet në tre lote ... Loti i III Gostimë – Mollas (seg. Gostimë – Mollas me 1=1,8583 km, Viadukti prog.0+853,* ***zgjerimi i urës së Sulovës HD 11x22.2.=242 m*** *...*
(Vlen të evidentohet se pjesë e studimit dhe projektzbatimit janë dhe dy ura të tjera, më të vjetra/amortizuara se ura e Sulovës" ajo mbi lumin Shkumbin në Elbasan dhe ajo në Papër, për të cilat projektuesi ka ndjekur të njëjtin arsyetim, si për urën e Sulovës dhe ARRSH ka shprehur dakordësinë dhe nuk ka bërë ndryshime të projektit gjatë zbatimit).

Projektzbatimi përfundimtar është dorëzuar në muajin prill 2015 dhe brenda vitit 2015 subjektit fitues i është likuiduar vlera e plotë e kontratës prej 35,214,000 lekë, nga e cila 25,214,000 lekë, ose mbi 71 për qind e vlerës, në muajin dhjetor 2015. Mbi bazën e projekt preventivit përfundimtar të zbatimit, ARRSH ka zhvilluar tenderët e ndërtimit të ndarë në tre lote.

ARRSH në muajin qershor të vitit 2015 ka zhvilluar tenderin me objekt "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" me fond limit 980,844,927 lekë. Tenderi është fituar nga Bashkimi Operatorëve Ekonomikë (BOE) "RRR" sh.p.k. me fond limit 949,840,681 lekë dhe vlerë të kontratës së lidhur 1,139,808,817 lekë. Kontrata midis palëve është lidhur datë 4.8.2015. Në nenin 3/3 të kontratës "*Afati i kontratës*" është përcaktuar se .... *afati maksimal i përfundimit të punimeve është 18 muaj nga data e lidhjes ë kontratës, sipas grafikut të punimeve bashkëlidhur kësaj kontrate* (4 shkurt 2017).
Në preventivin e objektit të paraqitur nga BOE, në kapitullin e II është përcaktuar kryerja e punimeve me emërtim *"Zgjerimi i urës së Sulovës"* me fond limit 118,348,975 lekë.

Drejtues i projektit (mbikëqyrës i punimeve) është caktuar subjekti "GGG" sh.p.k.

4.1.1.2. BOE "RRR" sh.p.k. me shkresë 2016, datë 7.1.2016 rreth 8 muaj më vonë nga miratimi i projektzbatimit përfundimtar, i ka kërkuar ARRSH nëpërmjet Mbikëqyrësit të punimeve "GGG" sh.p.k. "Shtesë kontrate" për objektin "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" (në ARRSH është protokolluar me nr. 41, datë 7.1.2016 dhe drejtuar VVV zv/drejtor, EEE dhe AAA.
Kontraktori në shkresë, ndër të tjera është shprehur se ... *Nga vëzhgimi i urës së Sulovës, janë vënë re disa defekte të cilat sipas nesh cenojnë sigurinë e saj. Mungesa e një lidhje të qëndrueshme të saj. Seksioni tërthor i urës përbëhet nga trarë 22.2. m të lidhur mes tyre nga traversa të cilat janë të dëmtuara. Mungesa e një lidhje të qëndrueshme të trarëve e cila është bazuar në punën që bëjnë disa detaje metalike të salduara, të cilat disa prej tyre janë të*

dëmtuara (prishur saldimi)bën që trarët të punojnë më vete, duke marrë ngarkesën çdo tra më vete dhe jo sipas llogaritjeve të konstruksionit.
Gjithashtu është vënë re se janë bërë ndërhyrje në përforcimin e pilave, por mund të konstatojmë që ka një gërryerje të vazhdueshme të tyre dhe në disa prej tyre është bërë zgjerimi duke kaluar nga 1 m në 1,5 m gjerësi. Në të njëjtën kohë, lidhja mes jastëkëve të sipërm dhe pilave është realizuar që të përballojë forcat vertikale, por jo ato horizontale. ***Propozojmë që të ndryshojmë aksin e rrugës*** *në mënyrë që të mos kemi dy kthesa të njëpasnjëshme nga pro. 0+800 deri në pro 1+600, por të kalojë në vijë të drejtë nëpërmjet realizimit të një viadukti me mbushje* ***dhe urës së re me dy korsi****...(përmbledhja e mangësive të projektit fillestar).*
Realizimi i këtyre veprave kërkon një rritje të fondit prej 150 milion lekë*.*

4.1.1.3. Mbikëqyrësi i punimeve "GGG" sh.p.k. me shkresë nr. 4268, datë 26.5.2016 (prot i Arrsh) i ka kërkuar Arrsh "*Miratim për ndryshime në projekt*".
Sipas kësaj shkrese ... *gjatë zbatimit të punimeve në objekt u vunë re disa problematika. Për këtë u hartua Projekti dhe preventivi i rishikuar. Bashkëngjitur po ju dërgojmë dokumentacionin e plotë të projektit të rishikuar...*
Projekti përmban Planimetrinë e rrugës, Planimetrinë e kanalizimeve, Planimetrinë e Sinjalistikës, Profilin gjatësor të rrugës, Profilin tërthor, Projekt ura e sulovës, Projekti i viaduktit, Preventiv i rishikuar, Analizat e çmimeve për zërat e rinj, Relacionin teknik.

Në "Relacionin teknik" shoqërues, me numër 10 me emërtim "Ura e sulovës" ndër të tjera është evidentuar se ... *Nga shqyrtimi në vend i urës së Sulovës, janë venë re disa difekte të cilat sipas nesh cenojnë sigurinë e saj.*
Ura e re ***është projektuar në aksin e ri rrugor*** *që në vijë të drejtë të nxjerr nga ana tjetër e lumit... Në projektin e këtij segmenti jan bërë këto ndryshime...* ***pozicioni i aksit është ndryshuar****. Ura e vjetër që ndodhet në këtë segment është jashtë kushteve të shfrytëzimit siç është shtjelluar më sipër mbi këtë problematikë. Për këtë arsye është vendosur ndërtimi i një ure të re paralel me urën e vjetër...*

4.1.1.4. EHH me detyrë ZZZ me shkresë nr. 4268/1, datë 30.5.2016, i ka dërguar materialin sipas përshkrimit të bërë në pikën 2, z. AAA me detyrë vvv i Këshillit Teknik (KT) të ARRSH, me qëllim mbledhjen e KT për të shqyrtuar propozimet e ardhura nga mbikëqyrësi dhe kontraktori i punimeve.
1.5. KT me vendim nr. 47, datë 8.7.2016 me objekt "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan - Banjë loti 3" ndër të tjera ka vendosur ... *Të miratojë në parim propozimet për ndryshime/përmirësime/modifikime dh shtesë punimesh në projektpreventivin e objektit "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan - Banjë loti 3".*
- Të negociohen të gjithë zërat e rinj të punimeve,
- Ngarkohet Sektori i Zhvillimit të Projekteve dhe Sektori i Projekteve të Brendshme për ndjekjen dhe zbatimin e detyrave ...
- Mbi këtë bazë mbikëqyrësi i punimeve të hartojë dhe dorëzojë ... dokumentacionin e nevojshëm preventivin brenda vlerës së kontratës bazë, duke përfshirë dhe fondin rezervë, preventivin e punimeve shtesë...
Në relacion, nuk është shprehur ndonjë vlerësim ekonomik për ndryshimin e projektit.

4.1.1.5. Në vijim, në zbatim të vendimit të Këshillit Teknik (KT) nr. 47, datë 8.7.2016 janë hartuar "preventivi i ripunuar" i kontratës bazë të projektit "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan - Banjë loti 3" me fond limit 949,840,681 lekë (i njëjtë me fondin limit të fituar

në tender) dhe preventivi "Shtesë punime" për nën objektin me emërtim "Ura e Sulovës", me fond limit 173,498,900 lekë.
Element që veçohet është fakti se në "Preventivin e ripunuar" të kontratës bazë, në pjesën e II, gjendet përsëri "Ura e Sulovës" me fond limit 65,106,597 lekë.
Shuma e shpenzimeve për urën e re të Sulovës" për të dy preventivët është **238,606,497 lekë** (fondi limit i parashikuar sipas preventivit të ripunuar të kontratës bazë 65,106,597 lekë dhe preventivi "Shtesë punime", të urës së re "Sulovë" 173,498,900 lekë).
Normalisht AK duhet të hartonte vetëm një preventiv për ndërtimin e urës së re të Sulovës, i cili do të shërbente si fond limit, të cilit AK, duhet t'i referohej për të zhvilluar procedurën e tenderit.

Vlera përfundimtare për urën e re të Sulovës prej 238,606,497 lekë është **120,257,522 lekë më shumë se sa vlefta e kërkuar për "zgjerimin" e urës sipas projektpreventiv**it fillestar me të cilin është fituar tenderi.

Vlera"Shtesë" (fondi limit shtesë) për punime "Shtesë" e kërkuar/miratuar nga ARRSH është 173,498,900 lekë, ose **23,498,900 lekë më tepër** se sa fondi shtesë i kërkuar nga Kontraktori dhe mbikëqyrësi i punimeve (pika 2 e këtij akt konstatimi, në të cilën është kërkuar rritje fondi prej 150,000,000 lekë).

Nga shqyrtimi/vlerësimi/krahasimi midis pikës 1 dhe pikës 2, 3, 4, 5 të këtij akt konstatimi, minimalisht përfundohet se KT nuk ka zbatuar projektin fillestar, sipas të cilit është parashikuar që ky zgjerim, të punojë si urë më vete i pavarur nga ura ekzistuese, por ka pranuar/ndryshuar/cenuar thelbësisht projektin fillestar, duke parashikuar/ndërtuar, në një aks të ri rrugor, *një urë të re në Sulovë, me dy korsi* ... e shoqëruar me dëm 120,257,522 lekë në buxhetin e ARRSH, i cili ngarkon me përgjegjësi K.T. tw përbërë nga AAA, EEE, EEH, AAL, SSS, AAE, AAH dhe AAM.

Në tërësi, nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes, rezulton se AK, për ndryshimet ndaj projektit fillestar, nuk është konsultuar me projektuesit e saj.

4.1.*2. Parregullsi e konstatuar:*
Vendimi i KT nr. nr. 47, datë 8.7.2016 është produkt i mbledhjes/procesverbalit të KT datë 31.5.2016. Ky procesverbal i mbledhjes së KT *nuk është i shoqëruar* nga:
- Relacioni shoqërues i Drejtorisë/oficerit të projektit për përdorimin e fondit rezervë, i cili shpreh qartë shkaqet që sjellin këto ndryshime, vlefshmërinë e tyre dhe qëndrimin e tyre pro ose kundër propozimit .
- R**elacioni shoqërues** përgatitur nga drejtoria përkatëse/oficeri i projektit, në rastin kur materiali i paraqitur kërkon shtesë punimesh që tejkalon vlerën e plotë të preventivit të ofertës, (kërkon aplikimin e shtesës së punimeve deri në 20 për qind sipas ligjit a kushteve të kontratës) nuk jepen shpjegime të argumentuara e sqarohen saktësisht shkaqet që bëjnë të nevojshme aplikimin e këtyre shtesave dhe nëqoftëse **janë identifikuar përgjegjësitë përkatëse** që kanë sjellë shtesën e punimeve.
- Projekt-vendimi i hartuar nga Sekretaria e Këshillit për Këshillin Teknik ku bëhet një përshkrim i shkurtër i çdo problemi të trajtuar, shprehen qartë vendimet dhe detajohen detyrat e ngarkuara drejtorive si dhe datat për zbatimin e tij. Ky projekt-vendim i paraqitet brenda 7 ditësh Drejtorit të Përgjithshëm i cili nxjerr vendimin *përkatës që paraprakisht është i sigluar nga anëtarët e Këshillit Teknik* (vendimi I KT nr. 47, datë 8.7.2016), në kundërshtim me pikat

8.3, 8.4. etj të "Rregullore e Brendshme e ARRSH" miratuar me Vendim të Bordit nr. 4, datë 15.4.2016.

Në këtë procesverbal, lidhur me ndryshimin e projektpreventivit të urës së Sulovës:
- Nga nga pjesëmarrësit, nuk është shprehur ndonjë opinion dhe nuk është marrë asnjë vendim,
- Nuk jepet/shprehet ndonjë e dhënë ekonomike.

Procesverbali është mbyllur me shprehjen ... *Të plotësohet materiali me të gjithë elementët e të paraqitet para oficerit të projektit për kontroll, para se të vendoset.*
Materiali pasues është Vendimi i KT nr. 47, datë 8.7.2016, me përmbajtje sipas pikës 1.4.
Sa më sipër ngarkon me përgjegjësi AAH në cilësinë e Sekretares të KT.

4.1.3**.** *Parregullsi e konstatuar:*
Në preventivin e ripunuar të kontratës bazë në pjesën e dytë me emërtim "Ura e Sulovës" në zërin "punime të ndryshme" është parashikuar "prishje struktura ekzistuese prej betoni" 542 m^3 me vlerë 1,177,224 lekë x 1.05 fondi rezervë x 1.2. TVSH = 1,483,302 lekë (njëlloj si në kontratën bazë të pa ripunuar).
Parashikimi i prishjeve të "strukturave të betonit ekzistuese", ndërkohë që do të ndërtohet një urë e re në një aks tjetër rrugor, është i gabuar. Nën këtë arsyetim vlera e parashikuar prej **1,483,302 lekë** përbën **dëm ekonomik** dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve subjektin "GGG" të përfaqësuar nga ing. HMM, BOE "RRR" sh.p.k. ing. SSL dhe SSP, të cilët kanë hartuar dhe miratuar këto zëra punimi.

4.1.**4.** *Parregullsi e konstatuar:*
Për tenderin "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" "Shtesë kontrate" me fond limit 173,498,482 lekë, nuk ka leje ndërtimi, nuk është kërkuar/bërë oponenca teknike e projektzbatimit të urës së re Sulovë, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar në të cilin është përcaktuar se ... *Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të bëhet për të gjitha lejet e ndërtimeve, me vlerë të preventuar së paku **100 milion lekë**, nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve.*

4.1.**5.** *Parregullsi e konstatuar:*
Zhvillimi i tenderit me objekt "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" "Shtesë kontrate"me procedurë "Me negociim pa shpallje paraprake" mbështetur në:
- nenin 29/c, nenin 33 pika 5 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar,
- nenin 36/2/dh të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është në kundërshtim me 36/2/dh të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, pasi autoriteti kontraktor, nuk gjendet në asnjë nga situatat që ka përshkruar AK në urdhrin e prokurimit.

Kjo parregullsi është e lidhur edhe me përfundimet e pikës 1 të këtij akt konstatimi.

Argumentim:
Mbështetur në urdhrin e e prokurimit nr. 7244 prot, nr. 34, datë 2.9.2016 tenderi për "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" "Shtesë kontrate" është zhvilluar:
- Me procedurë "Me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës" **(shtesë kontrate)**, me kontraktuesin e mëparshëm Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë (BOE) "RRR" sh.p.k.
- Bazuar në nenin në nenin 29/c dhe 33 pika 5 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar,

- nenin 36/2/dh të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",
Procedura është përfunduar me lidhjen e "Shtesë kontrate" 7244/4 datë 14.9.2016 me BOE "RRR" sh.p.k.

Lidhur me procedurën e prokurimit.
- Neni 29/c i ligjit përcakton "Procedurat standarde të prokurimit". Në zbatim të tij llojet e procedurave të prokurimit publik janë:
- procedurë e hapur;
- procedurë e kufizuar;
- *procedurë me negocim, me ose pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.*

4.1.5.1. Neni 33/5 i ligjit përcakton se "Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit", mund të përdoret për kontratat e punëve:
a) për punë apo shërbime shtesë, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, por që, për shkak të rrethanave të paparashikuara, janë bërë të domosdoshme, me kusht që t'i jepen operatorit ekonomik, që realizon këto ndërtime apo shërbime, si dhe kur vlera e punës dhe/ose shërbimeve shtesë nuk e tejkalon 20 për qind të vlerës së kontratës fillestare:
i) kur ndërtimet apo shërbimet suplementare nuk mund të ndahen nga kontrata fillestare, pa shkaktuar vështirësi të mëdha, teknike e ekonomike, për autoritetin kontraktor;
ii) kur këto ndërtime e shërbime, edhe pse të ndara nga kontrata fillestare, janë të domosdoshme për përmbushjen e saj.
b) për ndërtime apo shërbime të reja, që kanë të bëjnë me përsëritjen e ndërtimeve apo të shërbimeve të ngjashme, që i janë besuar një operatori ekonomik, të cilit autoriteti kontraktor i ka akorduar kontratën fillestare, me kusht që këto ndërtime ose shërbime të përputhen me projektin bazë, për të cilin është shpallur fitues i kontratës fillestare me procedurën e hapur ose të kufizuar. Përdorimi i mundshëm i kësaj procedure duhet të përfshihet në njoftimin e kontratës fillestare dhe autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë koston e përgjithshme të përllogaritur të ndërtimeve ose shërbimeve në vijim. Procedura e mësipërme mund të përdoret vetëm brenda 3 viteve nga lidhja e kontratës fillestare. Në çdo rast shtesa e kontratave nuk duhet të kalojë vlerën 20 për qind të vlerës së përgjithshme të kontratës fillestare.

4.1.5.2. Në vijim AK e ka saktësuar dispozitën ligjore në të cilën është mbështetur për të zgjedhur procedurën, që është neni 36/2/dh i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në të cilin është përcaktuar se ... *"Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës" është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret vetëm në rrethanat e parashikuara në nenin 33 të LPP.*
Autoriteti kontraktor mund ta përdorë këtë procedurë në kushtet e mëposhtme:
Kur zgjaten kontratat e shërbimeve ose punëve, nëse nevoja për punë/shërbime shtesë është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara, që nuk varen nga autoriteti kontraktor, dhe që nuk mund të ndahen, teknikisht ose ekonomikisht, nga kontrata fillestare, pa sjellë ndikime negative ose kosto të mëtejshme për autoritetin kontraktor, por që janë të nevojshme për përfundimin e kontratës fillestare. Autoriteti kontraktor mund ta përdorë këtë dispozitë vetëm me kusht që kontrata të lidhet me kontraktorin që po zbaton kontratën dhe vlera e plotë e kontratës shtesë të mos tejkalojë 20 % të vlerës së kontratës fillestare (përmbajtja e germës dh).

Nga përshkrimi i nenit 36/2/dh të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, rezulton se AK, për ndërtimin e një ure të re me emërtim "Ura e Sulovës" nuk gjendet në këtë nen, pasi nevoja për **punë shtesë,** nuk është shkaktuar nga *rrethana të paparashikuara, që nuk varen nga autoriteti kontraktor, dhe që nuk mund të ndahen, teknikisht ose ekonomikisht, nga kontrata fillestare, pa sjellë ndikime negative ose kosto të mëtejshme për autoritetin kontraktor.*
Ura e re e Sulovës e parashikuar me ndryshimin e projektit, ndodhet e shmangur nga aksi fillestar i parashikuar sipas projektit bazë.
Normalisht AK duhet të zhvillonte një procedurë të re prokurimi të llojit "I hapur".

KT është përgjegjëse për procedurën e zgjedhur, pasi e ka miratuar atë me vendim nr. 47, datë 8.7.2016.

4.1.**6.** *Parregullsi e konstatuar:*
Autoriteti kontraktor, bordi i menaxhimit, ka paraqitur në regjistrin e parashikimeve të prokurimit publik të vitit 2016 ndër të tjera edhe "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" "Shtesë kontratë" me vlerë 2,700,000 lekë (po kaq është realizuar), ndërkohë që AK (Këshilli teknik), nuk ka marrë në shqyrtim, nuk është shprehur për ndonjë "Shtesë punime", për projektin për "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" "Shtesë punimesh".

Argumentim:
BOE "RRR" sh.p.k. me shkresë numër "2016", datë 7.1.2016 (rreth 8 muaj më vonë nga miratimi i projektzbatimit përfundimtar), i ka kërkuar ARRSH nëpërmjet Mbikëqyrësit të punimeve "GGG" sh.p.k. "Shtesë kontrate" për objektin "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" (në ARRSH është protokolluar me nr. 41, datë 7.1.2016 me shënimin VVV, në cilësinë e duhur të ARSH, EEH në cilësinë e duhur, zj. AAL në cilësinë e duhur.
Sipas kësaj shkrese, për kryerjen e punimeve shtesë, përfshirë ndërtimin e një ure të re me dy korsi (ura e Sulovës) etj. kontraktori ka parashikuar rreth 150 milion lekë.

EEE me shkresë nr. 1466, datë 9.3.2016 i ka kërkuar z. AAA me detyrën e duhur, vlerën e plotë të objektit "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" "shtesë punimesh", i cili me shkresë nr. 7501, datë 25.8.2016 (rreth se rreth 5 muaj më vonë) i ka kthyer përgjigje, se vlera e plotë e këtij objekti është 208,200,000 lekë.
Vendosja e fondeve në regjistrin e parashikimeve publike vetëm me kërkesë të Kontraktorit, pa ditur nëse kërkesa e tij për shtesë kontrate, për "shtesë punime" do të miratohej, të çon në përfundimin se kjo procedurë tenderi ka qenë e paracaktuar për t'u zhvilluar, në mungesë të plotë të fondeve.

Në ndihmë të këtij përfundimi të çon edhe fakti që:
- Për vitin 2015 dhe 2016 çelja dhe realizimi i fondeve për kontratën bazë është rreth 451,000 mijë lekë, ose rreth 40 për qind ndaj vlerës së plotë të kontratës, kurse për "Shtesën e punimeve" janë çelur dhe realizuar 2,700 mijë lekë.

- Në përfundim të rakordimit "punime që shtohen" dhe "punime që zbriten" rezulton se nga preventivi i kontratës fillestare të hedhur në prokurim janë zbritur volume punimesh me vlerë rreth 60,278,674 lekë pa TVSH, të cilat janë përdorur për të plotësuar vlerën e nevojshme për ndërtimin e urës së re të Sulovës.

	Tabela e punimeve te zbritura në preventivin e Kontratës bazë				
Nr	Zeri i punimeve	Vlera në preventivin e Kontratës bazë	Vlera në preventivin e ndryshuar	Diferenca Lek	% Zbritur
I	**Viadukti prog 0+853**				
3	*Punime pilotimi (nenstruktura)*	44,350,927	26,984,924	17,366,003	39%
4	*Punime Armature Celiku*	119,132,952	86,536,208	32,596,744	27%
IV	**Punime në rrugë**				
4	Punime në KUB, KUZ	37,326,184	27,010,257	10,315,927	28%
	SHUMA ZBRITUR			60,278,674	

Kryesisht zbritja e volumit të punimeve përbëhet nga punime pilotimi dhe armature çeliku në vlerën 49,962,747 lekë pa TVSH për ndërtimin e viaduktit në progresivin 0+853 dhe punime në rrugë, , KUB dhe KUZ në vlerën 10,315,927 lekë pa TVSH. Vlera e zbritur prej 60,278,674 lekë pa TVSH është përdorur për të kompensuar ndërtimin e urës së re të Sulovës.
Sa më sipër e komprometon edhe më shumë ndryshimin e projektit fillestar, i cili është shoqëruar me rritje të ndjeshme të vlerës së kontratës.
Në të dy rastet e miratimit të projektit, Këshilli teknik ka qenë me përbërje të njëjtë.

4.1.7. Komente nga subjekti i audituar.
ARRSH me shkresë nr. 5,801/7, datë 18.7.2017 ka dërguar në KLSH një përmbledhje me "Observacione" për projektraportin, të cilat jepen në vijim sipas personave që i kanë bërë.

4.1.7.1. Koment nga z. Hamit Mustafa administrator i subjektit "GGG" në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve (shkresa nr. 5509, datë 4.7.2007).
Në preventivin e ripunuar të kontratës bazë në pjesën e dytë me emërtim "Ura e Sulovës" është parashikuar zëri "prishje struktura ekzistuese prej betoni"me vlerë 1,483,302 lekë, i cili nga grupi i auditimit është konsideruar dëm ekonomik... Ky zë punimi ka qenë në preventivin fillestar ... kështu që nuk është hartuar nga ana jonë... Ky zë punimi nuk është kryer dhe për rrjedhojë, nuk është likuiduar deri më sot, gjë që nuk përbën dëm ekonomik, megjithëse ky zë duhet realizuar për faktin se muret ekzistuese, pengojnë rrjedhën e ujrave të lumit \devoll, duke sjellë problem për pilat dhe shpatullat e urës.

4.1.7.2. Koment nga z. SSS dhe SSL specialist ARRSH, të cilët kanë miratuar preventivin (shkresa nr. 5709/14, datë 12.7.2017).
Krahas sa është trajtuar në pikën 4.1.7.1. ndër të tjera shtohet edhe ...
Zëri "prishje struktura ekzistuese prej betoni" është i parashikuar dhe ne preventivin e ripunuar te kontratës baze për faktin se ne shtratin e lumit aktualisht dhe sot (shih fotot përkatëse) këto struktura janë ne objekt te cilat kane ngushtuar ndjeshëm shtratin e lumit dhe për rrjedhoje ne raste te mëdha prurjesh do te kemi një ngritje te nivelit e ujit ne shtratin e lumit te cilat detyrimisht duhet te prishen dhe të evadohen pavarësisht nëse do te zbatohej projekti ekzistues (baze) apo projekti i ripunuar. Ne këto kushte ky zë punimi nuk ka lidhje me projektin e ripunuar dhe as nuk ka te beje me urën e re as me rikonstruksionin e urës se vjetër .

Faktor tjetër qe ky zë është parashikuar edhe ne projektin baze po ashtu dhe ne projektin e ripunuar është se këto struktura betoni janë te paqëndrueshme statikisht te cilat ne rastin e

ngritjes se nivelit te lumit Devoll mund te përmbysen duke dëmtuar seriozisht qëndrueshmërinë statike te urës që do të ndërtohet apo të urës që do të rikonstruktohej apo që do të zgjerohej.

Ne lidhje me konstatimin tuaj ne piken 2 te faqes nr 4 ku ju citoni;

..”Vendimi i KT nr. nr. 47, date 8.7.2016 është produkt i mbledhjes/procesverbalit te KT date 31.5.2016. Ky procesverbal i mbledhjes se KT nuk është I shoqëruar nga:

- Relacioni shoqërues i Drejtorisë/oficerit te projektit për përdorimin e fondit rezerve, i cili shpreh qarte shkaqet qe sjellin këto ndryshime, vlefshmërinë e tyre dhe qëndrimin e tyre pro ose kundër propozimit.

*- **Relacioni shoqërues** përgatitur nga drejtoria përkatëse/oficeri i projektit, ne rastin kur materiali i paraqitur kërkon shtese punimesh qe tejkalon vlerën e plote te preventivit te ofertës, (kërkon aplikimi n e shtesës se punimeve deri ne 20 për qind sipas ligjit a kushteve te kontratës) nuk jepen shpjegime te argumentuara e sqarohen saktësisht shkaqet qe bëjnë te nevojshme aplikimin e këtyre shtesave dhe nqs **janë identifikuar përgjegjësitë përkatëse** qe kane sjelle shtesën e punimeve…”*

Saktësojmë se Këshilli Teknik i ARRSH si organ i nivelit te larte teknik i cili rekomandon dhe këshillon Drejtorin e Përgjithshëm lidhur me çështjet teknike, si i tille ai vepron , shqyrton dhe miraton te gjitha problemet teknike qe dalin gjate ecurisë se aktivitetit te ARRSH. Si i tille ai mund te marre apo jo ne shqyrtim, te studioje apo te miratoje problemet dhe zgjidhjet teknike pavarësisht mendimeve apo propozimeve qe mund te vijnë nga jashtë këtij këshilli si nga specialistet e brendshëm apo te jashtëm si dhe çdo relator tjetër. Kur është e nevojshme ne mbledhjet e KT ftohen te marrin pjese dhe specialiste apo relatorë te drejtorive te ndryshme, natyrisht pa te drejte vote apo firme.

Kështu që përsa i referoheni rastit te mungesës se ndonjë relacioni ne protokoll, nëse kjo mund te rezultojë kështu, nuk ka te beje me vendimmarrjen ne shqyrtimin e propozimeve te ndryshme te karakterit teknik qe merren ne diskutim ne KT. Nëse nuk ka protokoll apo nuk gjendet apo ka mangësi , kjo ka te beje me anën formale te procesit te organizimit te mbledhjeve te KT dhe ajo qe ka rendësi dhe qe duhet marre ne çdo rast ne konsiderate është Vendimi i KT për çdo problem teknik qe ai shqyrton. Ne çdo rast qe dikush ka vërejtje apo objeksione ndaj vendimeve te KT, duhet t’i drejtohet vete këtij organi te nivelit te larte teknik dhe ligjërisht vendimmarrës.

Ajo çfarë ngrihet ne këtë akt-konstatim nuk ka te beje fare me këtë.

Do sugjeronim që, për shume probleme teknike qe Ju si Auditues, takoni gjate shqyrtimit te dosjeve me dokumente, te kërkoni mendimin e specialisteve te mirëfillte teknike pjesëmarrës ne aktivitetit e ARRSH për te dhëne një ekspertize te plotë teknike dhe te sakte çdo problemi teknik. Prezenca e këtyre specialisteve te cilët citoni si pjesëmarrës ne akt-ekspertim por qe një pjese e tyre nuk kane kontaktuar asnjë here me Ju, do te ishte mjaft e dobishme për vete procesin e punës se përbashkët.

Sqarim i audituesit.

Projekti i “Zgjerimit të urës së Sulovës” është pjesë e tenderit “Studim projektim riveshje sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë” fituar/realizuar nga BOE “PPN” & “GKK” me drejtues ligjor përkatësisht AA, me gradë shkencore prof. i asociuar dhe DD inxhinier, me vlerë të kontratës së lidhur 35,214,000 lekë, trajtuar gjerësisht në pikën 4.1. të këtij projektraport auditimi (specifikisht pika 4.1.3.).

Parashikimi i prishjeve të “strukturave të betonit ekzistuese”, ndërkohë që do të ndërtohet një urë e re në një aks tjetër rrugor, është i gabuar. Nën këtë arsyetim vlera e parashikuar prej **1,483,302 lekë** përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi mbikëqyrësin e punimeve subjektin “GGG” të përfaqësuar nga ing. HHM, BOE “RRR” sh.p.k. ing. SSL dhe SSP, të cilët kanë hartuar dhe miratuar këto zëra punimi.

Përfundimet e nxjerra, audituesi i ka mbështetur/konsultuar/dokumentuar veçanërisht me hartuesin e projektpreventivit të zbatimit të tenderit sipas pikës 4.1. të këtij projektraporti.

Lidhur me prezencën e specialistëve të ARRSH në akt ekspertim etj. të sugjeruar nga të audituarit, vlen të theksohet se ka qenë detyrim ligjor i të audituarve (ndryshuesve të projektpreventivit fillestar) të konsultoheshin me hartuesin e projektpreventivit të zbatimit të tenderit, i cili, pas verifikimit të dokumentacionit, rezulton se nuk është bërë (pika 4.1.1.5).

4.1.7.2. Komente (observacione) nga AAHi me detyrën e duhur, në cilësinë e anëtarit të KT (Shkresa nr. 5079/17, datë 14.7.2017).

Sqarim i audituesit.
Komentet (Observacionet) e AAH kanë përgjithësisht të njëjtën përmbajtje me komentet (observacionet) e paraqitura në projektraport, për akt konstatimin që është mbajtur për këtë qëllim.
Në argumentet e paraqitur nuk ka ndonjë element shtesë, ndaj atyre që janë trajtuar hollësisht në akt konstatim dhe projektraport, për rrjedhojë "Vërejtjet" *nuk qëndrojnë*.

4.1.7.3. Komente nga z. AAA me detyrë, në cilësinë e anëtarit të KT (shkresa 5801/4, datë 14.7.2107).
Në përgjithësi komentet (vërejtjet) përmbledhur sqarojmë se ... *profesioni im është jurist dhe prezenca ime në KT është për të ndjekur nëse mbledhja zhvillohet në përputhje me Rregulloren e Brendshme të funksionimit të ARRSH ... funksioni dhe detyrat e saj janë të përfaqësojë ARRSH në të gjitha nivelet e gjykatave... të ofrojë këshillim ligjor për specialistët e ARRSH ... të realizojë prokurimin e fondeve publike duke mundësuar realizimin e procedurave të prokurimit ... Nuk jemi në kundërshtim me pikën 7 të UKM nr. 2, datë 13.5.2005, pasi nga ana e sipërmarrësit nuk është ndryshuar me nismën e vet, por janë bërë propozime konkrete të cilat në KT janë përcjellë mbikëqyrësi I punimeve, për më tepër gjatë kohës që është paraqitur materiali në KT, realizimi në terren I punimeve ka qenë zero etj,* të kësaj natyrë të cilat nuk u konsideruan nga audituesi , me argumentet e paraqitur me hollësi në akt konstatim dhe projektraport.

4.2. "Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e korridorit Veri Jug dhe *lidhja me qytetin*" me fond limit 88,674,154 lekë, i zhvilluar në vitin 2016, disa të dhënat për të cilin janë si vijon:
Procedura është zhvilluar në datën 12/10/2016 në orën 13.00 (faza e pare, shprehje interesi me mjet elektronik)
Auditimi i ushtruar në procedurën të emërtuar "Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e korridorit Veri Jug dhe lidhja me qytetin".

Të dhënat mbi procedurën e prokurimit	**Komisioni i Njësisë së Prokurimit**	**Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**
a	***b***	***c***
Termat e referencës (termave teknike dhe llogaritjeve të vlerës së projektit) nr. 5131 prot, datë 17/06/2016 (ARRSH). Urdhër Prokurimi nr. 30, me nr. 5316 prot, datë 22/06/2016 (ARRSH). Urdhër nr. 30/1, me nr. 5316/2 prot, datë	***Njësia e Prokurimit Hartues*** ***Termat e referencës (termave teknike dhe llogaritjeve të vlerës së***	**KVO**

11/10/2016 (ARRSH). VKT të ARRSH-së nr 41, datë 09/06/2016 me vlerë të fondit limit 88 674 154 lekë, pa TVSH	***projektit)*** Hartues Miratues 1.	

Parregullsi të konstatuara:

Procedura*"shërbime konsulente"* (**prokurim elektronik**), me fonde publike, me objekt "Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e korridorit Veri Jug dhe *lidhja me qytetin*", me vlerë të fondit limit 88 674 154 lekë, pa TVSH **është bërë në kundërshtim**;

- Me Kontratën nr. 5310/4, datë 30/11/2011 "Ndërtimi i rrugës by pass Perëndimor", Shkodër Loti 1, si edhe me Kontratën me nr. 5311/4 datë 30/11/2011 "Ndërtimi i rrugës by pass Perëndimor", Shkodër Loti 2. (*ref. Nenit 690 t*ë *Kodit Civil "Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. ...).* Në projektin e zbatimit të hartuar nga "SPHAERA" shpk është realizuar qëllimi***"lidhja me qytetin"*** në jug.
- Me nenin 4, të ligjit 125/2013 "Për Koncensionet dhe Parteneritetit Publik Priva" (i ndryshuar).
- Me nenet 10, 55, të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit",
- Me VKM nr. 354, datë 11/05/2016 "Për Miratimin e Manualit te Tarifave për Shërbime në Planifikimin e Territorit, Projektimit, Mbikëqyrjes dhe Kolaudimit".
- Me nenin 8.1 "Këshilli Teknik" të "Rregullores së Brendshme të Funksionimit të ARRSH-së", të miratuar me Vendim të Bordit të Menaxhimit nr.4, datën 15/04/2016,
- Me nenet 1,2,29, 35, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar),
- Me nenet 38, 58 të VKM nr. 914, datë 29/12/2014 (i ndryshuar),
- Me Hartografinëe sistemittë Autoriteti Shtetëror të Informacionit Gjeohapsinor

Parashtrimet për të dhënë Argumentim

Për tëbërë arsyetimin do të zhvillojmë parashtrimet në dy grupime;

1) Me Grupin e hartuesve të termave të referencës (TR),"termave teknike dhe llogaritjeve të vlerës së projektit" dhe Njësisë së Prokurimit (NjP),
2) Me Njësinëe Prokurimit (NjP) dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO).

Më datën 17/06/2016 me nr. 5131 prot, të (ARRSH-së) janë hartuar Termat e Referencës (termave teknike dhe llogaritjet e vlerës së projektit), me objekt "Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e koridorit Veri Jug dhe *lidhja me qytetin*",miratuar me VKT të ARRSH-së nr 41, datë 09/06/2016 me vlerë të fondit limit 88 674 154 lekë, pa TVSH.

4.2.1. *Grupi i hartuesve të termave të referencës (TR),"termave teknike dhe llogaritjeve të vlerës së projektit" dhe Njësia e Prokurimit (NjP),*

TERMAT e REFERENCES (TR)

Paragrafi "Përshkrimi i Projektit"

Përshkrimi i projektit është krysisht për aksin rrugor nga hyrja e qytetit në jug dhe për 5 km lidhja në veri me rrugën në drejtim të Hanit të Hotit, ky quhet By Pass Perëndimor i Shkodrës, i cili ka patur qëllim që të realizoj kalimin tranzit pa hyrë në qytet. *Lidhur me këtëprojekt ky aks ka patur deformime të shumta duke ulur cilësinë e standartit, gjeometrin e këtij objekti.*
Këtu pershkruhet se *ky projekt nuk zgjidh në mënyrë përfundimtare dhe teknike kalimin e trafikut tranzit nga njëra anë e qytetit në tjetrën*!
Shpjegohet që*"lidhja me qytetin"* e në vijim me rrugën nacionale Shkodër Tiranë nuk është realizuar me projektin "By Pass Perëndimor i Shkodrës".
Kjo që kërkohet në këto Terma Reference, *por që nuk limitohet vetëm në këtë*, është lidhja e "By Pass Perëndimor i Shkodrës" merrugën nacionale Shkodër Tiranë.
Ajo c'farë kërkohët në këto Terma Reference ë*shtë jo vetëm kjo*, sepse një konsulent i kujdesshëm dhe me eksperiencë*mund t*ë *ofroj edhe zgjidhje t*ë *tjera p*ë*rsa i p*ë*rket*ë *k*ë*saj detyre duke zhvilluar nj*ë *aks q*ë *nuk p*ë*rdor fare, By Pass Perëndimor n*ë *pik*ë*n e fillimit, por q*ë*mund t*ë *lidhet me t*ë *n*ë *piken fundor t*ë *tij, n*ë*dalje veriore t*ë *qytetit, af*ë*rsisht n*ë *km 4 t*ë *saj*!.

Varianti për efekt vlerësim projekti

ARRSH *për vlerësimin e llogaritjeve të vlerës së kësaj kontratë* ka marë në konsideratë (si projekt-ide), ndërtimin e një aksi (6 km para hyrjës në Shkodër ref. një ortofoto përshkruar *600 m urë* përgjat lumit Drin kalon të dyja brigjet njëkohësisht edhe lumin Kir *130 m urë*, nëpër shtratet e këtyre lumenjëve, si edhe me një tunel kalon kodrën në veri të kalas me rreth *(2*690 m tunel)* dhe kërkohet të lidhet me By Pass Perëndimor të Shkodrës. *Gjatësia e kësaj* ***projekt-ideje*** *nga ortofoto është parashikuar* ***3.6 km***. (*variant*)
*Variant tjet*ëri mundshem të cilin mund ta marrë në *konsideratë një konsulent i kujdeshëm*!, është varianti që pikën e lidhjes me koridorin "Veri-Jug" e ka të njëjtë*por mbasi anashkalon qytetin anash rrjëdhës së Lumit Kir, intersekton atë diku nga km 5 dhe për 5 km të tjera* ***(10 km)*** *lidhet me aksin e Koplikut*. Gjithsesi Konsulenti do të marrë në konsideratë dhe do të zhvilloj cdo variant që ai e konsideron të arsyeshëm, fizibël dhe teknik më të arirë.

Paragrafi "Objekti"
Objektivi i përgjithshëm i studimit është përgatitja e projektit të plotë *(studimi i fisibilitetit, projekt ide dhe projekt zbatimi)* në *disa variante* nga të cilët do të zgjidhen *jo* më *pak se dy variante* të vlerësuara maksimalisht në lidhje me efektshmërinë tekniko-ekonomike dhe mjedisore, ...rrugë kategoria A. *Gjithashtu në këtë objektiv përfshihet dhe ristudimi i projektit ekzistues të "By Pass Perëndimor i Shkodrës" mënyrën e lidhjes me projektin e filluar tashme në fazë të ndërprerë zbatimi, rishikim i gjurmës së tij, planimetrisë dhe parametrat gjeografik të tij,**në dy variante të tij** ....!*

Kosto e Projektit
Për llogaritjen e vlerës së projektit "*lidhja me qytetin*" e "By Pass Perëndimor të Shkodrës" me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë, e kerkuar si rrugë kategoria "A".
Gjatësia e kësaj **projekt-ideje** nga ortofoto është **3.6 km** sipas "ARRSH"-së, me vlerë ndërtimore totale 3,490,000,000 lekë prej të cilave (vlera ndërtimore punime, transporti 1,040,000,000 lekë dhe tunel 2,450,000,000 lekë për (2 x 0.69 km).
Llogaritjet janë bërë në bazë të VKM nr. 354 datë 11/05/2016 për cmimin e shërbimit, kurse për koston nuk është bërë asnjë Analizë Teknike (ref VKM-së përkatëse).

Vlera totale e shërbimit është llogaritur për zërat e punimeve të projektimit si më poshtë, për të parën me katër faza (II, III, V, VI, përjashtuar I, IV dhe VII) Tuneli, me pesë faza (II, III, IV, V, VI, përjashtuar I dhe VII) Strukturat e Transportit;për tëdytën me pesë faza (II, III, IV, V, VI, përjashtuar I);për të tretën me tre faza (II, III, IV, pa përjashtuar);

1.	Trarifa e shërbimit për strukturat e transporti dhe qarkullimit (ura dhe rrugë) dhe veprat inxhinierike(Tuneli)	78,764,840	lekë
2.	Rilevime topografik	6,786,363	lekë
3.	Studim i nëntokës punime nënthemel (gjeologjik)	3,074,000	lekë
4.	Studim Mjedisor	48,952.24	lekë
TOTAL (pa TVSH)		**88,674,154.74**	lekë

DOKUMENTAT STANDARDE (DS)

Në datën 28/09/2016 PV 1, NjP ka miratuar dokumentat standarte, me objekt "Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e koridorit Veri Jug *dhe lidhja me qytetin*", me vlerë të fondit limit 88 674 154 lekë, pa TVSH.
NjP ka përzgjedhur llojin e procedurës *"shërbime konsulente"* (prokurim elektronik) mbi arsyen e Urdhërit të Prokurimit nr. 5316 prot., datë 22/06/2016, në vijim është arsyetura lidhur me LPP, si edhe VKM 914 "...rregullorja e prokurimit...", si edhe ka përpiluar kriteret e veçanta të kualifikimit mbi pervojen e mëparshme, kapacitet ekonomike dhe financiare, kapacitetet teknike dhe profesionale, kriteret e vlerësimit.

DS, Njoftimi i Kontrates;
pika 2.8 Do të pranohen variante (*nuk është përzgjedhur Opsioni*),
pika 2.8.1 Do të pranohen nënkontraktim (*nuk është përzgjedhur Opsioni*) ndërkohë është shprehur me *poshtë që lejohet deri**40 %**,* si edhe nuk është përcaktuar që *AK do t'i bëj apo jo pagesë nënkontraktorit*,
Pika 3.2 Sigurimi i Ofertës nuk kërkohet nga AK,
Pika 4.3 Afati kohor për *dorëzimin* e kërkesës për shprehje interesi; data 12/10/2016, ora 13.00
Pika 4.4 Afati kohor për *hapjen* e kërkesëspër shprehjen e intresit;data 12/10/2016, ora 13.00

Kriteret e Veçanta;

Përvoja e mëparshme, ofertuesi duhet te kete realizuar shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet, me vlerë jo më të vogël se 25%të vlerës së llogaritur të kontratës që prokurohet, realizuar me sukses gjatë tre viteve të fundit.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar, kopje tëçertifikuara të bilanceve të dy viteve të fundit (2014,2015), të paraqitura në autoritetet përkatëse, dhe kopje të deklaratës së xhiros vjetore të të dy viteve të fundit (2014,2015), me vlerën mesatare jo më të vogël se 88000000 lekë të kontratës që po prokurohet.

Kapacitet teknik dhe profesional, ofertuesi duhet të dorëzoj liçensën profesionale të shoqërisë dhe të drejtusve teknik për projektim, të përcaktuara në kategoritë si më poshtë; 6/b,6/c,6/d,7/b,7/d,8/a,8/b,9/d, 9/e,11/a,11/b, si edhe inxhinier me license projektimi 2/d. Listë me personelin, dëshmi për fuqinë puntore me numër punonjësish jo më pak së 25 vetë.Certifikatë ISO 9001;2008 dhe ISO 14001;2004 ...,

Kriteret e Vlerësimit teknik		Pikët
(i)	Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit	[0-10]
(ii)	Metodologjia e Propozuar	[20-50]
(Përqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)		
(iii)	Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar	[0-30]
(iv)	Transferimin e Njohurive, (*nëse kërkohet*)	[0-10]

Transferimin e Njohurive nuk do të kërkohet. Pikët nga 0-10 ndahen përpjesëtimisht!, kritereve të sipërcituara, Minimumi i kualifikimit është 70 pikë

Sa referuar (mbi **TR**), më lartë **QËLLIMI** është "*lidhja me qytetin*" ne jug, të "By Pass Perëndimor të Shkodrës" me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë. Dhe objekti i kësaj kontrate është përgatitja e projektit të plotë*"studimi i fisibilitetit"* me përmbajtje përcaktimi me të dhëna për trafikun survejim edhe analizë, projekt inxhinierik analizë materjalesh, gjeoteknik, gjeologjik, hidrologjik, vlerësim shtresash etj, si edhe raport të thëlluar të VNM-së përfshirë edhe vlerësim Social, si edhe *Planin e Biznesit* duke vlerësuar, përqindjen vjetore të kthimit të investimit, fitimin vjetor neto, raportin kosto fitim, analizën e ndjeshmërisë dhe riskut në shumë aspekte,*projekt ide, projekt zbatimi, preventivi përfundimtar),*është kërkuar edhe (*projekti për paisjen me leje, si edhe përgatitja e dokumentacionit për procedurën e tenderimit*), plotë 7-ë Fazat e projektimit të strukturave të transporti dhe veprave inxhinierike. Në këto terma refence kërkohet një punë e cila është kryher për projektimin si edhe është në fazën e zbatimit. Ndryshimi i gjurmës së projektit që është në ndërtim "By Pass Perëndimor të Shkodrës", kjo gjë e bën të pa vlefshme këtë procedurë.

- Autoriteti Kontraktor është në kundërshtim me, Kontratën nr. 5310/4 datë 30/11/2011 "Ndëertimi i rrugës by pass Perëndimor", Shkodër Loti 1, si edhe me Kontratë "nr. 5311/4 datë 30/11/2011 Ndërtimi i rrugës by pass Perëndimor", Shkodër Loti 2. (*ref. Nenit 690 të Kodit Civil "Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. ...).* Në projektin e zbatimit të hartuar nga "SPHAERA" shpk është realizuar qëllimi **"*lidhja me qytetin*"** në jug për të cilën është bërë kjo procedure ë**shtë mbivendosje**.

Ideja e këtij prokurimi ka lindur si rezultat i mos realizimit të plotë të ndërtimit të "By Pass Perëndimor të Shkodrës" i cilaështë në fazë zbatimi dhe është ***pezulluar !!!,*** *përshkruhet në termat e referencës. C'ka do të thotë që projekti nuk ka dhënë akoma rezultatin për qëllimin e ndërtimit.*

Nga informacioni i mbledhur ka rezultuar që projekti për ndërtimin e "By Pass Perëndimor të Shkodrës"është i plotësuar edhe me dy elementët lidhës me qytetin e Shkodrës në Jug dhe nëVeri.

4.2.2.Kontratë nr. 5310/4 datë 30/11/2011 Ndërtimi i rrugës by pass Perëndimor, Shkodër Loti 1. Ref. DS "*Projekti i objektit është hartuar nga shoqëria SPHAERA në mbështetje të ToR, përgatitur nga DPRR dhe miratuar me Vendim të KT. Loti 1, ndërtimi i gjysmzs së gjerësisëtë rrugës me gjatësi prej 4.9 km (ref projekt zbatimit (1dhe3 PZ) 472 m lidhja me qytetin nga jugu në drejtim të Tiranës (1)dhe 4432 m në drejtim të Hanit të Hotit nga veriu ..."Kontraktuar JV "AR" shpk & "DE"shpk & "EU"shpk vlera e projekti 1,447,446,358 lekë, (janë paguar deri më tani afërsisht 590,246,268 lekë, pagesa e fundit është bërë me datë 22/04/2015, 40.778 % e vlerës).*

4.2.2. Kontratë nr. 5311/4 datë 30/11/2011 Ndërtimi i rrugës by pass Perëndimor, Shkodër Loti 2. Ref. DS
"*Projekti i objektit është hartuar nga shoqëria SP në mbështetje të ToR, përgatitur nga DPRR dhe miratuar me Vendim të KT. Loti 2, ndërtimi i rrugës me gjatësi prej 1.7 km gjerësi 14 m lidhja nga jugu në drejtim të Tiranës (2) ..."Kontraktuar "DD" shpk, vlera e projektit 454,574,936 lekë, (jane paguar deri më tani afërsisht 144,575,181 lekë, pagesa e fundit është bërë më datën 24/06/2014, 31.80% e vlerës),*

Për më shumë shiko vizatimet e kësaj procedure, si edhe informacion nga ASIG,

Ortofoto nga projekti i zbatimit "By Pass Perëndimor të Shkodrës" dhe lidhja me qytetin shkodër Hartuar nga JV "SPAHERA" shpk&"G&K"shpk

Nga Raporti Teknik studim projektimit përndertimin e rrugës"BYPAS_i PERENDIMOR SHKODER" në zbatim të "termave të referencës është projektuar *dhe lidh hyrjen e qytetit të Shkodrës* në anën perëndimore të saj, me daljen e saj derri në lidhje me rrugën Shkoder –Han i Hotit. By Pass-i perëndimor i qytetit të shkodrës përkon me së miri dhe me studimin urbanistik...Objektivi ...***hartuar projekt ideja dhe projekt zbatimi të rrugës e cila do të lidhë hyrjen e qytetit të Shkodrës nga jugu me hyrjen e qytetit nga veriu duke lidhur njëkohësisht edhe rrugën Tiranë-Shkodër me rrugën Shkodër Han i Hotit. Gjithashtu të një rruge e cila***

***do të shërbej si një tangenciale apo unazë perëndimore që do të lidhet dhe me sistemin e brendshëm rrugor të qytetit*"**

Plani nga projekti i zbatimit "By Pass Perëndimor te Shkodrës" dhe lidhja me qytetin Shkodër Hartuar nga JV "SP shpk & "GK"shpk (jugu, veriu)

✓ Termat e referencës (termave teknike dhe llogaritjeve të vlerës së projektit) nr. 5131 prot, datë 17/06/2016 (ARRSH-se), **me qëllimin *"lidhja me qytetin"*** në jug, të "By Pass Perëndimor të Shkodrës" me rrugën nacionale Shkodër-Tiranë, **bie në kundërshtim (apo mbivendosje)** me procedurën e realizuar sa me sipër, d.m.th. me vetë projektin për ndërtimin e "By Pass Perëndimor të Shkodrës" **që ka patur për qëllim edhe lidhjen me qytetin**. Hartuesit e termave të referencës bien në**kundërshtim më qëllimi e vetë këtyre termave** pasi *kërkesa është për lidhjen me qytetin*, dmth të rrugës Tiranë-Shkodër me "By pass-in", ndërkohë *trasimi i gjurmës i pranuar si projekt ide është me gjatësi 3.6 km*, dmth **një rrugë tjetër paralele deri sa bëhet njëlidhje me rrugën ekzistuse me tunel në lindje të kalasë së Rozafes dhe me ura për kalimin e lumit Kir dhe Drin me gjatësi të konsiderushme**. *C'ka do të thotë që nuk është domosdoshmëri të bëhet kjo rrugë, por vetëm lidhja me qytetin*.

➢ Autoriteti Kontraktor është në kundërshtim me germën a), të pikës 1, të nenit 4 "Fusha e Zbatimit ...", të ligjit 125/2013 "Për Koncensioneve dhe Parteneritetit Publik Priva" (i ndryshuar). Sepse ka kërkuar studim fisibiliteti të thelluar si edhe plan biznesi, për këtë qëllim nuk mund të bëhet biznes.

➢ Autortiteti Kontraktor është në kundërshtim me nenin 10 "Përgjegjwsitë e Ministrive të Tjera", nenin 55 "Organizimi dhe Funksionimi i Rregjistrit", të ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", si edhe me VKM-së nr. 354, datë 11/05/2016 "Për Miratimin e Manualit të Tarifave për Shërbime në Planifikimin e Territorit, Projektimit, Mbikqyrjes dhe Kolaudimit". *Sepse për "projekt-iden e trasuar", përmasa e gjatësisë së gjurmës nuk është e saktë, pasi nuk është ndërtuar sipas Sistemit Koordinativ Shtëtror është në kundërshim me Hartografinë e hedhur në sistem nga Autoriteti Shtetror i Informacionit Gjeohapsinor. (referuar trasës sipas vijës së projekt-ides së TR, gjatësia është afërsisht **2550 m (nga 3600 m**).*

Në termat e referencës janë aritur të bëhen, analizat e detyrës së projektimit dhe përcaktimi i bazës së projektit. (Ref. VKM-sënr. 354, date 11/05/2016) është kërkuar projekti i plote *"studimi i fisibilitetit"*me përmbajtje përcaktimi me të dhena për trafikun survejim edhe analizë,

projekt inxhinierik analizë materjalesh, gjeoteknik, gjeologjik, hidrologjik, vlerësim shtresash etj, si edhe raport të thelluar te VNM-së përfshirë edhe vlerësim Social, si edhe *Planin e Biznesit* duke vlerësuar, përqindjen vjetore të kthimit të investimit, fitimin vjetor neto, raportin kosto fitim, analizën e ndjeshmërisë dhe riskut në shumë aspekte. Në vijim kanë zhvilluar analizën e detyrës dhe llogaritjet e vlerës së shërbmit për këtë gjurmë (ura, tunele).

✓ Hartuesit (TR) kanë kërkuar shërbim për"*studim fisibilitetitë thëlluar si edhe plan biznesi"*e cila në këto kushte nuk është e nevojshmë, sepse **lidhja me qytetin është domosdoshmëri**, si edhe për faktin që nuk do të **bëhet biznes sepse nuk do të vendoset "tra".**AK është në kundërshtim *me ligjit 125/2013 "Për Koncensioneve dhe Partneritetit Publik Priva" (i ndryshuar), nenin 4, "Fusha e Zbatimit, pika 1 "koncensionet/partneriteti publik privat mund të jepen për realizimin e punimeve dhe ose shërbimeve sektorët dhe qëllimet e mëposhtme, gërma a) transport ...rrugët...*Hartuesit me këtë analizë të detyrës së projektimit,qëkanë aritur në përcaktimin e bazës së projektit (3.6 km), *janë pozicionuar vete në fazën e parë të projektimit*, (RefVKM-se nr. 354, datë 11/05/2016), por edhe kanë tejkaluar këtë fazë pasi e konsiderojnë projekt ide (faza II) për të cilën kanë bërë edhe llogaritjet e vlerës së shërbimit.
Hartuesit e termave **bien në kundërshtim pasi nuk kanë gjetur** kushtet për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimi, **por këtë ja kanë kërkuar Ofertuesve**, **si edhe shërbimet bazë dhe të veçanta**. *Kjo është në kundërshtim meVKM-nënr. 354, datë 11/05/2016, neneve "36" Fazat e projektimit të veprave inxhinierike, faza e parë, "37" Shërbimet për planifikimi e objekteve inxhinierike dhe të komunikacionit, pika 1, (i.gërmat, a deri e si edhe ii.gërmat, a,b,) analizat e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit, (për rrugën dhe urat) "42"Faza e projektimit të Strukturave të transporit sipas tipologjise së shërbimit, faza e parë, "43", Shërbime për planifikimin e strukturave të transportit sipas tipologjisë së shërbimit, pika 1 analizat e detyrës së projektimit/termave të referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit, gjetja e kushteve për zgjidhjen e detyrës nëpërmjet planifikimit (për tunelin).*

Në termat e referencës është kërkuar edhe *projekt ide, projekt zbatimi, preventivi përfundimtar* është kërkuar edhe *projekti për paisjen me leje, si edhe përgatitja e dokumentacionit për proceduren e tënderimit*, plote 7-t. Fazat e projektimit të strukturave të transporti dhe veprave inxhinierike. Në llogaritjen e vlerave totale të shërbimit janë llogaritur për zërat e punimeve të projektimit si me poshtë, për të parën me katër faza (II, III, V, VI, përjashtuar I, IV dhe VII) Tuneli, me pesë faza (II, III, V, VI, përjashtuar I,IVdhe VII) Strukturat e Transportit;për të dytën me pesë faza (II, III, IV, V, VI, përjashtuar I);për të tretën me tre faza (II, III, IV, përjashtuar I).
✓ Hartuesit (TR) kanë kërkuar shërbimet e sipër përmendura, por nga llogaritjet e vlerës kanë përjashtuar shërbimin apo shmangur*"Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit"* faza IV dhe për "Përgatitjen e dokumentacionit për proceduren e tenderimit" faza VII.*Kjo është në kundërshtim me vetë termat e referencës pasi ky shërbim është kerkuar dhe mund të lind pretendim nga ofertuesi, për shtesë në vlerën e projektit*. Shmangia e sipërpërmendur si edhe lidhja që kërkohet e ofertuesit me autoritetet shtetore qëndrore dhe vendore, për të kerkuar informacion apo projekte, studime, miratime planesh etj, te konsideruara ne TR, si ***"supozime dhe risqe"****që mund të ndërhyjnë me projekt,* ***apo shmangiet e cojnë këtë projekt në pamundësi zbatimi****. AK është në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", nenin 10 "përgjegjësitë e ministrive të tjera" pika 1 dhe 2 "...ministritë dhe organet e tjera publike qëndrore sigurojnë dhe zhvillojnë burimet e nevojshme, njerëzore e profesionale, për planifikimin e territorit,kontrollin e zhvillimit, menaxhimin e tokës e të mjedisitdhe administrimin e rregjistrit, si edhe në vijim me procedurën e marrjes së lejës së ndertimit..., si*

edhe të regjistrimit të saj në ZVRPP), si edhe në kundërshtim me ligjin nr. 8402, date 10/09/1998 "Për Kontrollin e disiplinimit të punimeve të Ndërtimit" (i ndryshua), në vijim të procedurave për dokumentacion të rregulltligjor dhe teknik, con në pamundësi të plotesimit të tyre nga mbikqyresi dhe kolaudatori, nga shërbimi urbanistik, regjistrimi i pasurise,etj.

✓ Hartuesit (TR) janë në kundershtim për "vlerën e llogaritur ndërtimore", pasi nuk kanë bërë Analizë Teknike për punimet e parashikuara (rruge, ura, tunele, etj.) për të llogaritur cmimin për njesi *(ref Manualit 2015). Për projekt-iden e trasuar, përmasa e gjatesisë së gjurmës nuk është e saktë, pasi nuk është ndërtuar sipas Sistemit Koordinativ Shtetrorështë në kundërshim me Hartografinëe hedhur ne sistem nga Autoriteti Shtetror i Informacionit Gjeohapsinor*.(refereuar trases se trasuar sipas vijes se projekt-ides se TR, **gjatësia është afërsisht 2550 m (nga 3600 m).**

➢ Autortiteti Kontraktor (KT) është në kundërshtim me nenin 8.1 "Keshilli Teknik" të "Rregullorës së Brendshme të Funksionimit të ARRSH-së", te miratuar me Vendim të Bordit te Menaxhimit nr.4, datën 15/04/2016, si edhe menenet 29, 35, të ligjit nr. 9643, date 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) dhe nenit 38, te VKM nr. 914, date 29/12/2014 (i ndryshuar), nenit 7, te VKM nr. 354, datë 11/05/2015.

NjP ka përzgjedhur llojin e procedurës *"shërbime konsulece"* (prokurim elektronik) ***mbi arsyen!*** e Urdhërit të Prokurimit nr. 5316 prot., datë 22/06/2016 te ARRSH-së, në vijim është arsyetura lidhur me LPP, si edhe VKM nr. 914 "...rregullorja e prokurimit..." . Hartuesit TR dhe NjP **kanë aritur të lidhen** me këtë formë procedurepër përzgjedhjen e kontratës së prokurimit publik ***"shërbime konsulence"***me***"fandin limit".*** *Pasi kjo lloje procedure deklaron fondin limit dhe AK përgatit vlerën e kostos dhe buxhetin. Në vijim për të realizuar preventivin bazohet në vlerësimin që AK, u bën burimeve që i nevojiten për të përmbushur detyrën; kosto për stafin, mbeshtetja logjistike dhe inputi fizik. Kostot ndahen ne dy kategori kryesore; tarifa ose shpërblimi dhe rimbursimet,* (ref. gërmes a, pikës 4, te nenit 37 "Shërbime Konsulence" , VKM nr. 914 "...rregullorja e prokurimit..."). Shërbimet e konsulences janë specifikuara *si shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese*.

✓ Hartuesit e (TR) dhe (NjP),janë në kundërshtim me nenin 8.1 "Këshilli Teknik"të "Rregullorës së Brendshme të Funksionimit të ARRSH-së", të miratuar me Vendim te Bordit të Menaxhimit nr.4,datën 15/04/2016ku thuhet *"Këshilli Teknik është organ rekomandues dhe këshillues pranë drejtorit të përgjithshëm lidhur me c'është teknike....Qëllimi i tij kryesor është t'i rekomandoj drejtorit të përgjithshëm ....të asistencës teknike në fushën e ndërtimeve rrugorë dhe veprave të artit që lidhen me to., ... Duke qënë një veprimtar e një niveli tëlartë shkencor, tekniko- ekonomik, juridik në fushën e veprimtarisë së ARRSH-së, dhe që ka të bëj metrajtimin teknik të problemeve kryesore...."*
C'ka do te thotë"*Shërbim Konsulencë*" është **detyrë e Këshillit Teknik**, i cili ka në përbërje të tij specialist të nivelit te lartë shkencor (*intelektual*), të cilët kanë për detyrë të japin *këshillime* teknike ne fushën e ndërtimeve rrugore dhe veprave të artit.

✓ Hartuesit e (TR) dhe (NjP), janë në kundërshtim me, nenet1, 29, 35, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), gërmave c, ç, të pikës 2 (nenit 1), *objekti dhe qëllimi, të nxisë pjesmarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurencën ndërmjet operatoreve ekonomike*, gërmën d), të pikës 1 (nenit 29), *për procedurën standarte të prokurimit* ***d) konkurs projektimi***, dhe pikes 1 (nenit 35) *AK mund të organizojë konkursin projektimit, si pjese e një procedure që con në përzgjedhjen e kontratës fituse, për njëplan apo projekt të zgjedhur nga një juri, mbi bazën e një procedure*

konkurimi, kryesisht në fushën e planifikimit urban, rural,arkitektonik, inxinierik, etj. ***Gërma b), pika 2,****<u>**për përfitimin vetëm të projektit kundrejt cmimit**</u>*, *si edhe në vijim të* nenit 38, të VKM nr. 914, datë 29/12/2014 (i ndryshuar), ku thuhet në gërmën a), pika 3 *Titullari i AK apo personi i i autorizuar nxjer urdhërin e prokurimit .....Për këtë lloj procedure prokurimi , urdhrëri i prokurimit* ***nuk përmban fond limit****.*

✓ Hartuesit e (TR) dhe (NjP), janë në kundershitm edhe me VKM nr. 354, datë 11/05/2015, në nenin 7, pika 7 thuhet; *në rastin <u>e uljes se konsiderueshme të kostove të llogaritshme</u>, që vijne si rezultat i <u>punës tekniko-shkëncore</u>, ose si zgjidhje të një ndikimi pozitiv në mjedis dhe që nuk ulin standartin e veprës të përshkruar në kontratë, mund të merret në konsideratë pagimi i një "tarife sukses" ...*

C'ka do të thotë që realizimi i konkursit mund të sjellë zgjidhje të shumta dhe mund të përzgjidhej projekti më i mirë me kosto më të ulet (ndërtimi si rrjedhim edhe shërbimi).Ref. TR vete hartuesit kërkojnë që ofertuesi të paraqesë disa variante, si edhe jo me pak se dy do të përzgjidhen, c'ka nënkupton **që ofertuesi fitues do të bëj konkurs projektimime veten e vetë minimalisht ne tre variante**. Realizimi i projektit të zbatimit në disa variante është i pamundur dhe jashtë cdo llogjike intelektuale dhe këshillues.

✓ Referuar rekomandime të KLSH-se, ka kërkuar pezullimin e llojit të procedurës "Shërbime Konsulence", ARRSH-së.

2) Njësisa e Prokurimit (NjP) dhe Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO).

KVO dhe NjP, me PV nr.2, datë 12/10/2016 është bërë hapje e procedurës së prokurimit me mjete elektronike, operatoret ekonomik ofertues janë; **1**. IN, **2**. ILL **3**. GG, **4**. EK **5**. S.S.D, **6**. CCE **7**. GGG.

Me PV nr. 3, date 26/10/2016 eshte bere vleresimi ne sistem i kerkesave per shprehje interesi, te paraqitur nga operatoret ekonomik, KVO–ja, ka vendosur t'i drejtohet me ftese operatoreve te kualifikuar; **1**. GGG, **2**. JV & AV & A.L & GE", **3.** JV & IL & IT & A.SH".

v.o.

1. "GGG" shpk *<u>ploteson kriteret</u>*;
2. "IN shpk, & IN shpk, & AV, & A.L shpk, & GE. shpk" *<u>ploteson kriteret</u>...*: por me koment; ***Certifikata ISO 9001:2008****e paraqitur nga AV, pas verifkimit te bere online sic parashikon organi i leshimit te saj,* ***rezulton e pavlefshme****, por* ***KVO*** *e konsideron devijon te vogel (dhe* ***<u>nuk e skualifikon</u>****);*
3. "47 EK 79 & ILIRIADA P.K.S shok, & ITM shpk, & A.SH ENGINEERING shpk"*<u>ploteson kriteret</u>*;
4. "GE shpk, & GR shpk" *<u>nuk ploteson kriteret</u>*: te pervojes, ..., ***Certifikata ISO 9001:2008, 14001:2004*** *e paraqitur nga GG, pas verifkimit te bere online sic parashikon organi i leshimit te saj,* ***rezulton e pavlefshme.***
5. "ILL shpk & LO shpk"*<u>nuk ploteson kriteret</u>*: ligjore, ekonomike dhe financiare, te pervojes, ..., ***Certifikata ISO 9001:2008,*** *afat deri 25/09/2015****, 14001:2004*** *e paraqitur nga Ill, pas verifkimit te bere online,* ***rezulton e pavlefshme.***
6. **"**S.S.D" shpk nuk ploteson kriteret: *<u>nuk ploteson kriteret</u>*: nuk ka derguar dokumentat.
7. "CO" shpk*<u>nuk ploteson kriteret</u>*: sherbimet te ngjashme, licensat profesionale, ***Certifikata ISO 14001:2004*** *e paraqitur, pas verifkimit te bere online sic parashikon organi i leshimit te saj,* ***rezulton e pavlefshme.***

OE kanë bërë vërejte për mënyrën e vlerësimit nga KVO si më poshtë:

Ankesë F.F. me nr. 8919, datë 01/11/2016, perfaqesues i JV "IN & IF & AV & A.L & GE". Ne pergjithesisht me argumentin rreth termave "Studim Fisibiliteti" dhe "Stubim", per te cilin eshte kerkuar nga TR "per kryerjen e te gjitha hetimeve dhe investigimeve e nevojshme per te bere te mundur pergatitjen e dorezimit te studimit te fisibiliteti final te kerkuar" .... Me daten 03/11/2016 me nr. 8919/1 prot., eshte urdheruar pezullimi i procedures dhe eshte ngritur grupi i shqyrtimit te ankese. Komisioni i shqyrtimit te ankese ka kthyer pergjigje nr. 8919/2 prot date 11/11/2016 dhe nuk ka pranuar ankesen e bere nga operatori, si edhe eshte njoftuar operatori me nr. 8919/3 prot., date 14/04/2016.

Ankesa 2

Me daten 02/11/2016me nr. 9025 prot., GX perfaqesues "GR" shpk, ka paraqitur ankese pran AK, me argumentin e egzistences se pervojes nepermjet nje kontrate me "BBB",....Me daten 04/11/2016 me nr. 9025/1 prot., eshte urdheruar ne vijim te pezullimit te procedures dhe eshte ngritur grupi i shqyrtimit te ankese. Komisioni i shqyrtimit te ankese ka kthyer pergjigje nr. 9025/2 prot date 11/11/2016 dhe nuk ka pranuar ankesen e bere nga operatori, si edhe eshte njoftuar operatori me nr. 9025/3 prot., date 14/04/2016.

v.o.

Me daten 22/11/2016 me nr. 5316/4 prot., eshte bere ftesa per propozim te operatoreve ekonomik.

Me PV nr. 4, date 07/12/2016 ne oren 13.00, KVO ka pranuar ofertat me porpozimet teknike dhe ekonomike, te tre operatoret ekonomik te kualifikuar kane dorezuar dokumentacionin e kerkuar.

Me PV nr. 5, date 16/12/2016 ne oren 11.00, KVOka bere vleresimin e propozimeve teknike:

"GJEOKONSULT % CO" shpk

Anetrai i KVO-se	Pervoja ne pune te ngjashme 0-10	Metodologjia e propozuar 20-50	Stafi 0-30	Transferimi i njohurive	Totali 100/90
1	10	48	26		93.33
2	8	45	25		86.66*(7)*
3	8	40	27		88.88*(3.33)*

Pas vleresimit individual me kriter pikezimi nga 0-100, operatori i mesiperm u vleresua me piket mesatare 89.62 pike*(87.78)*

"IN shpk, & IN shpk, & AV shpk, & A.L. shpk, & GE shpk"

Anetrai i KVO-se	Pervoja ne pune te ngjashme 0-10	Metodologjia e propozuar 20-50	Stafi 0-30	Transferimi i njohurive	Totali 100/90
1	7	35	22		71.11
2	6	35	25		73.33
3	7	35	26		75.55

Pas vleresimit individual me kriter pikezimi nga 0-100, operatori i mesiperm u vleresua me piket mesatare 73.33 pike

"GK & IL, & IT shpk, & A.S. shpk"

Anetrai i KVO-se	Pervoja ne pune te ngjashme 0-10	Metodologjia e propozuar 20-50	Stafi 0-30	Transferimi i njohurive	Totali 100/90

1	9	33	25		74.44
2	8	35	25		75.55
3	8	35	24		74.44

Pas vleresimit individual me kriter pikezimi nga 0-100, operatori i mesiperm u vleresua me piket mesatare 74.81 pike

Ankesa 3
Me daten 22/12/2016 me nr. 10545 prot., z. F.F perfaqesues i JV "IN & IN & AV & A.L. & GE", kane paraqitur ankese pran AK. Ne piken e pare vazhdon ankesa mbi argumentin rreth termave "Studim Fisibiliteti dhe projektim" dhe "Studim". Ne piken e dyte ankesa eshte per operatorin qe eshte vleresuar me me shume pike lidhur me kualifikimin dhe kapacitetet teknike. Ne piken e trete ankesa eshte per KVO- ne, *qe ne perberjen e tij nuk ka ekspert te fushes*.

Me daten 23/12/2016 me nr. 10545/1 prot., eshte urdheruar pezullimi i procedures dhe eshte ngritur grupi i shqyrtimit te ankese. Komisioni i shqyrtimit te ankese ka kthyer pergjigje me nr. 10545/2 prot date 28/12/2016 dhe nuk ka pranuar ankesen e bere nga operatori, si edhe eshte njoftuar operatori me nr. 10545/3 prot., date 05/01/2017.

Me daten 23/12/2016 me nr. 5316/5 prot., eshte bere njoftimi operatoreve mbi shtyrjen e hapjes se propozimit ekonomik.

Ankesa 4
Me daten 06/01/2017 me nr. 54 prot., z. FF, perfaqesues i JV "IN & IN & AV & A.L. & GE", kane paraqitur ankese pran AK dhe KPP. KPP ka mare vendim nr. 21/1 prot., date 09/01/2017 per shqyrtim ankese dhe nejkohesisht per pezullimin e procedures. ***KPP me vendim datë 30/01/2017 me nr. 31/2017 V, ka vendosur mos pranimin e kerkeses se operatorit ekonomik***, arsyetuar terresisht, por vlen te permendet si problematike *arsyetimi i KPP-se ... ne lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se* ***"akitekti nuk eshte ekspert fushe dhe nuk mund te zevendesoje inxhinierin civil apo aq me pak inxhinierin e rrugeve*** *apo ate te strukturave ne perberje te KVO-se", sqarojne se ne rastin konkret, arkitekti, i cili diplomohet nefakultetin e inxhinierise se ndertimit, gezon nje formim profesional ne perputhje me objektin e prokurimit te procedures ne shqyrtim, duke e konsideruar ekspert te fushes per te cilin zhvillohet kjo procedure prokurimi, per sa kohe qe nuk ekziston nje dispozite ligjore qe percakton se cili eshte ekspert fushe.*
Me daten 31/01/2017 me nr. 31/1 prot., eshte njoftuar AK per vendimin.

Me PV nr. 6, date 03/02/2017 ne oren 11.00, KVO ka bere vleresimin e propozimit ekonomik:

Nr.	Operatoret ekonomik	Cmimi i ofertes ne lek pa TVSH	Vleresimi i Propozimit Ekonomik
1	"GGG shpk	88 500 000	90.87
2	"IN shpk, & IN shpk, & AV shpk, & A.L.T..shpk, & GE shpk"	80 420 000	100
3	"EK & IL shpk, & IT shpk, & A.SH shpk"	88 552 000	90.81

Vleresimi perfundimtare

1	"GGG" shpk	89.870
2	"IN shpk, & INshpk, & AV shpk, & A.L.T..shpk, & GE shpk"	70.3968
3	" EK & IL shpk, & ITshpk, & A.S shpk"	71.8176

Njoftimi perfundimtare i operatoreve eshte bere me date 03/02/2017 me nr.5316/8 prot..
Raporti permbledhur eshte hartuar me nr. 5316/9 prot., date 14/02/2017. Njoftimi i Fituesit me nr. 5316/10 prot., date 14/02/2017.
Kontrata eshte lidhur me nr. 5316/11 prot., date 06/03/2017 me objekt "Studim Projektim plotesim By Pass Shkoder si pjese e koridorit Veri Jug dhe lidhja me qytetin" , cmimi 106 200 00 leke me TVSH, afati i kontrate 10 muaj.
Formulari i njoftimit te kontrates eshte derguar per ne APP me nr. 5316/12 prot., date 24/03/2017, si edhe eshte botuar ne Buletinin nr. 13 date 03/04/2017.
Referuar proves-verbalit PV-5, date 16/12/2016, KVO "per vleresimin e propozimeve teknike", ne tabelen e perllogaritjes per operatorin "GGG" shpk, eshte bere gabim ne mbledhje e totalit, nga 87.78 pike qe duhet te ishte eshte shenuar (89.62 pike).
KVO eshte ne kundershtim me vete llojin e procedure pasi ka nderhyre ne strukturen e llogaritjeve duke perjashtuar rubriken "Transferimi i Njohurive").

- KVO eshte ne kundershim me nenet 1, 2, te ligjit nr. 9643, date 20/11/2006 "Per Prokurimin Publik" (i ndryshuar), si edhe me nenin, 58 VKM-se nr. 914, date 29/12/2014 "Per Miratimin e Rregullores se Prokurimit Publik" (i ndryshuar).

Tabela e vleresimit "Pervoja ne pune te ngjashme 0-10"

Operatoret Ekonomik	**1.Anetrai i KVO-se**	**2.Anetrai i KVO-se**	**3.Anetrai i KVO-se**	**Komenti**
(1)"GGG" shpk	10	8	8	Ka paraqitur per reference kontraten nr.8242/6 date 30/04/2015 "studim projektim dublim i rruges Kashar Rinas", kjo kontrate eshte lidhur mes B.P qe eshte edhe "47 EK 79 & ILIRIADA P.K.S" shpk qe eshte ofertuesi i **3.** **51 % te nje kontrate punime te ngjashme**
(2)"IN shpk, & IN shpk, & AV shpk, & A.L. shpk, & GE shpk"	7	6	7	Me shume se **1 kontrate kontrate te ngjashme** **16 dokumente.**
(3)" EK & IL shpk, & IT shpk, & A.S shpk"	9	8	8	Ka paraqitur per reference kontraten nr.8242/6 date 30/04/2015 "studim projektim dublim i rruges Kashar Rinas", kjo kontrate eshte lidhur mes B.P qe eshte edhe "47 EK 79 & ILIRIADA P.K.S" shpk qe eshte ofertuesi i **1. 49 % te nje kontrate punime te ngjashme**

Tabela me vlerat e kontrateve te operatoreve ekonomik

Operatoret Ekonomik	Nr. i kontratave (referencave)	Vlera e kontratave	Vleresuar mbi 25% sipas kerkeses se DS **22,168,538.69 leke**
(1) "GGG" shpk	**51% e nje kontrate**	26,520,000 leke	0.20 % me shume se kerkesa
(2)"INshpk, & IN, & AV shpk, & A.L..shpk, & GE shpk"	**16 kontrata**	127,685,390 leke	**4.76 % me shume se kerkesa**
(3) "EK & IL shpk, & IT shpk, & A.S. shpk"	**49% e nje kontrate**	25,480,000 leke	0.15 % me shume se kerkesa

Operatori 1

3

Operatori

KVO ka bere vleresimin e operatorve sipas kriterit te pare "Pervoja ne pune te ngjshme", (*Pse dhe si eshte matur pervoja me pune te ngjashme (0-10 pike ?)*, nga tabela e llogaritjeve shikohet nje shmangie te vleresimit, per operatorin *e pare dhe te tretin*, ndryshimi i vleresimit *nga Antari i pare*, i cili nuk eshte siguruar per te dhene nje vleresim te barabarte, *pse, sepse* referenca e paraqitur apo pervoja me punime te ngjashme eshte *1 dokument i njejte qe eshte paraqitur nga te dy ofertuesit* (1 dhe 3), dhe *vlera e saj kontrate eshte (per te parin **0.20%** dhe te tretin **0.15%** me e larte se kerkesa e TR). C'ka do te thote qe vleresimi i ketyre operatoreve me dokumente te njejte, ne kushte te barabarta nuk eshte bere i barabarte (kjo ne sasi reference dhe vlere punimesh me te njejtin dokument).*

KVO po ne kete vleresim ka gabuar duke *diskriminuaroperatorin e dyte*, i cili ka paraqitur**16** kontrata sherbimi dhe vlera e tyre eshte **4.76%** me shume se vlere e kerkuar ne TR. *Te tre Anetaret e KVO-se, kane bere vleresim pa u siguruar dhe vleresuar me me pak pike se*

operatoret e tjere. ***C'ka do te thote qe nuk ka qene nje trajtim i barabarte i ofertuesve, qofte ne vlere apo ne reference punimesh.***

- ✓ KVO eshte ne kundershtim me ligjin nr. 9643, date 20/11/2006 "Per Prokurimin Publik" (i ndryshuar), germen d), te pikes 2, te nenti 1, "Qellimi i Ligjit", ku thuhet, *te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne proceduren e prokurimit publik,* si edhe germen a), te nenit 2, "Parimet e Perzgjedhjes*", mosdiskriminimi dhe trajtimi i barabarte i ofertuesve ose kandidateve*.

KVO ka bere vleresimin e operatorve sipas kriterit te dyte "Metodologjia e propozuar 20-50" perqasja teknike dhe metodologjia, plani i punes, aftesia organizative", (*Si eshte vleresuar?).* Per vleresimin e ketij kriteri kerkohen;

"Perqasja teknike":

- Operatori i pare ***nuk ka paraqitur asnje*** projekt ide, apo variant,
- Operatori i dyte *ka paraqitur **tre** variante* (L 3842 m, L 3998 m, L 14735 m, eshte larguar 1.1 km nga pika e kerkuar ne TR),
- Operatori i trete *ka paraqitur **nje** variant* (**L 2525 m**), kjo gjatesi eshte percaktuar duke respektuar gjurmen e projekt ides sipas termave te reference.

"Metodologjia, plani i punes, aftesia organizative":

- Operatori i pare *ka paraqitur*, nje dokument *me tre fleta njesoj si operatori i trete*, permendim : "*lidhur me eksperiencen e marre nga puna ne projekte konstruksionesh..."*ka paraqitur edhe nje tabele *"Skema Organizative e konsulentit" e cila eshte njesoj si edhe me operatorin e trete*.
- Operatori i dyte ***nuk ka paraqitur dokumenta te tilla***,
- Operatori i trete *ka paraqitur*dokumenta perkatese qe jepet nje pershkrim per organizim, planin e punes, aftesite organizative (3 flete), vlen per tu permendur Baza e njohurive "*eksperienca e marre ne pune ne projekte konstruksionesh ..... ky eshte nje dokument i njejte me **Operatorin e Pare**.* "Skema Organizative e konsulentit" e cila eshte njesoj si edhe me operatorin e pare

Tabela e vleresimit "Metodologjia e propozuar 20-50" (perqasja teknike dhe metodologjia, plani i punes, aftesia organizative).

Operatoret Ekonomik	**1.Anetrai i KVO-se**	**2.Anetrai i KVO-se**	**3.Anetrai i KVO-se**	**Komenti**
(1)"GGG" shpk	48	45	40	Ne Dokumentat perkatese jepet nje pershkrim per organizim, planin e punes, aftesite organizative (3 flete), vlen per tu permendur Baza e njohurive "eksperienca e marre ne pune ne projekte konstruksionesh ..... Skema organizative eshte vetem nje tabele, ne te cilen vlenper tu permendurs shprehaj "Inxhinier Hidrolog" **(KY DOK. ESHTE KOPJE ME DOK. TE OFERTUESIN NR 3)** **Nuk ka paraqitur asnje prezantim per planin e organizimit te sherbimit, grafikun e aktivitetit.** **Nuk ka prezantuar asnje perqasje me projekt-iden e prorpozuar.**
(2)"IN shpk, & IN shpk, & AV shpk, & A.L..shpk, & GE				Ky ofertues nuk ka paraqitur asnje prezantim per planin e organizimit te

shpk”	35	35	35	sherbimit, grafikun e aktivitetit. Ka paraqitut disazgjidhje
(3) “ EK & IL shpk, & IT shpk, & A.S shpk”	33	35	35	Ne Dokumentat perkatese jepet nje pershkrim per organizim, planin e punes, aftesite organizative (3 flete), vlen per tu permendur Baza e njohurive “eksperienca e marre ne pune ne projekte konstruksionesh ..... Skema organizative eshte vetem nje tabele, ne te cilen vlenper tu permendurs shprehaj “Inxhinier Hidrolog” **(KY DOK. ESHTE KOPJE ME DOK. TE OFERTUESIN NR 1)** Per vec kesaj ky ofertues qe prezantuar edhe strukture e projektimit, grafikun e aktivitetit dhe garfikun e realizimit te sherbimit, Ka paraqitur zgjidhje.

KVO ka bere vleresimin e operatorve sipas kriterit te dyte “Metodologjia e propozuar 20-50” perqasja teknike dhe metodologjia, plani i punes, aftesia organizative”, (*Pse dhe si eshte vlereuar ?)*, nga tabela e llogaritjeve *shikohet nje shmangie teper e theksuar e vleresimit, per operatorin e pare* nga dy te tjeret.

Duke i dhene pike me shume eshte e pa bazuar, *pasi operatori i pare nuk ka prezantuar asnje projekt ide, apo perqasje teknike*, ndersa dy te tjeret kane paraqitur. ***Madje projekt idet e tyre me dokumentat e paraqitura forcojne me teper gabimin e bere nga hartuesit te termave te reference qe gjurma e trases se kerkuar nuk rezulton 3.6 km por afersisht 2.6 km. Kjo gje na deklaron gabimin e llogaritjes se fondit limit te prokuruar qe eshte teper i madh***.

*Edhe ne kete rast operatori i pare dhe i dyte ka paraqitur per vleresim te njetin dokument skemen organizative, si edhe relacioni shpjegues per planin e punes dhe aftesise. C’ka do te thote qe keta dy operator kane natyre te njejte. Gabim eshte qe ne kete skeme organizative eshte percaktuar titulli **“Inxhinier Hidrolog”**, kjo diplome **nuk ekziston dhe nuk ka inxhinieri hidrolog**, ky term eshte teper abuzues. Ky fakt tregon qe edhe asnje ofertues nuk ka cv me kete titulli.*

Operatori 1

Operatori 3

KVO duke *mos pasur* ***specialist te fushes*** *ne perberje komisioni*, nuk ka aritur te bej vleresim teknik te sakte, pasi operatori i pare s'ka paraqitur *"perqasje teknike",* si operatoret e tjere, por edhe nuk ka aritur te lexoj gabimin teknik te bere nga hartuesit e termave te references, por edhe vete dokumentat e dorezuara nga ofertueset, per verifikimin e gjatesine se gjurmes e cila eshte gabim **1 km (d.m.th. me pak**).

KVO-se ka vleresuar me pike me shume operatorin e pare, i cili ka mangesi ne dokumenta dhe ne llogjike profesionale sic u permenden me larte, si edhe ne terresi vleresimi eshte i gabuar per dokumenta te njejta vleresim i ndryshem.

- KVO eshte ne kundershim me ligjin nr. 9643, date 20/11/2006 "Per Prokurimin Publik" (i ndryshuar)nenin 1 "Objektin dhe Qellimin", nenin 2 "Parimet e perzgjedhjes", si edhe me nenin, 58, te VKM-se nr. 914, date 29/12/2014 "Per Miratimin e Rregullores se Prokurimit Publik" (i ndryshuar), i cili thote; *"komisioni i vleresimit te ofertave ...., ku te pakten njeri eshte ekspert i fushes..."*

KVO ka bere vleresimin e operatorve sipas kriterit te trete ***"Stafi"***

- Operatori i pare *ka paraqitur 8 kontrata te specialisteve me licenca perkatese (cv),* ***por asnje me licenceper vleresimin e ndikimit te mjedis***,
- Operatori i dyte *ka paraqitur* ***ka paraqitur****edhe me licence* ***per vleresimin e ndikimit te mjedis***,
- Operatori i trete *ka paraqitur 14 kontrata te specialisteve me licenca perkatese (cv),* ***ka paraqitur****edhe me licence* ***per vleresimin e ndikimit te mjedis***.

Tabela e vleresimit "Stafi 0-30".

Operatoret Ekonomik	**1.Anetrai i KVO-se**	**2.Anetrai i KVO-se**	**3.Anetrai i KVO-se**	**Komenti**
(1)"GGG" shpk	26	25	27	Ka paraqitur dok, cv, lic, te 8 ekspereteve Asnje me licence per mjedisin
(2)"IN shpk, & IN shpk, & AV shpk, & A.L..shpk, & GE shpk"	22	25	26	Ka paraqitur dok, cv, lic, te 24 ekspereteve Me licence mjedisi
(3) "EK & IL shpk, & IT shpk, & A.S shpk"	25	25	24	Ka paraqitur dok, cv, lic, te 14 ekspereteve Me licence mjedisi

KVO ka bere vleresimin e operatorve sipas kriterit te trete "Stafi",sic shikohet nga dokumentat e dorezuara operatori i pare i cili eshte vleresuar me pike me shume ka paraqitur, 8 eksperte me dokumentacioni perkates, por asnjeri nuk ka licence per ***"per vleresimin e ndikimit te mjedis",*** qe kerkohet dhe eshte e detyrueshme per te kryer sherbimin apo aq me keq qe vete ky ofertues duhet te marre edhe miratimet perkatese, *ky operator duhet te ishte skualifikuar.* Operatori i dyte dhe i trete kane respektivisht 24 dhe 14 specialist dmth afersisht 3 dhe 2 here me shume se operatori i pare. C' ka do te thote duhet pabarazia ne vleresim eshte teper e theksuar.Hartuesit e NjP ne pikan 2.8.1 (DS) thuhet; "*do te pranohen nenkontraktim (nuk eshte perzgjedhur Opsioni) nderkohe eshte shprehur me poshte qe lejohet deri* ***40 %,*** *si edhe nuk eshte percaktuar qe AK do t'i bej apo jo pagese nenkontraktorit",* ky arsyetim na con ne paragjykim qe operatori fitues i cili nuk ka stafin e nevojshem mund te kontraktoj sherbim po me keta operator qe kane

ofertuar, qe do te thote qe AK, nuk ka integritet dhe besueshmerie dhe transparence ne proceduren e prokurimit publik, si edhe nuk ka vleresuar koston e shpenzimeve te sherbimit.

Lidhur me certifikatat ISO, KVO ka gabuar pasi *operatori i dyte kete dokument e ka pertej dates se vlefshmerise*, KVO ***nuk e ka skualifikuar***, nderkohe qe *operatoret e* ***tjere i ka skualifikuar***, dmth nuk eshte sjellur ne barazi pamvaresisht qe ka qene kriter skualifikimi. Pervec kesaj certifikatat ISO i jepet subjekti dhe jo individit, ky vleresim për to është i gabuar, pasi çertifikimi dhe aftësia profesionale, apo siguria është për individin d.m.th. për profesionistin dhe jo për subjektin që është veç një identitet juridik.

- KVO është përsëri edhe në këtë pjesënë kundërshim me gërmat a,b,c,ç,d,dh, tënenit 1 "Objektin dhe Qëllimin", të gërmës a,b,c, tënenit 2 "Parimet e përzgjedhjes", të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), si edhe me nenin, 58, të VKM-së nr. 914, datë 29/12/2014 "Për Miratimin e Rregullorës së Prokurimit Publik" (i ndryshuar), i cili thotë; *"komisioni i vlerësimit të ofertave ...., ku të paktën njëri është ekspert i fushës..."*

Nën arsyetimet e mësipërme, procedura*"shërbime konsulente"* me objekt "Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e koridorit Veri Jug dhe *lidhja me qytetin*", me vlerë të fondit limit 88,674,154 lekë, pa TVSH, në keto kushte përbën shpenzime jo efektive për buxhetin e ARRSH dhe ngarkon me përgjegjësi Këshilli Teknik, Hartuesit e Termave te Reference, Njësinë e Pokurimit dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave. Sepse qëllimi kësaj procedure "lidhja me qytetin" është realizurar dhe po ndërtohet. Ref. Kontratave të lidhura nga AK,nr. 5310/4 datë 30/11/2011 "Ndërtimi i rruges by pass Perëndimor", Shkodër Loti 1, si edhe me Kontratën me nr. 5311/4 date 30/11/2011 "Ndërtimi i rrugës by pass Perëndimor", Shkodër Loti 2. (*ref. Nenit 690 të Kodit Civil "Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. ...) është mbivendosje,* si edhe në kushtet e mësipërme procedura në terrësi është në kundërshim me nenet 1,2,29, 35, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar), si edhe me nenet 38, 58 te VKM nr. 914, datë 29/12/2014 (i ndryshuar), ... etj, sa me lartë.

4.2.2. Komente.

4.2.2.1. Koment Hartuesit e "Termave të references" z. Simon Prendi, (inxhinier), znj. Albana Ahmeti (inxhinier), znj. Liri Sula (inxhinier) (shkresa nr. 5079/19, datë 14.7.2017), si dhe zj. Elfiori Zota (inxhiniere) (shkresa 5079/13, datë 11.7.2017).
Në përgjithësi në komentet (observacionet) e grupit të hartimit të "Termave të referencës", janë përsëritur të njëjtat argumente që janë bërë edhe për akt konstatim nr. 5, të hartuar nga grupi i auditimit, të cilat me arsyetimet e paraqitura hollëisht në akt konstatim dhe projketraport, nuk qëndrojnë.

4.2.2.2. Koment i NJP me përbërje EL, (juriste), MI, (juriste) (shkresa nr. 5001/3, datë 14.7.2017).
Në përgjithësi në komentet (observacionet) e grupit njësisë së prokurimit, janë përsëritur të njëjtat argumente që janë bërë edhe për akt konstatim nr. 5, të hartuar nga grupi i auditimit, të cilat me arsyetimet e paraqitura hollëisht në akt konstatim dhe projketraport, nuk qëndrojnë.

4.2.2.3. Koment i KVO me përbërje DD Kryetar, EE, AA dhe DH anëtarë.
Në përgjithësi në komentet (observacionet) e komisionit të vlerësimit të ofertave, janë përsëritur të njëjtat argumente që janë bërë edhe për akt konstatim nr. 5, të hartuar nga grupi i auditimit, të cilat me arsyetimet e paraqitura hollëisht në akt konstatim dhe projketraport, nuk qëndrojnë.

4.3. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës "Ndërtimi rruga Kanali i Cukës-Butrint I".

Nga auditimi u konstatua se:

Kontrata e ndërtimit të rrugës "Ndërtim Kanali i Cukës-Butrint , Lot I" është nënshkruar me datë 11.06.2009, ndërmjet ARrSH (Ish-Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve) dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë "GJ & AA" Sh.p.k, me vlerë 527,579,420 lekë pa TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 15 muaj, referuar datës së nënshkrimit të kontratës. Kontrata e mbikëqyrjes së punimeve është nënshkruar me datë 11.06.2009, me Shoqërinë "F&S", me përfaqësues ligjor AS.

Kontrata përfshin punime gërmimi, shtresash, vepra arti, sinjalistike, elektrik si dhe vendosje kabull fibra optike dhe postim linje ujësjellësi.

Sheshi i ndërtimit i është dorëzuar kontraktorit me datë 12.06.2009. Punimet kanë filluar me datë 12.06.2009.

Këshilli Teknik i ARRSH me datë 12.01.2010, ka marrë vendim në lidhje me:

-Eliminimin e totalisht të zgjerimit në zonën km 4+595.

- Në km 4+360 do të bëhen gërmime arkeologjike.

- seksioni tërthor tip të modifikohet nga 2 x 3.5 m asfalt + 1 x 1 bankina në 2 x 3.5 m asfalt 1 x 1 m bankina e asfaltuar dhe 1 x 0.75 kunetë betoni bordurë.

Këshilli Teknik i ARSH me datë 11.01.2011 ka marrë vendim për miratimin e plotësimeve dhe modifikimeve të projektpreventivit për realizimin e objektit brenda vlerës së kontratës bazë. Për zërat e rinj të punimeve është ngritur grupi i negocimit i përbërë nga DD, TT dhe SS, sipas urdhrit nr. 2924/1, datë 03.05.2011.

Janë negociuar çmimet si më poshtë:

"F.V trarë metalikë të urës" me çmim 275,030 lekë/ton

"F.V tombino me tub beton arme me shtresë zhavorri 800 mm", me çmim 7963 lekë për ml. Ky çmim është bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit tetor 2010.

"F.V ndriçues star 1579 STA-P 150 NRL GR" me çmim 15024 lekë për copë.

"F.V krah dy degësh me H=8 m" me çmim 6375 lekë për çift.

"F.V shtyllë dekorative dy degësh me H=8 m" me çmim 18,000 lekë për copë.

Kontratës bazë i janë bërë shtesat e afatit të përfundimit si më poshtë:

Nr. 6884/1, datë 16.09.2010, për shtyrje afati për një periudhë 6 muaj dhe datë përfundimi 11.03.2011. Arsyeja e shtesës së afatit lidhet me pezullimin e punimeve, deri në kryerjen e ndërhyrjeve të propozuara nga Ministria e Kulturës, AKA dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Nr. 1797/2, datë 16.03.2011, për shtyrje të afatit për një periudhë 3 muaj dhe datë përfundimi 11.06.2011. Arsyeja është realizimi i punimeve të parashikuara sipas Vendimit të Këshillit Teknik të DPR (shtesë në volume dhe punime) duke marrë në konsideratë propozimet e bëra nga Ministria e Kulturës, AKA dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Nr. 3755/2, datë 10.06.2011, për shtyrje të afatit për një periudhë 6 muaj dhe datë përfundimi 11.12.2011. Arsyeja është ndryshimet e dala nga Vendimi i Këshillit Teknik të DPR (shtesë në volume dhe punime) duke marrë në konsideratë propozimet e bëra nga Ministria e Kulturës, AKA dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Nr. 7439/2, datë 22.12.2011, për shtyrje të afatit për një periudhë 6 muaj dhe datë përfundimi 11.06.2012. Arsyeja është realizimi i punimeve të parashikuara sipas Vendimit të Këshillit Teknik të DPR (shtesë në volume dhe punime) duke marrë në konsideratë propozimet e bëra nga Ministria e Kulturës, AKA dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Nr. 3163/2, datë 08.06.2012, për shtyrje të afatit për një periudhë 6 muaj dhe datë përfundimi 11.12.2012. Arsyeja është bllokimi i punimeve për shkak të shpronësimeve konkretisht nga Piketa 1 deri në piketën 11.

Nr. 2041/2, datë 11.12.2012, për shtyrje të afatit për një periudhë 6 muaj dhe datë përfundimi 11.06.2013. Arsyeja është "Probleme për shpronësime në objekt".
Nr. 3024/2, datë 12.06.2013, për shtyrje të afatit për një periudhë 12 muaj dhe datë përfundimi 11.06.2014. Arsyeja është "Probleme për shpronësime në objekt".
Nr. 3821/2, datë 23.06.2014, për shtyrje të afatit për një periudhë 7 muaj dhe datë përfundimi 11.01.2015. Arsyeja është "Ndërprerje e punimeve sipas kërkesës së Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës Kanalizimeve për ndërhyrje në segmentin Sarandë-Butrint për ndërtimin e KUZ. (shkresë nr. 1215, datë 29.05.2014)". Kjo shtesë është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit Rrugor Shqiptar.
Nr. 335/1, datë 23.01.2015, për shtyrje të afatit për një periudhë 3 muaj dhe datë përfundimi 15.04.2015. Arsyeja është "**Pengesa për lidhjen me energji elektrike për ndriçimin e objektit dhe sistemimin e bankinave**".
Nr. 3243/1, datë 20.04.2015, për shtyrje të afatit për një periudhë 2 muaj dhe datë përfundimi 15.06.2015. Arsyeja është "**Pengesa për lidhjen me energji elektrike për ndriçimin e objektit**". Shtesa është bazuar në nenet 23, 36 dhe 38 të kontratës.
Në nenin 23 përcaktohet: "*Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate*".
Në nenin 36, Par 4, përcaktohet: "*Autoriteti Kontraktor do të jetë dakord për një zgjatje afati, në rastin e forcës madhore*".
Nga auditimi i dosjes teknike rezulton se për periudhën nga data 15.04.2015 deri me datë 09.06.2015, kontraktori ka realizuar punime si më poshtë:

Datë	Puna e realizuar	ditë vonese
12.01.2015-14.01.2015	Sistemi i bankinës së rrugës majtas nga km 1+640 deri 1+700, 2+700 deri 2+760 dhe 1+800 deri 1+850	3
15.01.2015-16.01.2015	Ditë me reshje	-
19.01.2015-23.01.2015	Sistemim bankinash	4
26.01.2015-30.01.2015	Ditë me reshje	-
02.02.2015-13.02.2015	Sistemim bankinash	9
16.02.2015-22.02.2015	Ditë me reshje	-
23.02.2015-18.03.2015	Vendosje guardrail, sistemim bankinash, punime gërmimi	15
19.03.2015-22.02.2015	Ditë me reshje	-
23.03.2015-15.04.2015	Vendosje guardrail, sistemim bankinash, punime gërmimi	13
15.04.2015	punime gërmimi dhe sistemimi për rrugën sekondare 7, në anën e djathtë në progresivin 4 + 830	1
16.04.2015	nuk është punuar për arsye të reshjeve	-
17.04.2015-20.04.2015	punime gërmimi dhe sistemimi në progresivin 4 + 830 dhe 6 + 600 deri 6 + 800	2
21.04.2015	punime gërmimi dhe sistemimi për rrugën sekondare 7, në anën e djathtë në progresivin 4 + 830	1
22.04.2015	Vendosje hanrail tek Ura e Çukës, progresivi 0+140	1
23.04.2015	Vendosje fugash në Urën e Çukës	1
24.04.2015	Punime për vendosje fugash dhe handrail	1
27.04.2015	Hedhje shtresë stabilizant 15 cm në rrugën sekondare 2, km 0+350	1
28.04.2015	Rrulim në rrugën sekondare 2	1
04.05.2015	Hedhje shtresë stabilizanti 15 cm në rrugën sekondare 3, km 0+530	1
05.05.2015	Rulim stabilizanti në rrugën sekondare 4, km 0+930	1
06.05.2015	Rulim stabilizanti në rrugën sekondare 4, km 0+930 dhe hedhje shtresë stabilizanti në rrugën sekondare 5, km 1+170	1
07.05.2015	Rulim stabilizanti në rrugën sekondare 5, km 1+170 dhe hedhje shtresë	1

	stabilizanti në rrugën sekondare 6, km 4+400	
08.05.2015-11.05.2015	Hedhje shtresë stabilizanti dhe rrulim rruga sekondare 7, km 4+380	2
12.05.2015-13.05.2015	Rulim i shtresës së asfaltit rruga sekondare 2	2
15.05.2015	Rulim stabilizanti rrugë sekondare 3	1
18.05.2015	Rulim shtresë stabilizanti dhe shtresë binderi 2 x 5 cm rruga sekondare 1	1
19.05.2015	Shtresë stabilizanti në rrugën seksioni 6	1
20.05.2015	Shtresë binderi 2 x 5 cm në rrugën seksioni 6	1
21.05.2015-22.05.2015	Shtresë stabilizanti në rrugën seksioni 7 dhe rulimi i saj	2
24.05.2015-25.05.2015	Shtresë binderi në rrugën seksioni 7	2
01.06.2015-09.06.2015	Shtresë asfaltobetoni 4 cm në rrugën seksioni 2,3, 4, 5, 6 dhe 7	6
	Shuma:	75

Referuar argumentit për shtyrje afati për arsye të lidhjes së energjisë elektrike, rezulton se për periudhën e shtesës së afatit të punimeve nuk janë realizuar punime lidhje me energjinë elektrike, por punime shtresash. Theksojmë se për këtë periudhë argumentimi i shtyrjes është pamundësia e lidhjes me energji elektrike, por që në fakt kemi të bëjmë me mospërfundimin e punimeve. Sa më sipër rezulton se nuk kemi të bëjmë me një rast të forcës madhore dhe në këto kushte shtesa e afatit nëpërmjet mendimit të kontratës është e pavlefshme.
Shtyrja e afatit është bërë pa argumentime të bazuara në kontratë, në të dhen të pa sakta, pasi në të vërtetë nuk kanë përfunduar punimet e tjera që të shtyhet afati vetëm për lidhjen e energjisë elektrike, duke favorizuar drejtpërdrejtë kontraktorin dhe duke shmangur penalitetet për vonesa në dorëzimin e punimeve.
Sa më sipër, kontraktori duhet të penalizohej për mos përfundimin dhe dorëzimin e punimeve në afatin e caktuar. Referuar situacionit 18 i cili është përfundimtar, sasia e punimeve të pa realizuara referuar situacionit të mëparshëm është 5,183,000 lekë, më pak se 25 % e vlerës së kontratës.
Bazuar në nenin 37 të kontratës "Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve", për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 e vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës, por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25 % të vlerës së kontratës.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu I, Pika 14, Pika 15.d dhe 17.
Penaliteti i pa mbajtur Kontraktorit, bashkimit të operatorëve ekonomikë "GJ & AA" sh.p.k është me vlerë 9,892,114 lekë [(527,579,420 lekë x 25 %) x 1/1000 x 75 ditë].
Për këtë veprim mbajnë përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria "S & S" sh.p.k Drejtori i Përgjithshëm zv/Drejtori i Përgjithshëm, miratues i shtesave dhe drejtori juridik, i cili ka vlerësuar përshtatshmërinë ligjore të shtesës së kontratës.

Mbi auditimin e dokumentacionit teknik.
Nga auditimi i librezës së masave u konstatua se për zërin E.5 "*Hidroizolim me dy duar bitum*", është përllogaritur sipërfaqja për secilën lyerje, në kundërshtim me specifikimet teknike ku përcaktohet se hidroizolimi do kryhet për të njëjtën sipërfaqe por me dy duar bitum. Bazuar në situacionin përfundimtar, rezulton se është likuiduar sasia 4403 m^2 x 290 lekë/m^3=1,276,870 lekë. Në fakt duhet të likuidohej sasia 2201.5 m^2 (4403 m^2 /2). ***Vlera 766,122 lekë (2201.5 m^2 x 290 lekë/m^2 +TVSH) është përfituar padrejtësisht nga kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.***
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për

mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu I, Pika 14, Pika 15.d dhe 17.

Për këtë veprim mban përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve Shoqëria "S & S" Sh.p.k.

Janë hartuar 17 situacione të pjesshme. Në përfundim të kontratës janë certifikuar punime me vlerë 624,745,429 lekë me TVSH.

Si përfundim në lidhje me zbatimin e kësaj kontrate arrihet në konkluzionin se shtyrjet e afatit në periudha të konsiderueshme rreth 5 vjet, për arsye që lidhen dhe që nuk lidhen me përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, ka shkaktuar vënien me vonesë në eficiencë të këtij investimi.

Me shkresë nr. 5701, datë 14.07.2017, z. XX dhe DD kanë paraqitur vërejtjet mbi rezultatet e auditimit.

Pretendohet se menaxhimi i kontratës është detyrë funksionale e Drejtorisë së Zhvillimit të Projekteve të Huaja, të Brendshme dhe Shpronësimeve. Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se, pavarësisht detyrës funksionale të kësaj drejtorie, vendimmarrja nuk është bërë nga kjo drejtori. Miratimi i shtyrjeve të afatit të përfundimit është mbikëqyrur nga Drejtori Juridik, miratuar nga Nëndrejtori dhe Drejtori i institucionit. Miratimi bazohet relacionet që janë paraqitur dhe mbi bazën e tyre duhet të vlerësohej si nga ana juridike, ashtu dhe menaxheriale ligjshmëria e tyre.

EE ka paraqitur pretendimet sipas shkresës nr. 5701/5, datë 14.07.2017. Pretendohet se shtesat e afatit janë bërë për arsye të mungesës së financimit. Sqarojmë se, shtesat të cilat janë bërë në kundërshtim me termat e kontratës të trajtuara si të pabazuara nga grupit të auditimit nuk i përkasin periudhës në të cilën ka patur realisht mungesë financimi. Merret në konsideratë fakti se në për periudhën e tratuar EE nuk ka qenë në funksionin e zv-drejtorit të përgjithshëm, por z. BB.

4.4. Mbi auditimin e zbatimit të kontratës "Lushnjë-Berat, Lot 2".

Nga auditimi u konstatua se:

4.4.a. Mbi nënshkrimin e kontratës bazë.

Kontrata e punimeve civile "Ndërtim i segmentit rrugor Lushnjë-Berat, Lot 2", është nënshkruar me nr. 1200/6, datë 03.05.2013, me Kontraktorin "GP", me vlerë 1,360,355,580 lekë me TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 26 muaj, referuar datës së lidhjes së kontratës. Kontrata përfshin punime pastrimi dhe mbrojtje skarpatesh, punime dheu dhe pilota, punime rruge dhe shtresa rrugore, tombino dhe drenazhe, ndërtime trotuare dhe drenazhe. Gjatësia e rrugës është 17363 ml.

Ish-Drejtori i Përgjithshëm i ARSH TT, me shkresë nr. 7538, datë 20.05.2013, ka njoftuar znj. AAH për emërimin në rolin e mbikëqyrësit të punimeve provizorisht, për mos pengimin e fillimit të punimeve deri në caktimin e mbikëqyrësit të punimeve. Kontrata për mbikëqyrjen e punimeve është nënshkruar me datë 17.06.2013 me Shoqërinë "DE & GGG" sh.p.k.

Këshilli Teknik i ARrSh i mbledhur me datë 13.09.2013, ka marrë vendim për miratimin e propozimeve për ndryshimin e projektprevetivin, për përshtatje me matjet e realizuara në terren.

Pavarësisht ndryshimeve si më sipër, nisur nga ankesa të komunitetit ku shtrihet rruga, Këshilli Teknik ka marrë vendimin nr. 25, datë 16.09.2014, për disa shtesa dhe përmirësime të preventivit të objektit, të cilat konsistojnë në: Përmirësim të sinjalistikës dhe sigurisë rrugore, përmirësim të hyrje-daljeve dhe degëzime të fshatrave me rrugën nacionale, ndërtim të disa mureve pritëse, shtim të hapësirave të trotuareve etj.

Sa më sipër kanë rezultuar zëra të rinj punimesh, për të cilat është negociuar me kontraktorin. Çmimet janë bazuar në manualet e çmimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015.
Në dosjen teknike të objektit paraqiten 7 pagesa të pjesshme dhe situacioni përfundimtar nr. 8. Për kontratën bazë janë certifikuar punime me vlerë 1,360,354,169 lekë me TVSH.
Procesverbali i fillimit të punimeve mban datën 27.05.2013. Me datë 26.06.2015, kontratës bazë i është bërë një shtesë afati prej 6 muaj me arsyetimin e pamundësisë së ndërtimit të Urës së Kuçit, nga trafiku i rënduar gjatë periudhës së ndërtimit të veprës. Kjo shtesë është bazuar në nenin 23, 36 dhe 38 të kontratës. Data e re për përfundimin e punimeve është përcaktuar 30.12.2015. Bazuar në kontratën e punimeve civile të nënshkruar mes palëve, punimet janë parashikuar të realizohen pa ndërprerjen e trafikut. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, procesverbali i përfundimit të punimeve është hartuar me datë 30.12.2015.

4.4.b. Mbi auditimin e dokumentacionit të kontratës bazë.
-Nga auditimit i librezës së masave për zërin B. 1 "Ndërtesa dhe struktura të tjera", Prishje dhe heqje e ndërtesave ekzistuese dhe strukturave ekzistuese (beton dhe beton arme), ngarkim dhe transport në çfarë do distance rezulton se është certifikuar sasia 1966 m^3. Në zërin prishje kombino katrore është përllogaritur volumi për 1 ml tombino 5.52 m^3. Ky volum është shumëzuar me gjatësinë e tombino sipas seksionit tërthor të trupit të rrugës, konkretisht për 7.8 m gjatësi e realizuar në 40 raste. Në volumin 5.52 m^3 është përfshirë volumi i portalit në masën 2.09 m^3, volum i cili duhet të llogaritej i ndarë, pasi rezultati i llogaritjeve ka përfshirë volumin e portalit në të gjithë gjatësinë e tombino duke u përsëritur. Për një tombino 7.8 ml, volumi i betonit të shkatërruar duhet të ishte 28.8 m^3 [((5.52-2.09) m^3 x 7.8 ml) + 2.09 m^3] dhe jo 43.22 m^3 që është llogaritur realisht. Sa më sipër, për 40 tombino, volumi i llogaritur më tepër është 576.8 m^3 [40 tombino x (43.22-28.8)].
Vlera 1,938,048 lekë (576.8 m^3 x 2,800 lekë/m^3 + TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori "GP" dhe përbën dëm ekonomik.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu I, Pika 14, Pika 15.d dhe 17.
Për sa më sipër mban përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve bashkimi i shoqërive "DE & GGG" sh.p.k.

4.4.c. Mbi shtesën e kontratës.
Për realizimin e punimeve shtesë, pas rishikimit të projektpreventivit dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Teknik nr. 25, datë 16.09.2014, me nr. 5235/4, datë 12.08.2014, është nënshkruar shtesa e kontratës me vlerë 258,738,790 lekë me TVSH. Janë certifikuar punime me vlerë 258,738,790 lekë pa TVSH. Afati i zbatimit të punimeve për shtesën e kontratës është përcaktuar 6 muaj. Shtesës së kontratës i është amenduar afati i përfundimit me datë 27.05.2015, për një afat 7 muaj, për përfundim të punimeve me datë 03.08.2015, me arsyetimin se: "*Si pasojë e radhës teknologjike të kryerjes së punimeve, sepse ndërtimi i shtresës së sipërme të asfaltit (4 cm) përfshirë edhe emusionin bituminoz që janë punime/zëra të kontratës shtesë kanë lidhje me përfundimin e volumeve të kontratës bazë*". Sa më sipër, vërtetohet që punimet e kontratës bazë nuk janë përfunduar deri me datë 26.06.2015, periudhë në të cilën është bërë shtyrja e afatit kohor për përfundimin e punimeve të kontratës bazë për 6 muaj, me argumentimin e pamundësisë së ndërtimit të Urës së Kuçit, nga trafiku i rënduar gjatë periudhës së ndërtimit të veprës. Pavarësisht sa më sipër, me datë 23.07.2015, është bërë shtyrje e afatit të përfundimit të punimeve shtesë për një afat 4 mujor, për përfundim deri me datë 30.12.2015, me

pretendimin se: **"*Për të kryer zërin pastrim kanali, i cili nuk është realizuar gjatë kësaj periudhe si pasojë e prezencës së ujit gjatë sezonit të vaditjes së tokave*"**. Kjo shtesë kontrate nuk është shoqëruar me relacion argumentues në kundërshtim me kushtet e përgjithshme të kontratës. Shtesa e kontratës është bazuar në nenet 23, 36 dhe 38 të kontratës. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me forcë madhore si dhe argumentimi nuk qëndron sa i përket zërave të punimeve të realizuara në fakt gjatë kësaj periudhe të cilat, bazuar në ditarin e punimeve për periudhën 03.08.2015 deri 28.12.2015, janë realizuar punime të cilat kanë të bëjnë me:

-Furnizim vendosje shenja rrugore permanente me një shtyllë.

- Furnizim vendosje shenja rrugore permanente me dy shtyllë + vendosje tregues kilometrikë.

- Vijëzime rrugore me bojë termoplastike në të nxehtë gjerësi 120 mm, linjë e ndërprerë.

-Furnizim vendosje guardrail (barriera mbrojtëse metalike).

- Zëri pastrim kanale është realizuar nga data 26.11.2015 deri me datë 28.12.2015. Sa më sipër, për periudhën kohore nga data 03.08.2015 deri me datë 26.11.2015, ose 113 ditë, janë realizuar punime të cilat nuk kanë lidhje me objektin shtesë kontrate (zgjatje afati të përfundimit të punimeve).

Gërmimet e kanaleve si më sipër janë certifikuar për periudhën deri 05.11.2014, në sasinë 1750 m^3 (situacioni nr. 1), për periudhën deri datë 22.12.2014, në sasinë 850 m^3 (situacioni nr. 2), për periudhën deri datë 10.07.2015, në sasinë 375 m^3 (situacioni nr. 3), ndërsa për periudhën e shtyrë pas datës 03.08.2015, janë certifikuar përkatësisht 400 m^3 sipas situacionit nr. 5 dhe 0 m^3 sipas situacionit përfundimtar, pra rezulton se punimet e gërmimit të kanaleve kanë përfunduar në masën 88 % para akordimit të shtesës së afatit. Vetëm 400 m^3 nga 3375 m^3 gërmime janë situacionuar gjatë periudhës së shtesë së dytë të afatit (kontrata shtesë).

Në preventivin e punimeve për pastrimin e kanaleve është përcaktuar "*Gërmim dheu me ekskavator me zinxhirë 1.0 m^3, në kanale gjerësi > 2m, në prani uji ~ 1m, kategoria IV, me shkarkim në mjet dhe transport në vend depozitim*", pra ky zë punimi është parashikuar të realizohet në prezencë të ujërave dhe argumentimi i shtyrjes së afatit se nuk është punuar nga prezenca e ujërave nuk duhet të merrej në konsideratë për shtyrjen e afatit të përfundimit të kësaj shtese kontrate. Shtesa e afatit të kontratës është bazuar në nenet 23, 36 dhe 38 të kontratës bazë, nene të cilat kanë përcaktimet si më poshtë:

Neni 23 "*Nga afati i fillimit deri në afatin e realizimit të plotë, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për; a. dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo personi punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit, b. Dëmtim të punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor sipas nenit 23*".

Neni 36 "*Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të porosisë shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20 % të çmimit total të kontratë. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në ligjin e prokurimit publik"*.

Neni 38 "*Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e punimeve dhe drejtuesi i projektit do të bëjë këtë sapo të vendosë së punimet janë mbaruar plotësisht.*

-Nëse drejtuesi i projektit zbulon se punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japë udhëzime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zërat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

- Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata".

Sa më sipër rezulton se, shtesa e afatit nuk ka lidhje me detyrimet e ndërsjella të përcaktuara në kontratë në lidhje me shtyrjen e afatit të punimeve.

Bazuar në nenin 33, Pika 33.5 të kontratës, Autoriteti kontraktues do të jetë dakord për shtyrje të afatit në rastin e Forcës Madhore, por në këtë rast nuk kemi të bëjmë me forcë madhore për arsyet si më poshtë:

- Gërmimi i kanalit është parashikuar të realizohet me prezencën e ujit dhe argumentimi i shtesës se nuk janë realizuar gërmimet e kanalit nuk përcaktohet si forcë madhore.
- Bazuar në ditarin e punimeve, rezulton se deri me datë 03.08.2015, që i përket parashikimit të përfundimit të punimeve pas shtyrjes së parë të afatit me 7 muaj, nuk janë realizuar të gjitha punimet e shtesës së kontratës, ndërkohë që pretendohet se nuk janë realizuar vetëm kanalizimet.

Sa më sipër, bazuar në përcaktimet kontraktore, shtyrja e afatit është e pavlefshme dhe është bërë për të favorizuar kontraktorin duke shmangur penalitetet e përcaktuara, për mos përfundimin në afatet kontraktore, sipas nenit 34 të kontratës.

Sipas situacionit nr. 5 për punime deri me datë 21.12.2015, është certifikuar vlera 4,959,062 lekë dhe sipas situacionit nr. 6 (situacion përfundimtar) është likuiduar vlera 6,682,234 lekë.

Sa më sipër, bazuar në nenin 34, Pika c të kushteve të përgjithshme të kontratës, për mos përfundim në afat të punimeve, kontraktori "GP" duhet të penalizohej për vonesë në dorëzimin e punimeve me vlerë 7,309,371 lekë [258,738,790 lekë (vlera e kontratës) x 25 % (duke qenë se punimet e mbetura janë më pak se 25 %) x 113 ditë (ditë vonesë bazuar në ditarin e punimeve) x 1/1000].

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu I, Pika 14, Pika 15.d dhe 17.

Për veprimin e mësipërm mban përgjegjësi XX, miratues i shtesës së kontratës, BB, miratues i shtesës së kontratës, DD dhe HH menaxhues të kontratës (nënshkrues të situacioneve) si dhe mbikëqyrësi i punimeve bashkimi i shoqërive "GGG & DE" Sh.p.k.

Shtesa e kontratës përfshin disa punime të cilat nuk janë pjesë e preventivit të kontratës bazë. Për përcaktimin e çmimeve për zërat e rinj të punimeve është ngritur grupi i negocimit me urdhër nr. 10749, datë 27.02.201. Grupi i negocimit përbëhet nga z. TH. DO dhe HE. Çmimet janë bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015. Theksojmë se, ndryshimet të cilat rezultojnë me zëra të rinj punimesh, rezultojnë me çmime tavan, ose vlerë maksimale të përshkruara në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit, krahasuar me çmimet e preventivit të tenderuar të cilat rezultojnë me ulje nga organizimi i procesit të prokurimit.

Me datë 16.05.2017, me prezencën e përfaqësuesve të mbikëqyrësit të punimeve u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt.

-U verifikuan punimet për realizimin e shtresave asfaltike për lidhje biznesesh në disa segmente, sipas shtesës së kontratës. Në progresivin 1+900, bazuar në librezën e masave është përshkruar sipërfaqja 940 m^2. Nga verifikimi në objekt rezulton se sasia e realizuar është 348 m^2, me një diferencë 592 m^2. Diferencat në vlerë për zërat respektivë, shtresë binderi, shtresë asfaltobetoni, ndërtim i shtresës bazë dhe nënshtresës, paraqiten si më poshtë:

Shtresë binderi 592 m^2 x 750 lekë/m^2 = 444,000 lekë
Shtresë asfaltobetoni 592 m^2 x 620 lekë/m^2 = 367,040 lekë
Ndërtim i shtresës bazë me gurë të thyer, granulometri 0-31.5 mm, 20 cm
592 m^2 x 0.2 m x 1,200 lekë/m^2 = 142,080 lekë
Ndërtim i shtresës bazë me gurë të thyer, granulometri 0-20 mm, 10 cm
592 m^2 x 0.1 m x 1,500 lekë/m^2 = 88,800 lekë
Ndërtim i shtresës nën bazë me zhavor 20 cm
592 m^2 x 0.2 m x 1,430 lekë/m^2 = 169,312 lekë

Shuma: 1,211,232 lekë.

Vlera 1,453,478 lekë (1,211,232 lekë +TVSH), është përfituar padrejtësisht nga kontraktori "GP" dhe përbën dëm ekonomik.

Veprimi i mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, me UKM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Kreu I, Pika 14, Pika 15. d dhe 17. *Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve.*

Me shkresë nr. 5701, datë 14.07.2017, XX dhe DD kanë paraqitur vërejtjet mbi rezultatet e auditimit.

Pretendohet se menaxhimi i kontratës është detyrë funksionale e Drejtorisë së Zhvillimit të Projekteve të Huaja, të Brendshme dhe Shpronësimeve. Në lidhje me këtë pretendim sqarojmë se, pavarësisht detyrës funksionale të kësaj drejtorie, vendimmarrja nuk është bërë nga kjo drejtori. Miratimi i shtyrjeve të afatit të përfundimit është mbikëqyrur nga Drejtori Juridik, miratuar nga Nëndrejtori dhe Drejtori i institucionit. Miratimi bazohet relacionet që janë paraqitur dhe mbi bazën e tyre duhet të vlerësohej si nga ana juridike, ashtu dhe menaxheriale ligjshmëria e tyre.

EEl ka paraqitur pretendimet sipas shkresës nr. 5701/5, datë 14.07.2017. Pretendohet se shtesat e afatit janë bërë për arsye të mungesës së financimit. Sqarojmë se, shtesat të cilat janë bërë në kundërshtim me termat e kontratës të trajtuara si të pabazuara nga grupit të auditimit nuk i përkasin periudhës në të cilën ka patur realisht mungesë financimi. Merret në konsideratë fakti se në për periudhën e trajtuar z. EE nuk ka qenë në funksionin e zv-drejtorit të përgjithshëm, por z. VV.

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka paraqitur vërejtjet e "GP" sh.p.k të bëra me shkresë nr. 73, datë 11.07.2017. Sqarojmë se:

Sa i përket përllogaritjeve për sasinë e betonit të shkatërruar, grupi i auditimit është bazuar në librezën e masave të dosjes teknike vënë në dispozicion të grupit të auditimit gjatë auditimit.

Në lidhje me punimet e shtresave sqarojmë se nga grupi i auditimit janë bërë sondazhe për seksione të veçanta të punimeve dhe jo për gjithë punimet e realizuara, në këtë mënyrë është në përgjegjësinë e mbikëqyrësit të punimeve të saktësojë volumet e kontratës në tërësi.

4.5. Nga dokumentacioni teknik i zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve në objektin:"***Sistemim asfaltim rruga Librazhd - Qafë Stude, Loti 3***" u konstatua se:

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 1779/5 prot. datë 06.05.2011 të lidhur midis Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, përfaqësuar nga ish-drejtori i përgjithshëm z. Andi Toma dhe operatorit ekonomik "VV" sh.p.k. Vlera e kontratës bazë është 2,271,903,530 lekë me TVSH me afat zbatimit 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës, sipas grafikut të punimeve. Lloji i kontratës është kontratë me çmim njësie të bazuar në çmimet e njësisë, të shprehura në preventivin në njësi. Bazuar nenit 40 të kontratës, kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Garancia e defekteve në ndërtim është 5% e vlerës së kontraktuar dhe ka afat 2 vite pas datës së kolaudimit përfundimtar. Bazuar projektit fillestar kanë qenë të parashikuara 2 segmente (km 9+600-22+720 dhe 0+000-16+827). dhe më pas është shtuar segmenti (0+000-17+420).

Për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës është nënshkruar kontrata nr. 1779/6 prot. datë 06.05.2011, midis Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, përfaqësuar nga ish-drejtori i përgjithshëm TT dhe operatorit ekonomik "GGG" sh.p.k, me përfaqësues ligjor HH. Vlera e kontratës së mbikëqyrjes është 22,303,477 lekë me TVSH.

-Me shkresën nr. 544/2 prot. datë 02.11.2011 të Drejtorit Ekzekutiv të Fondit Shqiptar të Zhvillimit z. CC, drejtuar ish-Ministrit të MPPT dhe DPRR, hyrje me nr. 6812 prot. datë 22.11.2011, me objekt zbatimin e segmentit Librazhd-Ura e Cerenit, bazuar porosisë së Kryeministrit të Shqipërisë, ku segmenti rrugor do të jetë pjesë e programit të rrugëve dytësore dhe lokale që FSHZH është duke zbatuar.

- Nga ish-Drejtori i Përgjithshëm AA urdhërohet që të bashkëpunohet me FSHZH, që DPRR të realizojë hapjen e trasesë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit të realizojë shtresat asfaltike për të realizuar përfundimin e rrugës në të gjithë gjatësinë nga Librazhdi në Urën e Cerenit.

- Me shkresën e ish-Drejtorit të Përgjithshëm nr. 6812/3 prot. datë 29.12.2011, drejtuar mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve, i kërkon të realizojnë azhornimin në terren të projekt-preventivit të pa tenderuar Fushë Stude-Ura e Cerenecit. Gjithashtu i kërkon vlerësimin e volumeve të punimeve për objektin "Sistemim Asfaltim Rruga Librazhd-Qafë Stude Loti 3", bashkë me pjesën e pa tenderuar me gjatësi 17.4 km, duke mos përfshirë punimet e shtresave asfaltike, ku bashkëlidhur u dërgon projekt-preventivin e pjesës 17.4 km të segmentit rrugor Fushë Stude-Ura e Cerenecit.

- Me vendimin e Këshillit Teknik të datës 06.02.2012, miratohen në parim propozimet për plotësimin dhe rivlerësimin e projekt-preventivit, për shkak të mospërputhjeve të projekt zbatimit nga kuotat relative dhe jo ato absolute. Gjithashtu miratohet rivlerësimi i projekt-preventivit me gjatësi 17.4 km.

- Me vendimin e Këshillit Teknik të datës 01.02.2013, miratohet në parim rivlerësimi i projekt-preventivit për saktësimin e volumeve, për shkak të zonave të identifikuara për rrëshqitje në pozicionet ku ndryshojnë shtresat gjeologjike. Identifikimi i zonave të rrëshqitshme janë pasqyruar në raportin gjeologjik dhe për stabilizimin e rrëshqitjeve propozohet përdorimi i fondit rezervë. Akti i dorëzimit të sheshit dhe procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur më datë 11.05.2011.

- Për afatet e ndërtimit janë realizuar 4 amendime të kontratës nr. 2274/2 datë 08.05.2013, nr. 6333/1 datë 01.07.2014, nr. 07/1 datë 05.01.2015, nr. 6055/1 datë 13.07.2015, të cilat konsistojnë në ndryshime të projekt-preventivit për shkak të vazhdimësisë së projektit, nga rrëshqitjet e ndodhura në km 13+500, nga mos lirimi i sheshit të ndërtimit të shpronësimeve në fshatin Borove-Cerenec, nga kushtet atmosferike duke mos punuar në veprat e artit, nga rrëshqitjet e ndodhura në km 11+100-11+450 të Fushë Stude-Cerenec Lot 1 dhe 11+900-11+963 Fushë Stude-Cerenec Lot 1.

-Me shkresën nr. 126 prot. datë 30.09.2015 është njoftuar nga sipërmarrësi përfundimit i punimeve. Mbikëqyrësi i punimeve ka njoftuar përfundimin e punimeve me shkresën nr. 241 prot. datë 09.10.2015.

-Procesverbali i kolaudimit i kontratës bazë është realizuar më 28.12.2015, ku objekti është i deklaruar se vihet në shfrytëzim.

- Me vendimin nr. 7, nr. 556 prot. datë 06.02.2014, janë miratuar në parim propozimet e paraqitura nga mbikëqyrësi i punimeve me shkresën nr. 308 datë 10.12.2013, të cilat konsistojnë në marrjen e masave inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjeve në km 13+480 deri 13+530 të segmentit 9+600-22+520, korsi shtesë nga km 2+875-4+825, modifikime në kanalet anësore me veshje me beton, lidhjen e komunave (Qafe Stude-Stebleve 7km), komuna (Ostren 2.7km) dhe Bypassi i fshatit Cerenec me gjatësi 1.9 km.

-Për shtesën e punimeve është nxjerrë Urdhri i Prokurimit nr. 34 datë 29.06.2015 me objekt " Sistemim Asfaltimi i rrugës Librazhd-Qafe Stude Loti3 (shtesë punimesh), me fond limit 453,765,298 lekë me TVSH. Lloji i procedurës është përcaktuar "Negocim pa shpallje" me kontraktorin e kontratës bazë "VV" sh.p.k, në mbështetje të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar neni 33/5, sepse ka të bëjë me zgjatjen e kontratave të punëve

të cilat nuk kanë qenë të përfshira në kontratën fillestare, pasi nevoja për punë shtesë është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara, që nuk varen nga AK dhe që nuk mund të ndalen. Shtesa e kontratës nr. 5615/4 prot. datë 03.07.2015, është lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar, përfaqësuar nga XX dhe operatorit ekonomik "VV" sh.p.k, përfaqësuar nga KK, me afat *7 muaj* nga nënshkrimi i saj.
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për shtesën e kontratës, për periudhën e auditimit konstatohet se shtesa e kontratës, ende nuk është përfunduar dhe sipërmarrësi ka paraqitur 2 situacione pjesore në vlerë 230,289,474 lekë me TVSH, ku nga ARRSH është paguar 175,027,640 lekë me TVSH.

-Me shkresën nr. 8271 prot. datë 11.10.2016, të Drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Cilësisë z. LL, drejtuar zv. Drejtorëve të Përgjithshëm EE dh QQ, Drejtorit të Drejtorisë së Standardeve z. SS, Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit z. HH z. XX, *konstatohen problematikat e disa kontratave të punëve publike të cilat janë të kolauduara.* Në këtë shkresë paraqitet situata e disa kontratave publike të cilat janë përfunduar dhe kolauduar, *por objektet nuk kanë përfunduar.*
Në këto kontrata nuk janë realizuar një pjesë ose e gjithë paketa asfaltike bashkë me sinjalistikën dhe elementët e sigurisë rrugore, duke listuar objektet e papërfunduar si më poshtë:
1. "*Sistemim Asfaltim rruga Librazhd - Qafë Stude, Lot 3*",
2. "Sistemim Asfaltim rruga Qafë Thanë - Lin Pogradec, Lot 2, shtesë kontrate",
3. "Ndërtim rruga e Arbrit, dalje Ura e Vashës - Bulqizë, Lot 3",
4. "Ndërtim rruga e Arbrit, dalje Ura e Vashës - Bulqizë, Lot 3, shtesë kontrate",
5. "Rruga e Arbrit (Segmenti: Ura e Brarit - Hyrja e Tunelit Qafë Murriz",
6. "Sistemim Asfaltim Rruga Kuçovë - Belsh - Cërrik",
7. "Sistemim asfaltim rruga e Gjinarit".
Nga Drejtori i Drejtorisë së sigurimit të cilësisë, ***shprehet shqetësimi se është emergjente përfundimi i objekteve me gjithë elementet e parashikuara në projekt për të shmangur dëmtimet që do të kërkonin ribërjen e zërave të punimeve të kryera si dhe shmangien e aksidenteve të mundshme.***

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se:
- Nga ARRSH, nuk është marrë asnjë masë në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit për përfundimin e objektit "Sistemim Asfaltim rruga Librazhd - Qafë Stude, Lot 3", duke mos marrë asnjë masë për dëmtimet e mundshme të shtresave të zhavorrit dhe të çakullit.
- Nga ARRSH, nuk është marrë asnjë masë për përfundimin e shtesave të kontratave, në të gjithë objektet e sipërcituara të cilat konsistojnë në hapjen e traseve duke mos zbatuar paketat asfaltike.
Veprimet e mësipërme tregojnë një keq menaxhim të fondeve publike nga ARRSH, duke mos arritur përfundimin e objekteve megjithëse ato kolaudohen, duke shkaktuar dëme ekonomike të parikuperueshme në zërat e punimeve dhe duke rriskuar sigurinë rrugore. Veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi menaxhimin ekzekutiv të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Gjatë auditimit të projektit të azhurnuar (As-Build), situacionit përfundimtar, librezës së masave të kontratës bazë konstatohet se:
Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, librezave të masave, situacionit përfundimtar, rezultojnë disa pasaktësi ose mospërputhshmëri në disa seksione tërthore, duke sjellë si pasojë volume më të mëdha pune.

1. Shtesa e trasesë e segmentit rrugor Fushë Stude - Ura e Cerenecit.

Kontrata në preventivin e ripunuar, kapitulli A "*Punime për Lëvizjen e Dherave*", zërat e gërmimit të dheut në seksion T.Z (A1), gërmim dheu në seksion të lirë T.F (A2), gërmim në shkëmb i fortë me mina (A3), gërmim seksion i detyruar për kanale (A4), formim në trupin e rrugës në mbushje me material shkëmbor (A5), konstatohen se janë rritur artificialisht sipërfaqet e seksioneve tërthore të disa piketave të llogaritura në librezat e masave, duke përfituar volume më të mëdha punimesh në zërat e mësipërm.

Bazuar librezës së masave dhe projekt azhurnimit (As-Build), të miratuar nga mbikëqyrësi dhe të dorëzuara në ARRSH, janë përshkruar sipërfaqet e profileve tërthore të piketave të rrugës, *të cilat nuk përputhen me llogaritjet e sipërfaqeve në librezat e masave*.

Sipërfaqja e seksioneve tërthore janë përcaktuar me pajisje topografike GPS, duke nxjerrë kuotat e tokës dhe kuotat e projektit të zbatuar. Pas verifikimit të profileve të seksioneve tërthore të projektit, vërehen sipërfaqeve tërthorë të pasakta në disa seksioneve, duke rritur volumet e punimeve të kapitullit A për lëvizjen e dherave. Llogaritjet e gabuara të papërputhura janë në përgjithësi janë në lotin 2 Fushë Stude - Ura e Cerenecit, duke mos u përputhur me llogaritjet. Në seksionet më voluminoze të kontratës, sipërfaqet e profileve tërthorë për të gjitha zërat e lëvizjes së dherave përputhen.

Zëri A4, në preventiv dhe në situacion përfundimtar është me emërtimin "Gërmim seksion i detyruar për kanale,+auto" është vjelë me zërin "Përforcim të bazamentit". Nga verifikimi i projektit fillestar me atë përfundimtar konstatohet se segmenti rrugor Fushë Stude-Ura e Cerenecit Loti 2 (0+000 - 17+420), ka pasur parashikuar hapjen e trasesë për 17.4 km dhe ka përfunduar me 16.8 km.

Nga rillogaritja e volumeve të projektit, **bazuar sipërfaqeve tërthore me pasaktësi, rezulton vlera prej 25,520,880 lekë me TVSH, e përfituar padrejtësisht nga kontraktori për shkak të llogaritjeve të pasakta në projekt.**

Tabela e mëposhtme paraqet efektin financiar të rillogaritjeve të sipërfaqeve të pasakta.

Nr	Përshkrimi i punimit	Paguar sipas situacioni perfundimtar 0+000 deri ne 17+420				Realizuar fakt, bazuar azhurnimit dhe rillogaritjeve ne L.M			
		Njësia	**Sasia**	Çmimi	Vlera	**Sasia**	Çmimi	Vlera	Dif.
	Kontrata baze, A.Punime per Levizjen e Dherave			(Lekë)	(Lekë)		(Lekë)	(Lekë)	(Lekë)
A1	Germim dheu ne seksion te lire TZ, + auto	m3	353,901.0	500.0	176,950,500.0	324,821.0	500.0	162,410,500.0	14,540,000.0
A2	Germim dheu ne seksion te lire TF, + auto	m3	34,375.0	500.0	17,187,500.0	31,407.0	500.0	15,703,500.0	1,484,000.0
A3	Germim ne shkemb te forte me mina, seksion i lire, + tr auto	m3	14,673.0	900.0	13,205,700.0	12,343.0	900.0	11,108,700.0	2,097,000.0
A4	Germim seksion I detyruar per kanale, + tr auto	m3	19,341.0	500.0	9,670,500.0	14,485.0	500.0	7,242,500.0	2,428,000.0
A5	Formim I trupit te rruges ne mbushje me material shkembor karriere	m3	35,600.0	800.0	28,480,000.0	34,702.0	800.0	27,761,600.0	718,400.0
								Shuma:	**21,267,400.0**
								TVSH	**4,253,480.0**
								TOTAL	**25,520,880.0**

Për sa më sipër mbikëqyrësi i punimeve nuk ka paraqitur vërejtje.

ARRSH në observacionet e paraqitura ne KLSH, me shkresë nr. 5671/2 prot. datë 11.07.2017. ka përfshirë dhe observacionet e operatorit ekonomik "VV" sh.p.k, në të cilat përsëriten saktësisht observacionet që ka bërë mbikëqyrësi i punimeve për procesverbalin që është mbajtur për këtë qëllim. Pavarësisht se më sipër, me sqarimet e dhëna hollësisht në procesverbal dhe projektraport, vërejtjet e operatorit ekonomik "VV" sh.p.k, nuk qëndrojnë.

4.6. ***Nga verifikimi i dosjes së zbatimit të objektit "Ndërtim i rrugës Lushnje-Berat, Loti 3"u konstatua se:***

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 1181/6 prot. datë 03.05.2013 të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar, përfaqësuar nga ish-drejtori i përgjithshëm z. TT dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "AG" sh.p.k & "HA" sh.p.k, përfaqësuar nga z. GG dhe PP. Vlera e kontratës bazë është 1,166,460,075 me TVSH me afat zbatimit 24 muaj nga data e lidhjes së kontratës, sipas grafikut të punimeve**.** Ndërtimi i rrugës ka një gjatësi L=9,335 m, ku Loti 3 fillon nga progresivi 22+924 km deri në 32+260 km, me gjerësi të shtresës asfaltike 11m.

Për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratës është caktuar fillimisht nga AK, mbikëqyrës provizor AAH dhe më pas është nënshkruar kontrata e mbikëqyrjes nr. 1751/6 prot. datë 17.06.2013, me operatorin ekonomik "ER" sh.p.k, me përfaqësues ligjor z. II. Akti i piketimit të objektit, akti i dorëzimit të sheshit dhe procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur për kontratën bazë më 10.05.2013. Gjatë zbatimit të kontratës janë hasur vështirësi në trasenë e rrugës afër aviacionit ushtarak të Urës Vajgurore dhe është kërkuar vazhdimisht lirimi i shesheve të ndërtimit për shkak të vështirësive për shpronësimet e tokave që takojnë rrugën, të cilat kanë shtyrë afatet e punimeve të miratuara nga mbikëqyrësi dhe autoriteti kontraktor. Për kontratën bazë janë nënshkruar 4 (katër) amendime për shtyrje të afatit të punimeve.

Me vendimin e Këshillit Teknik 24.07.2013, është miratuar në parim projekt-preventivi i rishikuar, bashkë me tabelën e volumeve duke bërë të mundur përdorimin e fondit rezervë. Nga projekti fillestar i parashikuar, është kërkuar nga kontraktori plotësimi i segmentit të ngelur nga rreth-rrotullimi i fshatit Ciflik dhe përfundon tek rreth-rrotullimi në dalje të qytetit të Urës Vajgurore, me gjatësi rreth 2 km.

Kërkesa e kontraktorit është bazuar nga kërkesa për ndërhyrje nr. 295 datë 02.07.2013 të Bashkisë së Urës Vajgurore, ku kontraktorit dhe mbikëqyrësi i punimeve kanë hartuar projekt-preventivin për zbatimin e punimeve në segmentin shtesë. Në vendimin e Këshillit Teknik deklarohet se segmenti prej 2 km, është jashtë investimit të kontratës nr. 118/6 datë 03.05.2013 "Ndërtim i rrugës Lushnje-Berat, Loti 3".

-Me amendimin e kontratës nr. 1623/5 datë 07.04.2014, është realizuar shtesë kontrate Nr. 1, në vlerën 197,244,899 lekë me TVSH në masën 16.9 %, duke shtuar segment rruge nga rreth-rrotullimi i fshatit Ciflik dhe përfundon tek rreth-rrotullimi në dalje të qytetit të Urës Vajgurore. Për kontratën shtesë nr. 1, janë nënshkruar 6 (gjashtë) amendime për shtyrje të afatit të punimeve.

- Me amendimin e kontratës nr. 10699/4 datë 24.12.2015, është realizuar shtesë kontrate Nr. 2, në vlerën 36,039,779 lekë me TVSH në masën 3%, për shkak të kërkesave të Ministrisë së Mbrojtjes për transferimin e pronës së Bazës Ajrore, që preket nga ndërtimi i rrugës duke kërkuar vendosje semaforësh, ndërtimin e nënkalimi të ri dhe vendosjen e barrierave mbrojtëse. Për kontratën shtesë nr. 2, janë nënshkruar 2 (dy) amendime për shtyrje të afatit të punimeve.

Njoftimi i përfundimit të punimeve është bërë më datë 29.04.2016. Kolaudimi i objektit është realizuar më 30.12.2016.

Gjatë auditimit të projektit, situacionit përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimet në terren konstatohet se:

Nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, librezave të masave dhe situacionit përfundimtar, rezultojnë diferenca volume pune të pakryera dhe përfitim të kontraktorit "AG" sh.p.k & "HA" sh.p.k, më tepër në **vlerën 6,711,032 lekë me TVSH (5,592,527 x 20%).**

1. *Kontrata bazë, kapitulli B2, zëri i ndërtimit të murit rrethues me blloqe betoni (muret rrethues që prishen nga ndërtimi i rrugës)*
Në librezat e masave pasqyrohen dhe paguar në situacionin përfundimtar volumin prej 625 m^3. Nga verifikimet me sondazhe të mureve në terren rezulton lartësia e murit me blloqe 1.25 m, ndërsa në librezën e masave rezulton se lartësia e murit është llogaritur për 2.5 m. Nga rillogaritjet e volumeve rezulton se volumi i mureve me blloqe betoni është 328 m^3, pra një diferencë prej **297** m^3 të likuiduar më tepër. Tabela e mëposhtme tregon llogaritjet përkatëse.

Ndertimi mur me blloqe betoni, piketat	Njesia	Gjatesi	Gjeresi	Lartesia ne fakt	Lartesia sipas LM	Volumi ne fakt	Volumi sipas LM	Diferenca
30+996 - 31+0.16	m^3	25	0.3	1.25	2.5	9.375	18.75	9.375
30.760 - 30+778	m^3	20	0.3	1.25	2.5	7.5	15	7.5
30+705 - 30+720	m^3	22	0.3	1.25	2.5	8.25	16.5	8.25
30+693 - 30+704	m^3	15.2	0.3	1.25	2.5	5.7	11.4	5.7
30+680 - 30+688	m^3	15	0.3	1.25	2.5	5.625	11.25	5.625
30+494 - 30+496	m^3	5	0.3	1.25	2.5	1.875	3.75	1.875
30+463 - 30+490	m^3	35	0.3	1.25	2.5	13.125	26.25	13.125
30+450 - 30+456	m^3	10	0.3	1.25	2.5	3.75	7.5	3.75
30+425 - 30+443	m^3	25	0.3	1.25	2.5	9.375	18.75	9.375
30+405 - 30+423	m^3	18	0.3	1.25	2.5	6.75	13.5	6.75
29+332 - 29+390	m^3	58	0.3	1.25	2.5	21.75	43.5	21.75
26+900 - 26+924	m^3	25	0.3	1.25	2.5	9.375	18.75	9.375
26+874 - 26+888	m^3	15	0.3	1.25	2.5	5.625	11.25	5.625
26+826 - 26+846	m^3	14	0.3	1.25	2.5	5.25	10.5	5.25
26+750 - 26+789	m^3	34	0.3	1.25	2.5	12.75	25.5	12.75
26+629 - 26+648	m^3	20	0.3	1.25	2.5	7.5	15	7.5
26+444 - 26+540	m^3	90	0.3	1.25	2.5	33.75	67.5	33.75
26+360 - 26+385	m^3	35	0.3	1.25	2.5	13.125	26.25	13.125
25+944 - 25+964	m^3	20	0.3	1.25	2.5	7.5	15	7.5
25+500 - 25+540	m^3	45	0.3	1.25	2.5	16.875	33.75	16.875
25+432 - 25+460	m^3	42	0.3	1.25	2.5	15.75	31.5	15.75
25+134 - 25+161	m^3	30	0.3	1.25	2.5	11.25	22.5	11.25
24+526 - 24+586	m^3	66	0.3	1.25	0.7	24.75	13.86	-10.89
24+444 - 24+450 maj	m^3	20	0.3	1.25	2.5	7.5	15	7.5
24+440 - 24+478 dj	m^3	42	0.3	1.25	2.5	15.75	31.5	15.75
24+402 - 24+432	m^3	42	0.3	1.25	2.5	15.75	31.5	15.75
24+390 - 24+455 dj	m^3	57	0.3	1.25	2.5	21.375	42.75	21.375
23+014 - 23+030	m^3	30	0.3	1.25	3	11.25	27	15.75
Totali						**328.2**	**625.3**	**297.06**

2. *Kontrata bazë, kapitulli B3, zëri i themel me mur guri për muret rrethues*
Në librezat e masave pasqyrohen dhe paguar në situacionin përfundimtar volumin prej 640 m^3. Nga verifikimet me sondazhe të mureve në terren rezulton lartësia e themelit 0.8 m me gjerësi 0.7 m. Nga rillogaritjet e volumeve rezulton se volumi i themeleve të mureve është sasia prej 490 m^3, pra një diferencë prej **150** m^3 të likuiduar më tepër. Tabela e mëposhtme tregon llogaritjet përkatëse.

Themeli I muri piketat	Njesia	Gjatesi	Gjeresi	Lartesia ne fakt	Lartesia sipas LM	Volumi ne fakt	Volumi sipas LM
30+996 - 31+0.16	m^3	25	0.7	0.8	1	14	17.5
30.760 - 30+778	m^3	20	0.7	0.8	1	11.2	14
30+705 - 30+720	m^3	22	0.7	0.8	1	12.32	15.4
30+693 - 30+704	m^3	15.2	0.7	0.8	1	8.512	10.64
30+680 - 30+688	m^3	15	0.7	0.8	1	8.4	10.5
30+494 - 30+496	m^3	5	0.7	0.8	1	2.8	3.5
30+463 - 30+490	m^3	35	0.7	0.8	1	19.6	24.5
30+450 - 30+456	m^3	10	0.7	0.8	1	5.6	7
30+425 - 30+443	m^3	25	0.7	0.8	1	14	17.5
30+405 - 30+423	m^3	18	0.7	0.8	1	10.08	12.6
29+332 - 29+390	m^3	58	0.7	0.8	1	32.48	40.6
26+900 - 26+924	m^3	25	0.7	0.8	1	14	17.5
26+874 - 26+888	m^3	15	0.7	0.8	1	8.4	10.5
26+826 - 26+846	m^3	14	0.7	0.8	1	7.84	9.8
26+750 - 26+789	m^3	34	0.7	0.8	1	19.04	23.8
26+629 - 26+648	m^3	20	0.7	0.8	1	11.2	14
26+444 - 26+540	m^3	90	0.7	0.8	1	50.4	63
26+360 - 26+385	m^3	35	0.7	0.8	1	19.6	24.5
25+944 - 25+964	m^3	20	0.7	0.8	1	11.2	14
25+500 - 25+540	m^3	45	0.7	0.8	1	25.2	31.5
25+432 - 25+460	m^3	42	0.7	0.8	1	23.52	29.4
25+134 - 25+161	m^3	30	0.7	0.8	1	16.8	21
24+526 - 24+586	m^3	66	0.7	0.8	1	36.96	46.2
24+444 - 24+450 maj	m^3	20	0.7	0.8	1	11.2	14
24+440 - 24+478 dj	m^3	42	0.7	0.8	1	23.52	29.4
24+402 - 24+432	m^3	42	0.7	0.8	1	23.52	29.4
24+390 - 24+455 dj	m^3	57	0.7	0.8	1	31.92	39.9
23+014 - 23+030	m^3	30	0.7	0.8	1	16.8	21
Totali						**490.112**	**612.6**
Likuiduar ne situacionin perfundimtar							**640**

3. Kontrata bazë, kapitulli C dhe në fondin rezervë, zëri mbushje, shpërndarje dhe ngjeshje e materialit te seleksionuar, te aprovuar paraprakisht nga Mbikëqyrësi I punimeve (zhavorr, çakall minash, etj) ne nivelin dhe profilin e kërkuar.

Në librezat e masave pasqyrohet volumi prej 153,072 m^3 dhe në situacionin përfundimtar është paguar volumin prej 152,548 m^3. Nga verifikimet e projektit të azhornuar rezulton se mbushjeve të trupit të rrugës nuk është zbritur volumi që zënë tombinot. Nga rillogaritjet e volumeve të tombinove rezulton se volumi që duhej zbritur në librezën e masave është 1,059 m^3 dhe sasia që duhej paguar është (153,072 m^3- 1,059 m^3= 152,013 m^3). Pra diferencë prej 535 m^3 është likuiduar më tepër. Tabela e mëposhtme tregon llogaritjet përkatëse.

Km piketa	Gjerësi	Lartësi	Gjatësi	Volumi
23+029	2.5	1.5	40.71	153
24+175.8	2.5	2.5	21.6	135
24+492.6	2.5	1.55	25.08	97
25+382.6	2.5	2.5	34.36	215
25+414.05	1.75	1.7	13.83	41
26+110.42	2.5	2	14.6	73
29+613.014	3.6	2.6	30.88	289

29+613.014	1.2	1.2	17.38	25
31+021.66	2	1.3	12	31
				1,059
Sasia ne librezën e masave				153,072
Sasia e likuiduar				152,548
Sasia që duhej likuiduar (153,072-1059)				**152,013**

4. Kontrata shtesë, kapitulli D3,shtresë çakulli mbeturine kave t=10cm.
Në librezën e masave dhe në situacion është likuiduar volumi prej 7,387 m^2. Nga rillogaritjet rezulton sasia prej 7,349 m^2.

5. Kontrata shtesë, kapitulli D4, Beton klas 20/20 t=10cm për trotuar.
Në librezat e masave pasqyrohet volumi prej 790 m^3 dhe në situacionin përfundimtar është paguar volumin prej 790 m^3. Nga verifikimet e projektit të azhornuar rezulton se zëri i betonit për trotuar nuk është zbritur volumi që zënë fidanët (495 m2) dhe pusetat me kapak gize (58m2)
.
Nga rillogaritjet e volumeve të betonit rezulton se volumi që duhej likuiduar është sasia prej 735 m^3. Pra diferencë prej 55.3 m^3 beton e likuiduar më tepër. Tabela e mëposhtme tregon llogaritjet përkatëse.

Beton klas 20/20 t=10 cm per trotur	Siperfaqa	Lartesia	Sasia
Shuma S1 -S24 (Djathtas +Majtas)	**7901.9**	0.1	**790.2**
Zbriten fidane + puseta	553	0.1	55.3
Total			**735 m^3**

6. Kontrata shtesë, kapitulli D5, Shtrese trotuari me pllaka betoni 10x20x6 cm, vetështrënguese
Në librezat e masave pasqyrohet volumi prej 7900 m^2 dhe në situacionin përfundimtar është paguar volumin prej 7902 m^2. Nga verifikimet e projektit të azhornuar rezulton se zëri i shtresës trotuari me pllaka betoni 10x20x6, nuk është zbritur volumi që zënë fidanët (495 m2) dhe pusetat me kapak gize (58m2). Nga rillogaritjet e volumeve rezulton se sasia që duhej likuiduar është sasia prej 7,349 m^2. Pra diferencë prej 553 m^2 e likuiduar më tepër. Tabela e mëposhtme tregon llogaritjet përkatëse.

Shtrese trotuari me pllaka betoni 10x20x6cm veteshtrenguese			
Djathtas	Njesia	Siperfaqa	Sipas LM, likuidimit
Shuma S1 -S24 (Djathtas +Majtas)		**7902**	**7902**
Zbriten fidane + puseta		553	
Total		**7,349 m^2**	

7. Kontrata shtesë, kapitulli D13, Beton klas 25/20 per kunete dhe bordure.
Në llogaritjet e librezave të masave rezulton sasia prej 608 m^3 dhe në situacionin përfundimtar paraqitet volumi i likuiduar prej 428 m^3. Nga verifikimet në terren dhe librezës së masave rezultoi se gjatësia e kunetës dhe lartësia e kundrabordurës nuk përputheshin me librezën e masave. Duke rillogaritur sipërfaqet në fakt të betoneve rezultoi sasia prej 377.6 m^3. Tabela e mëposhtme tregon llogaritjet përkatëse.

Beton 25/20 per kunete, kundrabordurat	Njesia	Gjatesi	Siperfaqe ne LM	Siperfaqe ne Fakt	Sasia sipas LM	Sasia fakt
Majtas						
23+084-0+094	m3	117	0.026	0.02	3.042	2.34
0+224-0+320	m3	96.3	0.026	0.02	2.5038	1.926

1+400-1+633	m3	228.4	0.026	0.02	5.9384	4.568
1+642-1+884	m3	244	0.026	0.02	6.344	4.88
1+898-1+925	m3	27.3	0.026	0.02	0.7098	0.546
1+941-1+957	m3	16	0.026	0.02	0.416	0.32
1+980-25+414	m3	346	0.026	0.02	8.996	6.92
0+010-0+262	m3	272	0.026	0.02	7.072	5.44
0+269-0+393	m3	124	0.026	0.02	3.224	2.48
Djathtas						
23+002-0+233	m3	291.5	0.026	0.02	7.579	5.83
0+248-0+348	m3	100	0.026	0.02	2.6	2
1+408-1+533	m3	124	0.026	0.02	3.224	2.48
1+558-1+577	m3	19.5	0.026	0.02	0.507	0.39
1+600-2+160	m3	557.7	0.026	0.02	14.5002	11.154
2+173-2+187	m3	7.2	0.026	0.02	0.1872	0.144
0+013-0+054	m3	41	0.026	0.02	1.066	0.82
0+060-0+397 (+3m)	m3	342	0.026	0.02	8.892	6.84
Kuneta						
Majtas						
23+086-0+210	m3	237	0.12	0.072	28.44	17.064
0+224-0+378	m3	153.8	0.12	0.072	18.456	11.0736
0+385-0+626	m3	246.5	0.12	0.072	29.58	17.748
0+719-0+731	m3	12.3	0.12	0.072	1.476	0.8856
0+746-0+800	m3	54	0.12	0.072	6.48	3.888
0+895-1+096	m3	204.6	0.12	0.072	24.552	14.7312
1+098-1+140	m3	42.6	0.12	0.072	5.112	3.0672
1+400-1+634	m3	230	0.12	0.072	27.6	16.56
1+642-1+883	m3	242.8	0.12	0.072	29.136	17.4816
1+898-1+925	m3	27	0.12	0.072	3.24	1.944
1+941-1+957	m3	16	0.12	0.072	1.92	1.152
1+980-25+422	m3	352	0.12	0.072	42.24	25.344
0+010-0+260	m3	250	0.12	0.072	30	18
Degezimi	m3	7.8	0.12	0.072	0.936	0.5616
0+269-0+393	m3	124	0.12	0.072	14.88	8.928
Djathtas				0.072	0	0
23+002-0+233	m3	292	0.12	0.072	35.04	21.024
0+248-0+348	m3	96.5	0.12	0.072	11.58	6.948
0+356-0+426	m3	68.2	0.12	0.072	8.184	4.9104
0+440-0+598	m3	158.2	0.12	0.072	18.984	11.3904
0+605-0+687	m3	83	0.12	0.072	9.96	5.976
0+690-0+780	m3	119.4	0.12	0.072	14.328	8.5968
0+792-0+800	m3	16.34	0.12	0.072	1.9608	1.17648
1+120-1+125	m3	24	0.12	0.072	2.88	1.728
1+125-1+160	m3	41.77	0.12	0.072	5.0124	3.00744
1+163-1+178	m3	14.87	0.12	0.072	1.7844	1.07064
1+400-1+408	m3	7.6	0.12	0.072	0.912	0.5472
1+408-1+533	m3	125.6	0.12	0.072	15.072	9.0432
1+558-1+577	m3	19.7	0.12	0.072	2.364	1.4184

1+600-2+160	m3	559	0.12	0.072	67.08	40.248
2+160-2+173	m3	20.24	0.12	0.072	2.4288	1.45728
2+187-fund	m3	186	0.12	0.072	22.32	13.392
sexioni 71-0+052	m3	43	0.12	0.072	5.16	3.096
Degezimi	m3	10.8	0.12	0.072	1.296	0.7776
0+065-0+397 (3m)	m3	337.6	0.12	0.072	40.512	24.3072
Totali					**607.7**	**377.6**
Sasia e likuiduar ne situacionin perfundimtar					**428.0**	

Tabela e mëposhtme përmbledh diferencat e punimeve.

Zëri	Përshkrimi I punimit	Paguar sipas situacionit				Realizuar në fakti, bazuar LM dhe verifikimet			
		Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera	Sasia	Çmimi	Vlera	Dif.
	Kontrata baze			(Lekë)	(Lekë)		(Lekë)	(Lekë)	(Lekë)
B2	Ndertim mur rrethues me blloqe betony	m3	625	8,000	5,000,000	328	8,000	2,625,600	2,374,400
B3	Themel me mur guri per muret rrethues	m3	640	6,000	3,840,000	490	6,000	2,940,000	900,000
C5+F.R	Mbushje shperndarje, materialit	m3	152,548	1,010	154,073,480	152,013	1,010	153,533,130	540,350
	Kontrata shtese								
D3	Shtrese cakulli mbeturine kave t=10cm	m2	7,387	393	2,903,091	7,349	393	2,888,157	14,934
D4	Beton klas 20/20 t=10cm per trotuar	m3	790	8,500	6,715,000	735	8,500	6,247,500	467,500
D5	Shtrese trotuari me pllaka betoni	m2	7,902	1,431	11,307,762	7,349	1,431	10,516,419	791,343
D13	Beton klas 25/20 per kunete dhe bordure	m3	428	10,000	4,280,000	378	10,000	3,776,000	504,000
								Shuma:	**5,592,527**
								TVSH	**1,118,505**
								TOTAL	**6,711,032**

Si përfundim, nga kontraktori "AG" sh.p.k & "HA" sh.p.k**, janë përfituar padrejtësisht punime të pakryera, duke i shkaktuar dëm ekonomik ARRSH dhe buxhetit të shtetit në vlerën 5,592,527 lekë pa TVSH, e cila duhet të zbritet nga vlera e garancisë së punimeve.**

4.7. ***Nga auditimi i procedurës së prokurimit për shtesën e kontratës me objekt: "Ndërtim i rrugës Lushnje-Berat, Loti 3" u konstatua se:***

Ndërtimi i rrugës Lushnje-Berat loti 3, ka një gjatësi L=9,335 m, ku Loti 3 fillon nga progresivi 22+924 km deri në 32+260 km, me gjerësi të shtresës asfaltike 11m. Kontrata e punës publike nr. 1181/6 prot. datë 03.05.2013 të lidhur midis Autoritetit Rrugor Shqiptar, përfaqësuar nga ish-drejtori i përgjithshëm TT dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "AG" sh.p.k & "HA" sh.p.k, përfaqësuar nga z. AA dhe PP, ka vlerën e kontratës bazë 1,166,460,075 me TVSH.

Në bazë të kërkesës për ndërhyrje nga Bashkia e Urës Vajgurore nr. 295 datë 02.07.2013, kërkohet plotësimi i segmentit të ngelur nga rreth-rrotullimi i fshatit Çiflik dhe përfundon tek rreth-rrotullimi në dalje të qytetit të Urës Vajgurore, me gjatësi rreth 2 km, ku kontraktori bashkë me mbikëqyrësin e punimeve kanë hartuar projekt-preventivi për zbatimin e punimeve në këtë segment.

Në vendimin e Këshillit Teknik deklarohet se segmenti prej 2 km, është jashtë investimit të kontratës nr. 118/6 datë 03.05.2013 "Ndërtim i rrugës Lushnje-Berat, Loti 3".

Me vendimin e Këshillit Teknik 24.07.2013, është miratuar në parim projekt-preventivi për objektin: "*Rikonstruksioni rruga rrethrrotullimi i Ciflikut i mbarimit të by-passit të Urës Vajgurore*".

Gjurma e rrugës për tu rikonstruktuar kalon në zonë fushore, ku zhvillimi planimetrik është në përgjithësi shumë i mirë dhe ku veprat kryesore të artit kërkojnë vetëm rikonstruksion të shtresave të asfaltit dhe rindërtimin e trotuareve. Gjendja e pjesës së asfaltuar varion nga 9 m deri në 13 m me trotuare në shumicën e rasteve në të dy anët. Me kërkesën për opinion nr. 3411/1 datë 08.07.2013 të ARRSH, drejtuar kontraktorit dhe mbikëqyrësit projekt-preventivi i shtesës së punimeve përfshin:

A. Prishje dhe pastrime, B. Punime dheu, C. Punime rruge dhe shtresash rrugore, D. Punime trotuari, E. Punime elektrike, F. Punime ndihmëse në rrugë dhe të ndryshme.

Me relacionin teknik nr. 1579 prot. datë 01.04.2014, drejtuar Drejtorisë Juridike, miratohet rikonstruksioni i rrugës nga Drejtoria e ZHPBHSH, Drejtoria e PBHT dhe nga Drejtori i Përgjithshëm. Fondet për rikonstruksionin e rrugës nga rreth rrotullimi i Çiflikut deri tek dalja e qytetit të Urës Vajgurore, janë planifikuar në plan buxhetin e vitin 2014, si shtesë punimesh në objektin "Ndërtimi i rrugës Lushnje-Berat". Çmimet e përdorura për llogaritjen e fondit limit për këtë objekt, janë sipas çmimeve të preventivit të kontratës bazë.

-Me urdhrin e prokurimit nr. 03 datë 02.04.2014, të titullarit të ARRSH z. Dashamir Xhika, urdhërohet të kryhet procedura e prokurimit me objekt "Ndërtimi i rrugës Lushnje-Berat (shtesë punimesh) me fond limit 197,250,289 lekë me TVSH.

Të dhëna për tenderin	Komisioni i Negocimit	Njësia e Prokurimit
1. Urdhër Prokurimi nr. 03, datë 02.04.2014 2. Vlera e përllogaritur e kontratës: 197,250,289 lekë, me TVSH 3. Procedurë me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës 4. Data e zhvillimit të negocimit: 04.04.2015 5. Firma Fituese "AG" sh.p.k & "HA" sh.p.k 6. Lidhjes së kontratës: 1623/5 datë 07.04.2014 7. Vlera e kontratës: 197,244,889 lekë me TVSH. 8. Diferenca nga fondi limit: 5,400 lekë		
Është ftuar për negociatë 1 operatorë ekonomik.	Kualifikuar 1 O.E	

-Lloji i procedurës është përcaktuar "Negocim pa shpallje", me kontraktuesin e mëparshëm BO " AG" sh.p.k & "HA" sh.p.k, parashikuar nga neni 33/5/a të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe pikës 5, kreu IV,"Rregullat e prokurimit publik" miratuar me VKM nr.1 datë 10.01.2007, i ndryshuar, *sepse ka të bëjë me zgjatjen e kontratave të punëve, pasi nevoja për punë shtesë është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara, që nuk varen nga autoriteti kontraktor dhe që nuk mund të ndalen, teknikisht ose ekonomikisht, nga kontrata fillestare, pa sjellë ndikime negative ose kosto të mëtejshme për autoritetin kontraktor, por që janë të nevojshme për përfundimin e kontratës fillestare. Vlera e punimeve shtesë nuk tejkalon 20% të vlerës së kontratës fillestare. Gjithashtu citohet se arsyetimi teknik jepet në relacionin përkatës të Drejtorisë së PBHT-së dhe ZHPBHSH-së.*

Zgjedhja e procedurës me "Negocim pa shpallje", për shtesën e kontratës së ndërtimit të segmentit Lushnje-Berat, Loti 3, bazuar projektit, vendimit të Këshillit Teknik nr. 24.07.2013, ***nuk ka qenë në asnjë rast në përputhje me rrethanat e përcaktuara të VKM nr.1 datë 10.01.2007, i ndryshuar pika 5, kreu IV, duke shmangur një procedurë të re prokurimi të llojit "I hapur", dhe ngarkon me përgjegjësi titullarin e ARRSH.***

Me procesverbalin nr. 2 datë 04.04.2014, është mbledhur komisioni i negocimit, njësia e prokurimit dhe kontraktori, i cili paraqiti ofertën ekonomike me vlerë 197,244,889 lekë me TVSH.

Lidhur me auditimin e zbatimit të kontratës "Rikonstruksion i rrugës Shkodër (Mbikalimi i trenit) – Mes".

Koment nga mbikëqyrësi i punimeve.

Mbikëqyrësi i punimeve NN ka paraqitur vërejtjet për auditimin e zbatimit të kontratës "Rikonstruksion i rrugës Shkodër (Mbikalimi i trenit) – Mes".

Mbikëqyrësi i punimeve pretendon se sipërfaqja e pëmëve për trotuaret është zbritur, madje jo të gjitha pemët janë mbjellë në trotuare. 48 pemë janë mbjellë në skarpata. Në observacion paraqitet sipërfaqja e trotuareve e cila është realizuar 55.9 m^2 më shumë se ajo e likuiduar në fakt. Pas riverifikimit të dokumentacionit rezulton se vërejtjet qëndrojnë dhe merret në konsideratë duke bërë reflektimet në projektraportin e auditimit.

Në lidhje me vijëzimin në aks me bojë termoplastike pretendohet se pavarësisht se është futur e gjithë gjatësia me vijëzim të ndërprerë, gjatësisë faktike i është shtuar edhe vijëzimi i rotondove. Gjithashtu referuar librezës së masave dhe situacionit përfundimtar rezulton se është likuiduar më pak sasia 915.2 ml. Ky fakt merret në konsideratë nga grupi i auditimit.

Sa i takon shtresave të zhavorrit, merret në konsideratë fakti se për trotuaret është realizuar një shtresë dhe jo dy siç është paraqitur në materialin e auditimit. Ky fakt merret në konsideratë edhe për sasinë e trajtuar si pasojë e mos rakordimit të sasisë së shtresës së binderit me atë të zhavorrit dhe reflektohet në projektraportin e auditimit.

Sa i takon zërit gërmim dheu me ekskavator, merret në konsideratë fakti se në manualin e çmimeve të ndërtimit ka disa zëra të ngjashëm ndër të cilat zëri 3/123/a me çmim 496 lekë/m^3, zëri 3, An-49 me çmim 2,366 lekë/m^3.

Sa i takon mbjelljes së pemëve, në vërejtje cilësohet fakti se në specifikimet teknike nuk ka patur përcaktim për dimensionin e pemëve. Nga verifikimi rezulton se realisht nuk ka një përcaktim të tillë, i cili është përshkruar vetëm në faqet e projektit i cili ka ndryshuar. Merret në konsideratë fakti se në periudhën e hartimit të dokumenteve të tenderit nuk ka patur në manual zë i cili të psecifikojë çmimin e pemëve në varësi të dimensionit të trungut. Ndërsa në manualet e vitit 2015 është specifikuar çmimi por jo referuar diametrit, por perimetrit dhe për rastin konkret për pemë dekorative bli 16 deri 18 cm është përcaktuar zëri në manualin nr. 3, An 169.

Grupi i auditimit, mbështetur në sa më sipër pranon "vërejtjet" dhe i reflektohen në projektraportin e auditimit, pasi çmimi referuar perimetrit të pemëve të mbjella (afërsisht 17 cm), është më i lartë se çmimi i tenderuar dhe likuiduar, ose 16,013 lekë, ndërsa çmimi i likuiduar është 9,610 lekë për copë.

Lidhur me auditimin e procedurës së tenderit me objekt "Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale dhe horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore" loti parë i zhvilluar në vitin 2015 i fituar nga BOE MM & KK konstruksion sh.p.k..

Koment i subjektit të audituar.

Koment i përmbledhur nga DD Shehu me detyrë specialiste në sektorin e preventivit dhe IR me detyrë përgjegjëse e sektorit të preventivëve (shkresa Nr.5079/12 datë 10.07.2017 në lidhje me projektraportin).

... Manualet dhe analizat teknike vijnë pranë institucionit tonë për njohje dhe zbatim (me shkresën nr.3954/1 datë 23.07.2015 MTI dërgon VKM Nr.629 datë 15.07.2015. Përditësimi i manualeve dhe shqyrtimi i analizave teknike është kompetencë e MTI.

...Detyra jonë ka filluar me përgatitjen e preventivit të fondit limit (me çmime –pa çmime) për fillimin e procedurës së prokurimit mbas kryerjes së procedurave të mëposhtme:

-Dorëzimi në arkivën e ARRSH-së më datë 31.07.2015 të projekt-preventivit të shoqëruar me analiza teknike çmimi, firmosur dhe vulosur fletë më fletë nga shoqëria projektuese "Spahera shpk".
- Miratimi me Vendim të Këshillit Teknik Nr.54 prot 6575 datë 03.08.2015 dhe kryerjes së oponencës nga Insituti i Ndërtimit datë 20.07.2015 (Shih kopje e shkresës bashkëngjitur nr.295/3 datë 20.07.2015.
...Nga ana jonë është përgatitur dhe nënshkruar një fond limit mbështetur në preventivin e projektuesit dorëzuar 31.07.2015, ku çmimet e aplikuar në preventivin e projektuesit janë ato të manualit sapo hyrë në fuqi nr.629 datë 15.07.2015, ndërsa zërat me shënimin cmim projektuesi të reflektuara në preventiv janë të shoqëruara me analiza teknike. Shprehemi se këto analiza janë bazuar në formatin e unifikuar dhe nuk kanë gabime aritmetike. Pasqyrimi i të dhënave në analizë është kompetencë e hartuesit, ndërsa shqyrtimi dhe vlerësimi bëhet nga MTI.

Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron:
Argumentet e mësipërme pranohen dhe reflektohen në Raportin Përfundimtar.

Koment i përmbledhur.
Projektuesi, subjekti "SP" sh.p.k. me shkresë Nr.5797 datë 14.07.2017 ka dorëzuar observacion në lidhje me projektraportin.
....Numri rendor 8 i preventivit me emërtim zëri punimi "Tabelë plotësuese 240x60cm". Analiza referuese sipas manualit të cmimeve VKM Nr.629 datë 15.07.2015 e përdorur nga projektuesi është AN 68 , F.V Sinjalet e drejtimit interurban HxL e madhe 70x250 cm. Sic shikohet përmasat 250x70cm të An 68 janë shumë të përafërta me përmasat 240x60 të analizës nr.8. Ndërsa analiza referuese sipas manualit të cmimeve VKM NR.629 datë 15.07.2015 e përdorur nga audituesit është AN 156 "FV tabela treguese 150x40 cm është shumë larg nga përmasat 240x60cm të analizës tone nr.8.
...Numri rendor 12 i preventivit me emërtim zëri punimi "Tabela të mëdha informative 200x150cm". Analiza referuese sipas manualit të cmimeve VKM Nr.629 datë 15.07.2015 e përdorur nga projektuesi është AN 113 "F.V Sinjale për autostrada,rrugë interurbane kryesore 300x180cm" Sic shikohet përmasat 300x180cm të An 113 janë shumë të përafërta me përmasat 200x180 cm të analizës tonë Nr.12. Ndërsa analiza referuese sipas çmimit të manualit të cmimeve të VKM Nr.629 datë 15.07.2015 e përdorur nga audituesit është AN 162 "FV tabela te medha informative + bazamenti U, H=5.5.
...Numri rendor 14 i preventivit me emertim zeri punimi "Vijezim shirita gjatësor dhe anesor me gjeresi 15cm.Termoplastike (spray)".
Analiza referuese sipas manualit të cmimeve VKM Nr.629 datë 15.07.2015 e përdorur nga projektuesi eshte AN 130 "Vijezim shirita gjatësor dhe anesor me gjeresi 15cm. Termoplastike (sprajt). Sasia e bojes per zerin NR.14 ne raport me An 130 është 0.12 litra pranuar dhe nga audituesit . Por ne realizimin e vijezimit te nderprere kostoja makineri ndryshon nga vijezimi i panderprere per shkak te proceseve teknologjike ne dukje te njejte por qe ndryshojne sepse produkti nuk eshte i njejte. Procese teknologjike nuk jane te njejte ne te gjithe procesin. Procesi i programimit te sprucimit te bojes ne te dy rastet eshte i ndryshem.Kosto mirëmbajtje eshte me e larte dhe kosto punëtori duke qene ne varesi te kostos makineri ndryshon ne te njejtin raport si kostoja makineri.

Për sa më sipër grupi i auditimit sqaron se:
Argumentet e mësipërme pranohen dhe reflektohen në Raportin Përfundimtar.

4.8. "**Implementimi i sistemit të menaxhimit të trafikut",** me fond limit 53,667,299 lekë, është realizuar nëpërmjet procedurës "Me mjete elektronike", bazuar në Ligjin Nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe VKM Nr.914 datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik".
Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen përkatëse për këtë procedurë, rezultoi si më poshtë:

Të dhëna për tenderin	Komisioni i Prokurimit	Njësia e Prokurimit
A	**b**	**c**
Urdhër Prokurimi Nr.51 datë 16.10.2015 Urdhër për ngritjen e KVO Nr.51/1 datë 16.10.2015. Fondi limit pa tvsh: 53,667,299 lekë Procedura"Procedurë e hapur elektronike". Data e zhvillimit të tenderit, 12.11.2015 Afati i realizimit: 2 muaj		

I. Termat e refencës, specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur në ARRSH, përkatësisht DD, AD, DD dhe DA. Qëllimi i aplikimit të sistemve të përcaktuara në termat e referencës është marrja e të dhënave të sakta të trafikut në 17 akse kombëtare. Për përcaktimin e çmimeve të zërave të preventivit të cilat nuk ndodhen në manualit e çmimeve të ndërtimit, janë marrë oferta nga tregu, përkatësisht nga operatorët "SC", "MA", "AS". Ofertat e dhëna nga këta operatorë ekonomik janë pa datë dhe me vlera afërsisht të njëjta, fakt që i bën ofertat e marra nga tregu të dyshimta dhe në mospërputhje me Neni 59 "Përllogaritja e vlerës limit të kontratës", të VKM Nr.914 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK", ku citohet "*Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës*".
Në preventivin e objektit të prokurimit, janë parashikuar disa punime ndërtimi si prerje-prishje asfalti, shtresë asfaltobetoni me makineri. Vlerën kryesore të preventivit e përbën vendosja e pajisjeve eletronike dhe elektrike si: sensor detektimi, UPS, panele, automate, kontroller sensori, touchpanele, sëitche, patch etje. Gjithashtu është kërkuar ndërtimi i një programi për përpunimin e të dhënave dhe mirëmbajtja e sistemit.
Mbi këto terma referenca janë hartuar dokumentet standarde të tenderit nga Njësia e Prokurimit në procesverbalin Nr.1 datë 16.10.2015, ku janë përcaktuar kriteret e përgjithshme të kualifikimet dhe kriteret e vecanta të kualifikimit.
4.8.1. Në Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) janë kërkuar licencat NP-1A(Punime gërmimi në tokë), NP-14A (Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha..), NP-10A (Ndërtimi i impjanteve për prodhimin e energjisë elektrike), NP-11A (Ndërtime për N/Stacione, kabinat e transformatorëve, linja të TV e mesëm dhe shpërndarje të energjisë), NP-12A (Punime të inxhinierisë së mjedisit), NS-1A (Punime për prishjen e ndërtimeve), NS-4A(Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plasti metalik dhe xhami, rifiniture të natyrës teknike ndërtuese), NS-5A (Impjante të sinjalistikës ndricuese të trafikut), NS-6A (Sinjalistika rrugore jo ndricuese), NS-13B (Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni), NS-14B (Impjante të brendëshme elektrike, telefoni, radiofoni, TV, etje), NS-18A (Punime gjeodezike), NS-19A (Sisteme kundrazhurmës për infrastrukturë).
Duke parë përmbajtjen e zërave të preventivit evidentohet se disa prej licencave të vendosura në DST, nuk kanë asnjë lidhje me natyrën e tij. Përkatësisht licenca:
- NP-10A (Ndërtimi i impjanteve për prodhimin e energjisë elektrike) nuk lidhet me natyrën e punimeve, sepse në kontratë nuk synohet të prodhohet energji elektrike me ndonjë pajisje.

4.8.2. Në Dokumentet Standarde të Tenderit është kërkuar staf i punësuar për periudhën Gusht 2014-Korrik 2015, si vijon:
- 3 (tre) inxhinier ndërtimi.
- 4 (katër) inxhinier elektrike.
- 3 (tre) inxhinier elektronik.
- 2 (dy) inxhinier mekanik, ku njëri prej tyre të ketë master për "Planifikim Transporti, menaxhim trafiku dhe siguri rrugore).
- elektricistë të specializuar dhe administratorë të rrjeteve kompjuterike 8 (tetë).
- 2 (dy) manovratorë

Duke parë zërat e punimeve të preventivit, ku kryesisht janë furnizim vendosje pajisjesh elektronike dhe elektrike, kërkesa për:
Tre inxhinier ndërtimi është e ekzagjeruar sepse punimet e ndërtimit janë shumë të pakta në volume, përkatësisht 450m2 prishje dhe shtrim asfaltobetoni. Do të ishte i mjaftueshëm vetëm 1 inxhinier ndërtimi për realizimin e këtij volumi.
Katër inxhinier elektrikë dhe tre inxhinier elektronik, kërkesë kjo jo në përpjesitim me punimet e parashikuara në preventiv dhe me vlerën e kontratës.
Dy inxhinier mekanik ku njëri prej tyre të jetë me master, ku kërkesa në lidhje me masterin është ekzagjeruar, sepse do të mjaftonte një inxhinier mekanik për të menaxhuar sistemin.
Tetë elektricistë te specializuar dhe administratorë të rrjeteve kompjuterike, kërkesë kjo e ekzagjeruar, sepse vetë sistemi që do të ngrihet ka vetëm një rrjet kompjuterik kontrolli i cili do të jetë i instaluar në ARRSH dhe nuk kuptohet ku do të punojnë këta administratorë rrjetesh kompjuterike
Dy manovratorë, kërkesë kjo pa asnjë lidhje me natyrën e kontratës, sepse për të realizuar zërat e preventivit nuk nevojitet asnjë mjet i cili ka nevojë për drejtim nga manovratorë.

Në DST për ekzekutimin e objektit të prokurimit është kërkuar nga ofertuesit, dëshmi për fuqi punëtore me numër mesatar punonjësish të siguruar për periudhën Gusht 2014- Korrik 2015, jo më pak se 100 punonjes. Ky kriter është absolutisht i ekzagjeruar duke konsideruar llojin e punimeve që do të realizohen. Këtë fakt e përforcon edhe ditari i punimeve i paraqitur në dosjen e zbatimit të operatorit fitues, në të cilin për çdo ditë është shënuar që kanë punuar për realizimin e objektit jo më shumë se 10 punonjës. Gjithashtu nuk faktohet prania në kantier nëpërmjet ditarit të punimeve, e stafit të kualifikuar si inxhinier elektrikë, elektronike dhe mekanikë, ky fakt i bën edhe pak të lidhura me kontratën kërkesat në DST në lidhje me stafin.
Llogaritja e stafit dhe numrit të punonjësve të nevojshëm për realizimin e kontratës nuk është shoqëruar me asnjë analizë për të justifikuar numrin e kërkuar.

4.8.3. Në Dokumentet Standarde të Tenderit është kërkuar dëshmi për mjetet dhe pajisje teknike që duhet të disponojnë ofertuesit, ndër të tjera janë kërkuar:
- 5 kamiona me kapacitet mbajtës 16 ton.
- 1 autovinc me kosh.
- 2 vinça
- 2 fadroma
- 1 eskavator me goma
- 2 eskavatorë me zinxhir
- 1 minieskavator

Mjetet e kërkuara më sipër nuk kanë asnjë lidhje me punimet për realizimin e kontratës, sepse nuk evidentohet se çfarë do të transportojnë 5 kamionë 16 tonësh, 3 vinçat etje. Gjithashtu nuk kuptohet çfarë zhvendosin dhe gërmojnë 2 fadromat, 3 ekskavatorët dhe 1 mini ekskavator.
Këto mjete nuk nevojiten për realizimin e asnjërit prej zërave të preventivit të kontratës.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Nenin 1 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike" dhe Nenin 26, pika 5 dhe 8 të VKM Nr.914 "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK", ku citohet *"Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve",* "*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore". "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.* dhe ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit.

II. Më urdhër Nr.51/1 datë 12.11.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga DD, DH, DL, DM dhe DK.
Në datë 27.11.2015 ora 13.00 është bërë hapja e ofertave, ku janë paraqitur vetëm dy operatorë ekonomikë: "IT" sh.p.k, i cili ska paraqitur dokumentacion dhe MA sh.p.k i cili ka paraqitur ofertën 53,471,000 lekë pa t.v.sh. Në datë 04.12.2015 është hartuar raporti përmbledhës dhe është vendosur fituesi "MA" sh.p.k me vlerë oferte 53,471,000 lekë pa t.v.sh.

Si edhe vërehet mësipër, në prokurim janë paraqitur 2 ofertues, ku njëri prej të cilëve nuk ka paraqitur ofertë. Ky fakt konfirmon vendosjen e kritereve diskriminuese dhe jo në përpjesëtim me llojin e kontratës nga ana e Njësisë së prokurimit.

Në datë 04.12.2015 është hartuar raporti përmbledhës dhe është vendosur fituesi "MA" sh.p.k me vlerë oferte 53,471,000 lekë pa t.v.sh.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik fitues "MA" sh.p.k, u konstatua se ky operator ekonomik nuk i plotëson të gjitha kriteret e vendosura në DST.
Konkretisht:

4.8.4. Ne lidhje me kërkesën e DST për paraqitjen nga ofertuesit të një vërtetimi nga Autoriteti Rrugor Shqiptar nëpërmjet të cilit konfirmohet se nëse është fitues dhe/apo ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nënkontraktor, nje investim/investime, sipas nje kontrate apo kontratave të lidhura në proces per t'u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes se ofertave, i ka përfunduar punimet fizike në masën 70% të vellimeve të pergjithëshme të punës. Për operatorin ekonomik "MA" sh.p.k është lëshuar një referencë punimesh me Nr.8826 datë 05.10.2015 nga ARRSH, ku specifikohet se shoqëria "MA" sh.p.k në bashkëpunim me shoqëritë "KG" sh.p.k dhe "AL" sh.p.k po kryen kontratën e zbatimit Nr.705/6 datë 22.04.2013 të objektit "Ndërtim Rruga Unaza e Re e Tiranës, Seg. Komuna e Parisit – Shkolla Teknologjike" me vlerë 689,180,547 lekë më t.v.sh. Realizimi deri në datën 05.10.2015 është në vlerën 345,385,926 lekë me t.v.sh dhe në masën 49.47 %. Nga kjo shkresë vërtetohet se operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e DST, që të këtë përfunduar punimet fizike në masën 70% të të kontrate që është duke kryer për ARRSH. Kjo në kundërshtim edhe me Nenin 26, Pika 10 të VKM Nr.914 "Për rregullat e prokurimit publik".

4.8.5. Në lidhje me disponimin e makinerive për realizimin kontratës, ku sipas DST duhet të paraqiten dokumentet teknike (leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, lejen e transportit lëshuar nga komuna apo bashkia te vlefshme; dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij duhet të shoqërohet me kontratën perkatëse të qerase/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit te kontratës objekt i këtij prokurimi.

-Në DST janë kërkuar 2 mjete fadromë, operatori ekonomik ka paraqitur dy mjete, ku një prej të cilëve, përkatësisht mjeti Fadrome tip Caterpillar tip 938 F, me Matrikull Nr.2RM01377, e paraqitur me urdhër zhdoganimi 04.06.2013, nuk posedon leje qarkullimi, siguracion dhe kontroll teknik.

-Në DST është kërkuar një mini ekskavator, operatori ekonomik ka paraqitur një mjet minis ekskavator Tip JCB Mod 80-30z, Telaio 81230082 me urdhër zhdoganimi 04.10.2013, i cili nuk posedon leje qarkullimi, siguracion dhe kontroll teknik.

4.8.6. Në DST kërkohet që ofertuesit të ketë 8 (tete) elektriciste te specializuar dhe administratore te rrjeteve kompjuterike. Operatori ekonomik ”4-AM” sh.p.k ka paraqitur elektricitë me certifikatë IQT, por jo ndonjë certifikatë specifike që të vërtetojë aftësine e e punonjësve për administrimin e rrjeteve kompjuterike, të kërkuara sipas DST.
Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me Nenin 53 të Ligjit Nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike”, ku citohet “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji*” dhe dhe ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

III. U auditua zbatimi i kontratës në terren, ku ishte përcaktuar sipas termave të referencës dhe preventivit vendosja e sensorëve të detektimit të automjeteve në 17 akse rrugore kombëtare. U bë verifikimi në 4 pika (Vore – Fushe Krujë, Vorë-Durrës, Rrogozhine – Elbasan, Plepa – Rrogozhine) ku ishin instaluar pajisjet dhe sensorët ne trup të rrugës. Pajisjet ishin vendosur sipas specifikimeve teknike dhe sensorët funksiononin normalisht, duke bërë identifikimin e mjeteve që kalonin në rrugë.
Megjithëse në këtë kontratë ishin parashikuar të gjitha pajisjet të cilat mund të kryejnë transferimin e të dhënave në kohë reale nga akset në një sistemin qendror, nuk është parashikuar dhe vendosur furnizimi me internet në vendet ku janë instaluar sensorët. Ky fakt bën që të dhënat të merren manualisht në çdo aks dhe jo të kalojnë dhe përpunohen në kohë reale në sistemin qendror të ARRSH, ku administrohet dhe programi kompjuterik i parashikuar sipas kësaj kontrate.

4.8.7. Koment i subjektit
Njësia e prokurimit ka dërguar observacion në lidhje me konstatimet e projektraportit me shkresë Nr.5801/2 datë 14.07.2017

Në përgjithësi në komentet (observacionet) e njësisë së prokurimit, janë përsëritur të njëjtat argumente që janë bërë edhe për Akt konstatim nr. 6, të hartuar nga grupi i auditimit, të cilat me arsyetimet e paraqitura hollësisht në akt konstatim dhe projketraport, nuk qëndrojnë.

Në datë 07.06.2017 është dorëzuar observacion në lidhje me akt konstatimin nga komisioni i vlerësimit të ofertave .

4.8.7.5. Koment **i subjektit:**
Në lidhje me konstatimin tuaj se "Referuar shkresës Nr.8226 datë 5.10.2015 të ARRSH ku specifikohet se shoqëria MA në bashkëpunim me "KG" kanë realizuar punimet në masën 49.47% pra vërtetohet se operatori nuk përmbush kriterin e DST që të ketë përfunduar punimet fizike në masën 70% sqarojmë se VKM Nr.402 datë 13.05.2015 " Për ndryshim dhe shtesë në VKM Nr.914 datë 29.12.2014" sanksionon në raste përjashtimore të përligjura kur kushti i plotësimit të punimeve në masën 70% për kontraktorët nuk do të zbatohet. Konkretisht në VKM përcaktohet se: Ky kusht nuk do të zbatohet nëse operatorët ekonomik janë kontraktorë/nënkontraktorë në një investim dhe nuk i kanë përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, per shkaqe të përligjura si : vonesa si pasojë e ndërthurjes me një vepër tjetër në ndërtim, si KUZ, OSHEE, dëmtimi apo dalja në dritë e objekteve me vlera historike, vonesa në shpronësim, ndryshim në prioritetet e qeverisjes në financim, rishpërndarje fondesh si pasojë e emergjencave. Sa mësipër konstatimi juaj nuk qëndron pasi sipas vërtetimit të lëshuar (bashkëngjitur) operatori ekonomik nuk i ka realizuar 70% të punimeve për shkaqe të përligjura dhe të pavarur nga ai.

Sqarim i grupit të auditimit.
Komentet e mësipërme nuk merren në konsideratë, pasi sipas shkresës Nr.8226 datë 05.10.2015 lëshuar nga ARRSH për shoqërinë "MA" sh.p.k, specifikohet se punimet e kësaj kontrate nuk janë realizuar në masën 70% për arsyet : Moslirimi i sheshit të ndërtimeve dhe financimi i këtij objekti nuk ka qenë në përputhje me nevojat për përfundimin e punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë. Sipas VKM Nr.402 datë 13.05.2015, asnjë nga arsyet e mësipërme nuk përmendet tek shkaqet e përligjura për mos zbatimin e kushtit ku operatorët ekonomikë nuk duhet të dorëzojnë një vërtetim që kanë realizuar punimet fizike në masën 70%. Më konkretisht pika v) rishpërndarje e fondeve si pasojë e ndonjë emergjence, të justifikuara nga ARRSH, sipas dokumentacionit lëshuar nga ky i fundit, nuk lidhet me shkakun (financimi i këtij objekti nuk ka qenë në përputhje me nevojat për përfundimin e punimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë) e përmendur në shkresën Nr.8226 datë 05.10.2015 lëshuar nga ARRSH.

4.8.7.6. Koment i subjektit Në lidhje me konstatimet tuaja mbi mjetet e paraqitura nga operatori ekonomik konkretisht referuar gjetjes suaj se për mjetin mini ekskavator nuk është paraqitur leje qarkullimi, figuracion dhe kontroll teknik, sqarojmë se në DST është përcaktuar "{ër mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentet teknike (leje qarkulli, certifikatën e kontrollit teknik dhe figuracioni i mjetit. Ky mjet bën pjesë me mjetet teknologjike vetëlëvizëse me zinxhir dhe nuk pajiset me dokumentacion të tillë.

Sqarim i grupit të auditimit. Të gjitha mjetet me mjete gomë të cilat lëvizin në rrugë dhe nuk transportohen nga mjete të tjerë, e kanë të detyrueshme pajisjen me leje qarkullimi, siguracion dhe kontroll teknik, për rrjedhojë "*Vërejtja*", nuk qëndron.

*4.8.7.8. Koment i subjektit***:** *Në lidhje me pretendimin tuaj se operatori ekonomik ka paraqitur elektricistë me certifikatë IQT por jo ndonjë cerfikatë specifike që të vërtetojë aftësinë e punonjësve për administrimin e rrjeteve kompjuterike të kërkuara në DST theksojmë se kriteri i përcaktuar në tender ka qenë: elektricistë të specializuar dhe administratorë të rrjeteve kompjuterike, 8 (tetë) (të paraqiten me dëshmitë IQT), të cilët i ka paraqitur.*

Sqarim i grupit të auditimit: Paraqitja e dëshmisë së IQT nuk vërteton specializimin dhe administrimin e rrjeteve kompjuterike, për rrjedhojë "Vërejtja", nuk qëndron.

4.9. "Supervizim i mirëmbajtjes së rrugëve me bazë performancë për Drejtoritë e Rajoneve", me të dhënat e mëposhtme:

Të dhëna për procedurë e prokurimit	Njësia e prokurimit	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
A	B	C
Urdhër prokurimi: nr. 52, date 26.11.2015 Fondi limit: 162,947 mijë lekë, pa TVSH Data e zhvillimit të tenderit 28.09.2015 Procedura e prokurimit: Procedurë e hapur elektronike Vlera e kontratës: 162,892 mijë lekë pa TVSH Data e lidhjes së kontratës: 01.03.2016 operatori fitues: "GGG " sh.p.k. diferenca nga fondi limit 55 mijë lekë		

Auditimi i kësaj procedure u krye në këto drejtime:

a.Procedura e këtij propozimi ka filluar me shkresën e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 5728, datë 01.08.2015, drejtuar Drejtorit të Planifikimit të Buxhetit, me objekt; "*Për një kontroll të rreptë të punimeve të mirëmbajtjes, sipas sasive dhe cilësisë së kërkuar, është e domosdoshme mbikqyrja e këtyre punimeve me kompani kontraktore private, si dhe shkresën n*r. 8569, datë 16.10.2015 nënshkruar nga Drejtori i Standardeve, drejtuar Drejtorit të Planifikimit të Buxhetit, me të cilën kërkon planifikimin e fondit në buxhetin e vitit 2015, dhe në zbatim të projektbuxhetit afatmesëm të viteve 2015-2017 me objekt implementimin të projektit të inicuar me fondet e Bankës Botërore gjatë viteve 2013-2014 fillimisht në Qarkun Tiranë dhe Kukës. Kjo procedurë ka të bëjë me ndryshimin e metodës së punës, mënyrës së vlerësimit dhe të mbikëqyrjes së rrugëve nga metoda e tradicionale me bazë Drejtoritë Rajonale sipas 12 qarqeve në shkrirjen dhe shpërndarjen e tyre në 3 Drejtori Rajonale; respektivisht në Veri me qendër në Shkodër, Drejtoria Rajonale Qendër Tiranë dhe Jug me qendër Gjirokastër, si dhe kalimin e mbikëqyrjes në bazë performancë të shoqërive private të kontraktuara për mirëmbajtjen e rrugëve dhe akseve nacionale, sipas kontratave të lidhura me objekt "mirëmbajtje rutinë me bazë performance".

Procedura e prokurimit ka filluar me shkresën nr. 9269/1, datë 12.11.2015 me objekt "Ndryshim në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike dhe të prokurimit të fondeve buxhetore të shpenzimeve operative (602), nënshkruar nga Drejtori i Shërbimeve Brendshme , me të cilën kërkon fillimin e menjëhershëm të prokurimit sipas detajimit të fondit limit dhe termave të referencës të miratuara nga Titullari i ARrSh-së. Për vitin 2015 është parashikuar fondi prej 500 mijë lekë.

Sipas detajimit të buxhetit rezulton për vitin 2016 është parashikuar vlera prej 99,414 mijë lekë dhe për vitin 2017 është parashikuar vlera prej 63,120 mijë lekë.

Urdhri i prokurimit nr. 52, datë 26.11.2005 është nënshkruar nga drejtori i përgjithshëm me objekt "Supervizim i mirëmbajtjes së rrugëve me bazë performance për Drejtoritë e Rajoneve"**,** me vlerë 162,892 mijë lekë pa tvsh

Nga verifikimi i kryer në programimin e fondit limit për këtë procedurë konstatohet se:

-Në dosjen e tenderit dhe sipas termave të referencës është parashikuar supervizim i mirëmbajtjes rutinë me bazë performance të rrugëve nacionale dhe akseve rrugore për gjatësinë totale prej 3,796 km. Për verifikimin e saktësisë së hartimit të fondit limit u auditua gjithë sasia e kontratave të lidhura nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe tre Drejtoritë Rajonale, me objekt "Mirëmbajtje rutinë të akseve rrugorë" respektivisht Veri, Qendër dhe Jug, nga ku rezultoi se:

-Rajoni Qendror Tiranë ka lidhur 27 kontrata me gjatësi 907 km, me vlerë 1,453,962 mijë lekë;
-Rajoni Jugor Gjirokastër ka lidhur 32 kontrata gjatësi 1,461 km me vlerë 804,117 mijë lekë;
-Rajoni Verior ka lidhur 24 kontrata me gjatësi 1,419 km me vlerë 1,765,914 mijë lekë
Në total janë lidhur 83 kontrata me objekt "*Supervizimin e mirëmbajtjes rutinë të akseve rrugore me gjatësi 3,787 km me vlerë totale prej 4,223,993 mijë lekë*".
Nga të dhënat e dosjes së prokurimit dhe të fondit limit konstatohet se Autoriteti Kontraktor në zbatim të projektit pilot të Bankës Botërore për supervizimin e mirëmbajtjes rutinë të akseve rrugore nuk disponon të dhëna orientuese për koston supervizimit të kontratës me performancë mirëmbajtje rutinë, për çdo gjatësi aksi rrugor respektivisht akse rrugore malore dhe fushore sipas stinëve, dimërore dhe verore, me qëllim përcaktimin e fondit limit duke u bazuar në këto tarifa orientuese. Po kështu, edhe sipas VKM nr. 704, datë 29.10.2014, "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", nuk u gjenden tarifa të veçanta dhe orientuese për këtë kategori shërbimi, duke sjellë si pasojë fondi limit të përcaktohet duke marrë për bazë tarifat e kontratave të ngjashme të lidhura sipas programeve pilot të procedurave të Bankës Botërore.
Gjithashtu duhet theksuar se, nga Autoriteti Kontraktor nuk është kryer asnjë studim për të përcaktuar efektin ekonomik që do përfitohet nëpërmjet këtij varianti për të krahasuar shpenzimet e çdo kontrate supervizimi për mirëmbajtjen rutinë të akseve rrugore ku për çdo kontratë caktohej një supervizor dhe efekti që përfitohet nëpërmjet implementimit të projektit pilot të Bankës Botërore duke përqendruar gjithë mbikëqyrësit në një shoqëri të vetme për supervizimin e 83 kontratave të lidhura me objekt "*Supervizimin e mirëmbajtjes rutinë "*.
Në mungesë të tarifave të supervizimit për çdo mbikëqyrës, (gjatësi aksi dhe vlerë kontrate) Grupi i Auditimit e ka të pamundur llogaritjen e efektivitetit ekonomik të kësaj kontrate, për supervizimin e mirëmbajtjes rutinë të gjatësisë 3,796 km me vlerë totale 4,223,993,000 lekë.
Sipas termave të referencës, kontrata me objekt "Shërbimi i konsulencës për mbikëqyrjen e mirëmbajtjes së rrugëve me bazë performancë për 3 rajonet respektivisht; Rajoni Verior, Qendror dhe Jugor", do realizohet në zbatim të strategjisë së Qeverisë Shqiptare nëpërmjet Autoritet Rrugor Shqiptar (ARRSH) për arritjen e eficencës së menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor kombëtar nëpërmjet implementimit të kontratave bazuar në performancë. Kjo kontratë, ka për qëllim: "*Realizimin e përgjegjësisë private për të marrë në mbikëqyrje menaxhimin e aseteve rrugore në këmbim të pagesave fikse mujore, e cila është subjekt i zbritjeve që lidhen me dështimin për të përmbushur detyrimet e mirëmbajtjes së akseve rrugore*".
Nga auditimi i procedurës së kryer për përcaktimin e fondit limit u konstatua se, formulari për llogaritjen e fondit limit krahas nënshkrimit të personave përgjegjës për kryerjen e kësaj procedurë është nënshkruar edhe nga Drejtori i Përgjithshëm , veprim i cili kufizon përgjegjësinë në lidhje me ushtrimin e kompetencave të punonjësve para organit që i ka emëruar, pasi në nenin 4, pika 9 e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 është përcaktuar se "……punonjësit e administratës publike në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë. Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave, zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Po kështu sipas nenit 4, pika 20, Përgjegjësia e menaxherit (Drejtorit të Përgjithshëm) lidhet me ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se, ajo është kryer sipas parashikimit. Në rastin konkret duke u ndodhur para këtij fakti në zbatim të nenit 8 të ligjit të mësipërm drejtuesit e të gjitha niveleve të njësisë i japin llogari eprorit, sipas shkallës

hierarkike, dhe janë përgjegjës për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara nga titullari, duke menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomicitet, efektivitet dhe efiçencë.

Auditimi i kësaj procedure u krye në këto drejtime:
-Procedura për hartimin e fondit limit:
-Kriteret e vlerësimit
- Vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë.
-Lidhja dhe zbatimi i kontratës.
Për zhvillimin e kësaj procedure Autoriteti Kontraktor, ka hartuar termat e referencës dhe kriteret e vlerësimit ku është përcaktuar se tenderi do zhvillohet me dy faza, respektivisht:
1.Faza e parë: Parakualifikimi
2.Faza e dytë: Dorëzimi dhe vlerësimi i propozimeve, krahasimi i propozimeve dhe kriteret e vlerësimit, ku janë përcaktuar:
-Përvoja në punëve të ngjashme nga: 0-10 pikë;
-Metodologjia e propozuar nga: 20-50 pikë;
-Kualifikimi i stafit nga: 0-30 pikë;
-Transferimi i njohurive nga: 0-10 pikë.
Minimumi i pikëve për vlerësim dhe vazhdim të mëtejshëm është 70 pikë.
Vlerësimi sipas formulës Pe= 100 x Çu /Ç
Pe – Pikët e propozimit ekonomik;
Çu-çmimi më i ulët i ofruar;
Ç- çmimi ofertues i radhës, duke filluar nga çmimi më i ulët i ofruar.
Vlerësimi përfundimtar ;
-Pesha për propozimin teknik: X=(pikët e propozimit teknik x 0.8)
-Pesha për propozimin ekonomik Y= (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)
Oferta më e mirë = X + Y

Kapaciteti ekonomik dhe financiar
-Kopje të bilanceve të dy viteve të fundit;
-Deklaratë e xhiros vjetore të dy viteve të fundit, me vlerë mesatare jo më të vogël se fondi limit i kontratës që prokurohet.
Vendosja e kësaj kërkese është në kundërshtim me, ligjin nr. 6943, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" neni 1,2 dhe 20.
Kapaciteti teknik dhe profesional.
-licencat profesionale të shoqërisë dhe të stafit, fuqia punëtore (stafi) të jetë jo me pak se 25 punonjës, e vërtetuar me listë pagesat të konfirmuara nga Drejtoria e tatim-Taksave dhe formulari E-sig 25/a.

Mbi auditimin e kryer për përcaktimin e fondit limit.
Fondi limit sipas termave të referencës është parashikuar në vlerën prej 162,947,804 lekë pa tvsh me një afat 26 mujor me vlerë mesatare mujore prej 6,267,223 lekë/muaj.
Si kriter bazë për përcaktimin e fondit limit është marë për bazë performanca e ndjekur për mirëmbajtjen e dy kontratave pilot të zbatuara me fondet e Bankës Botërore për rajonin Tiranë dhe Kukës, duke marrë për bazë distancën e segmenteve dhe raportin inxhinier/gjatësi rruge.
-Në termat e referencës supervizimi prej 3,796 km gjatësi rrugore do të monitorohet dhe do mbikëqyret nga jo më pak se 25 inxhinierë, mesatarisht rreth 1 (mbikëqyrës) inxhinier për 100 km rrugë.

-Fondi i pagës për 25 inxhinierë është parashikuar në vlerën prej *124,880,000 lekë* për 26 muaj në të cilën janë përfshirë edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.
-Shpenzime zyre për 3 rajonet kancelari energji, etj në shumën prej *5,800,000 lekë*;
-Shpenzime, për automjete në pronësi apo me qira karburant dhe riparime në shumën prej *22,000,000 lekë (*me një mesatare prej 32,544 lekë/muaj)
-Shpenzime udhëtim e dieta për stafin inxhinier në terren në shumën prej *10,168,000 lekë* me një mesatare prej 391,100 lekë muaj.
Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet llogaritja e fondit limit duke marrë për bazë gjatësinë e akseve rrugore prej 3,796 km nga 83 operatorë ekonomikë me vlerë të kontraktuar në shumën prej 4,223,993,000 lekë.

Tabela nr. 1

Nr.	Emërtimi i zërave të shpenzimeve	Njësia	Sasia	Kohëzgjatja muaj	Vlera 000/lekë
1	Shpenzime (paga sig.shoq)	Lekë/muaj	25 (Ing)	26	124,880
2	Shpenzime zyre (qira,kanc)	Lekë/muaj	3 zyra rajonale	26	5,800
3	Automjete (qira,karburant,etj)	Lekë/muaj	20	24	22,100
4	Shpenzime udhëtim e dieta	Lekë muaj		26	10,168
	Totali				**162,948**
	TVSH 20 %				32,589
	Totali me tvsh				**195,537**

Fondi i pagës është llogaritur mesatarisht për 36 inxhinierë nga të cilat 14 inxhinierë me kohëzgjatje nga 3 deri 6 muaj (inxhinierë mjedisi, inxhinierë trafiku rrugor,topograf,etj) të cilët rekrutohen me kohë të pjesshme, dhe 22 inxhinierë për 26 muaj që është edhe kohëzgjatja e kontratës së supervizimit të mirëmbajtjes së akseve rrugore.
Nga auditimi mbi ligjshmërinë e përcaktimit të fondit limit konstatohet se, dy prej zërave të shpenzimeve respektivisht marrje automjete me qira dhe qira zyre në tre rajonet me vlerë totale prej 27,900 mijë lekë, në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014, janë llogaritur dhe shtuar padrejtësisht edhe me vlerën e TVSH në masën 20 %. Këto zëra përfaqësojnë shpenzime operative me kohëzgjatje mbi 1 vit, dhe sipas neneve 25 dhe 28 të ligjit të mësipërm janë zëra shpenzimi të përjashtuar nga TVSH. Si rrjedhojë e këtij veprimi fondi limit për pjesën e TVSH-së është rritur artificialisht për shumën prej *4,580,000 lekë***,** (27,900 x 20%), vlerë e cila nuk përbën dëm ekonomik por rritje artificiale të kostos së këtij shërbimit, pasi tvsh e arkëtuar kontabilizohet në kredi të llogarisë "Tatim-Taksa dhe derdhet në buxhetin e shtetit "Dega e Tatim Taksave".
Procedura e prokurimit është botuar në buletinin e APP nr. 49, datë 14.12.2015 me objekt "Shërbim konsulence" dhe procedurë "prokurim elektronik i hapur".
Pas publikimit të procedurës në buletinin e APP, 3 operatorë ekonomikë paraqesin ankesa për kriteret e vlerësimit e konkretisht:
-Shoqëria A.S", shoqëria "EK" dhe shoqëria "IT".
Ankesat e paraqitura nga këto shoqëri janë kryesisht për kriteret e vlerësimit që kanë të bëjnë kryerjen e shërbimeve të ngjashme, të cilat nga autoriteti Kontraktor janë përcaktuar jo më pak se 30 % të vlerës së përllogaritur të kontratës realizuar me sukses në tre vitet e fundit, dhe deklarata e xhiros të dy viteve të fundit jo më e vogël se fondi limit që prokurohet.
Këto kritere, nga operatorët ekonomikë konsiderohen të fryra artificialisht, pasi sipas ligjit "Për Prokurimin Publik" maksimumi duhej të ishte deri në 40 % e fondit limit që prokurohet dhe jo në masën 100 % të fondit limit.

Titullari i Autoritetit Kontraktor me urdhrin nr.10290/1, datë 15.12.2015 pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit me qëllim verifikimin e ankesave. Për këtë qëllim Titullari ka miratuar komisionin e shqyrtimit të ankesave.

Komisioni i ngritur nga titullari pasi ka shqyrtuar ankesat dhe pretendimet e paraqitura, ka vendosur që të ndryshojnë kriterin nga 100 % të xhiros të kontratës që prokurohet në 40 % të xhiros së realizuar dy vitet e fundit, ndërsa kriteret e tjera, konsiderohen të rregullta dhe nuk ndryshojnë nga ato të përcaktuara në kriteret e vlerësimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Komisioni i miratuar nga titullari në përfundim të shqyrtimit të ankesave njofton operatorët ekonomikë për marrjen në konsideratë të njërës prej tyre dhe mos marrjen në konsideratë të kërkesës tjetër si dhe ndryshimin e kritereve të vlerësimit për kërkesat që u morën në konsideratë.

Titullari i Autoritetit kontraktor me urdhrin nr. 52/1, datë 23.12.2015 miraton komisionin e prokurimit , si dhe datën 28.12.2015 ditën që do të zhvillohet tenderi.

b.Mbi përzgjedhjen e procedurës së prokurimit.

Titullari i autoritetit kontraktor në urdhrin e prokurimit nr. . 52, datë 26.11.2015, ka përcaktuar procedurën "Tender i hapur elektronik", kombëtar, ndërkohë që tenderi duhej të kryhej tender i hapur ndërkombëtar pasi fondi limit është përcaktuar sipas kritereve të programit pilot të Bankës Botërore.

c. Mbi zhvillimin e procedurës së tenderit

Tenderi zhvillohet në datën 28.12.2015. Sipas procesverbalit nr. 1, datë 28.12.2015 të hapjes dhe zhvillimit të tenderit, rezulton se kanë marrë pjesë në konkurrim 6 operatorë ekonomikë, respektivisht:

- Operatori Ekonomik "ZE";
- Operatori Ekonomik "TA";
- Operatori Ekonomik "NO"
- Operatori Ekonomik "GGG";
- Operatori Ekonomik "TO"
- Operatori Ekonomik "CO".

Nga verifikimi i kryer në faqen ëeb të Agjencisë së Prokurimit Publik për verifikimin e dokumentacionit në formatin elektronik të këtij tenderi u konstatua se, procedura elektronike e zhvillimit të këtij tenderi nuk ndodhej në arkivën e APP. Për rikthimin e saj në formatin elektronik, ndonëse u kërkua në mënyrë të vazhdueshme nga grupi i auditimit për rimarrjen e këtij informacioni së bashku me dokumentacionin elektronik të tenderit të zhvilluar, por deri në datën e mbajtjes së këtij akti konstatimi, nuk u bë e mundur verifikimi i dokumentacionit elektronik. Auditimi deri në këtë moment u krye vetëm mbi bazën e dokumentacionit fizik që administrohej në dosjen e prokurimit të këtij tenderi.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi:

Në fazën e parë është bërë vlerësimi me pikë i operatorëve ekonomikë.

Nga verifikimi i procedurës së vlerësimit u konstatua se kriteri "Transferimi i njohurive" nga 0-10 pikë është hequr dhe në mënyrë të padrejtë 10 pikët janë shpërndarë në tre kriteret e tjera, në kundërshtim me shtojcën nr. 9 "Kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit", të Dokumentave Standarde të Tenderit miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Në përfundim të kësaj faze, ***për mangësi dhe mosplotësim të kritereve të kualifikimit, janë skualifikuar:***

- Operatori Ekonomik "TO"
-Operatori Ekonomik "ZE";
- Operatori Ekonomik "NO"
- Operatori Ekonomik "TA";

Nga operatorët ekonomikë janë vlerësuar dhe kalojnë fazën e parë operatorët ekonomikë, respektivisht si më poshtë:

- Operatori Ekonomik "CO";
- Operatori Ekonomik "GGG";

Pas vlerësimit të dokumentacionit të operatorëve ekonomikë është bërë vlerësimi me pikë, në përfundim, është renditur në vend të parë operatori ekonomik "GGG" me 90,22 pikë dhe operatori ekonomik "CO" me 87.77 pikë;

Pas vlerësimit duke filluar nga pikët e grumbulluara dhe vlerës ekonomike të përcaktuar në ofertë, u shpall fitues operatori ekonomik "GGG" për vlerën prej 162,892 mijë lekë pa tvsh, me zërat e mëposhtëm:

Pas pritjes së afatit të ankimimit nuk rezultoi asnjë ankimim për rezultatin përfundimtar dhe shpalljen e fituesit.

Me shkresën nr. 9738/6, datë 25.02.2016 njoftohet operatori ekonomik për paraqitjen dhe lidhjen e kontratës

Njoftimi i fituesit bëhet në buletinin e APP nr. 8, datë 29.02.2016.

Me operatorin ekonomik fitues lidhet kontrata nr. 9738/7, datë 01.03.2016 me vlerë 162,892 mijë lekë, me afat 26 muaj nga dita e lidhjes së saj, por pa përcaktuar gjatësinë e akseve rrugore që do supervizohen nga shoqëria e shpallur fituese. Nga verifikimi i kryer në zërat e ofertës konstatohet se për zërat qira automjeti dhe qira zyre në shumën totale prej 12,891 mijë lekë është llogaritur dhe shtuar edhe TVSH në masën 20 % në vlerën prej 3,782,000 lekë. Kjo shtesë është në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014, datë 24.07.2014, pasi këto dy zëra janë shpenzime me afat mbi 1 vit, dhe sipas neneve 25 dhe 28 të ligjit të mësipërm janë zëra shpenzimi të përjashtuar nga TVSH, veprim i cili ka sjellë si pasojë rritjen artificiale të vlerës së kontratës e cila nuk përbën dëm ekonomik, pasi kjo shumë kontabilizohet dhe derdhet për llogari të Degës Tatim Taksave.

d.Mbi zbatimin e kontratës

Nga verifikimi i kryer për zbatimin e kontratës u konstatua se në Autoritetin Rrugor Shqiptar, janë lidhur 18 kontrata mirëmbajte rutinë të 680 km akse rrugore me vlerë 678,345 lekë, ndërsa në drejtoritë rajonale janë lidhur 65 kontrata me gjatësi rruge 3,116 km me vlerë 3,545,648 lekë.

Nga verifikimi i kryer në pagesat e bankës të ARRSH-së u konstatua se situacionet e paraqitura nga shoqëritë mirëmbajtëse të akseve rrugore, janë nënshkruar dhe miratuar nga shoqëria "GGG" sipas kushtet e përcaktuara në kontratat e mirëmbajtjes rutinë.

Për vitin 2016 janë likuiduar respektivisht çdo muaj sipas situacioneve të paraqitura nga operatori ekonomik fitues vlera prej 99,414 mijë, dhe diferenca e ngelur prej 58,478 mijë lekë do të likuidohet deri në mbarim të kontratës.

U shqyrtua observacioni i paraqitur nga njësia e prokurimit nr 5801/1, datë 14.07.2017 dhe sqarojmë se pretendimet e paraqitura, për ndryshimin e përqindjes së xhiros nga 100 % në 40 %, dhe ndryshimin në kriteret e vlerësimit për "Transferimin e njohurive" janë marrë në konsideratë dhe nuk trajtohen si mangësi.

4.11. "Ndërtim Ura e Matit" Burrel, me vlerë 210.101,083 lekë me TVSH, Kontratë nr. 4227/5, datës 22/10/2012, lidhur me JV "AA", e deklaruar e perfunduar me Akti i Kolaudim datë 31/08/2016.

Parregullsi të konstatuara:

Vlera **e situacionit të parë për Dhjetorin 2012 qe eshte 1,053,000 lekë** "për urën e vjeter" është shpenzuar nga fondet publike, drejtëpërdrejt përbën dëm ekonomik. (pasi është hequr dorë nga ky projekti), si edhe me nenin 6, të ligjit nr. 8402, datë 10/09/1998 "Për Kontrollin e disiplinimit të punimeve të Ndërtimit" (i ndryshuar), si edhe Kontratë nr. 4227/5, datës 22/10/2012, lidhur me JV "AA" (i ndryshuar).

Parashtrimet për të dhënë Argumentim.

Kontrata e sipermarrësit JV "AA",
4.11.1. Më datën 22/10/2012 është lidhur kontrata nr. 4227/5, ndërmjet ARRSH-së dhe JV "AA", me objekt sipërmarja e punimeve të ndërtimit në objektin "Ndërtim Ura e Matit" Burrel, me vlerën 210.101,083 lekë me TVSH, **me afat kohor 18 muaj**. (*projekti **ka për qëllim rikonstruksionin e Urës së Matit**, në Burrel, projekt zbatimi i cili është hartuar nga "A.V*"),
4.11.2. Më datën 24/04/2014 me nr. 2116/1 prot, është bërë shtesë kontrate **me objekt shtyrjen e afatit për 12 muaj, nga afati i kontratës** nr. 4227/5 duke parashikuar si afat përfundimtar datë 30/04/2015,
4.11.3. Më datën 24/07/2014 me nr. 5069 prot, është bërë Amendim i kontratës **me qëllim ndryshimin e porosisë.** (*duke modifikuar tërrësisht nga **Rikonstruksion i Urës së Matit** në ndërtim të një **Ure të R**e, paralele me ekzistusen që do të rikonstruktohej, në drejtim të rrjedhës së lumit me distanc aksiale ndërmjet tyre 14.95 m*),
4.11.4. Më datën 28/04/2015 me nr. 3609/1 prot, është bërë shtese kontrate **me objekt shtyrjen e afatit për 6 muaj,** duke parashikuar si afat përfundimtar datën 30/10/2015,
4.11.5. Më datën 29/10/2015 me nr. 8889/1 prot, është bërë shtese kontrate **me objekt shtyrjen e afatit për 2 muaj,** duke parashikuar si afat përfundimtar datën 30/12/2015,

Kontrata e mbikqyrësit "LE" & "IN".
4.11.6. Më datën 31/10/2012 është lidhur kontrata nr. 4228/5, ndërmjet ARRSH-së dhe JV *"LE- & "IN", (kjo e fundit pa nënshkruar),* me objekt *mbikqyrja e shërbimit të mirëmbajtjes* ne objektin : Mbikqyrja e punimeve në Ndertim Ura e Matit, Burrel, me afat kohor 18 muaj.

Projekti i zbatimi është hartuar nga "A.V.", në vitin 2010, kosto për këtë shërbim, e paguar nga ARRSH **është 2,972,600 lekë**. Qëllimi i projektit është rikonstruksioni i Urës së Matit, Burrel. ARRSH ka prokuruar këtë objektit më këtë qëllim, në vitin 2012 me fondin limit 210,101,083 lekë me TVSH .
Punimet për rikonstruksionin e Urës së Matit, kanë filluar më datën 05/11/2012 ref. Proces verbalit të fillimit të punimeve dhe aktit të dorezimit të sheshit e nënshkruar nga investitori, sipërmarrësi dhe mbikqyrësi.
Më datën 11/07/2014 është bërë Proces verbali mbi rifillimin e punimeve e nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikqyrësi, por jo nga Investitori (ARRSH).
Më datën 16/07/2014 është bërë Proces verbali i Piketimit të punimeve e nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikqyrësi, për ndërtimin e urës së re paralel me ekzistuesen.
Janë plotësuar 8 situacione për periudhat kohore të ndryshme i pari ne Dhjetor 2012 (1,000,350 leke), i dyti ne 27 Korrik 2014 (19,851,607 leke) …. i teti ne Shtator 2016 (3,183,660 leke), **vlera perfundimtare 209,132,071 leke.**
Më datën 31/08/2016 është mbajtur process-verbali mbi kolaudimin e punimeve me objekt "Ndërtim Ura e Matit" Burrel.

Vlera e projekti sipas kontratës 210,101,083 lekë me TVSH,
Vlera e situacionit përfundimtar 209,333,668 lekë me TVSH,

Mbi ndryshueshmërine e Projektit.

Në zbatim të këtij projekti janë bërë ndryshime thelbësore. Në fillim është hartuar projekti **për rikonstruksionin** e Urës së Matit Burrel dhe më pas gjatë ndërtimit është hequr dorë dhe është propozuar ndërtimi i një **Ure të Re** paralele.
Kjo situatë ka lindur pas kontraktimit të punimeve të ndërtimit, si edhe të mbikqyrjes, me ARRSH-në. Nëpërmjet korespondencave të shumta të mbikqyrësit dhe sipërmarrësit ARRSH ka mbledhur dhe diskutuar në Këshillin Teknik këtë c'është ref. proces-verbalit nr. 1, të datës 14/11/2013 dhe nr. 2 të datës 22/11/2013. Këshilli teknik ka marë vendim nr. 5, datë 16/01/2014 për modifikimin e projektit duke ndërtuar një ure të re.
Në këto mbledhje kanë qënë të pranishëm përveç anëtarëve të këshillit edhe sipërmarrësi, mbikqyrësi dhe projektuesi.
Gjithë situata e krijuar është sjellur rreth gjendjen ekzistuese mbi aftësine mbajtëse dhe me mënyrën e ndërtimit. Sepse trafiku ishte një nga problemet që pengonte punimet për tu zbatuar.

Përmbledhje e PV nr.1;
Projektuesi ka pohuar që në DPRR, ka sjellë variant për rikonstruksioni e urës së vjetër dhe ndërtimin e një ure të re, Këshilli Teknik ka miratuar variantit për rikonstruksion. Po në këtë mbledhje projektuesi është shprehur që ky projekt nuk mund të realizohet pasi trafiku është i rënduar (sepse gjatë rikonstruksionit nuk duhen të kalojnë makina dhe nuk duhet të ketë ngarkesa dinamike…), si edhe është shprehur që është i mendimit për urë të re, ky ka qënë edhe mendimi i mëparshëm, në fazën e miratimit të projektit.
Sipërmarrësi ka pohuar se derri më tani janë shpenzuar **1,053,000 lekë** për urën e vjeter. Kjo është vlera ***e situacionit të parë për Dhjetorin 2012***.
Nga AK është pohuar që ndryshimet mund të bëhen brenda kësaj kontrate.
Përmbledhje e PV nr.2;
Në mbledhjen e dytë projektuesi ka sjellur zgjidhje tjetër një kohësisht edhe mbikqyrësi, për ndërtim Urë të Re, gjatë bashkëbisedimit midis projektuesit, kontraktorit, mbikqyrësit në prani të Këshillit Teknik, kjo e fundit është shprehur që do të kthej përgjigje. *Gjatë kësaj mbledhje ka dalë edhe shqetësimi për të cilën është bërë pagesa për projektin dhe sipërmarrësi nuk e ka zhvilluar atë, ndërkohë që sipërmarrësi ka pohuar që mbikqyrësi dhe vetë kanë hartuar një zgjidhje dhe nuk mund të paguajnë projektuesin për këtë shërbim. Ndërkohë që projektuesi rishprehet që në momentin e miratimit kanë paraqitur tre variante dhe DRRSH është zgjedhur 1, atë të rikonstruksionit.*
Më datën 16/01/2014 Këshilli Teknik ka miratuar në parim, propozimin për ndërtimin e urës së re, brenda vlerës së kontratës së lidhur, si edhe është ngarkuar mbikqyrësi i punimeve të hartoj projektin e plotë të urës së re. Në këtë mbledhje kanë qënë të pranishem sipërmarrësi, mbikqyrësi dhe projektuesi.

Projekti i Hartuar nga Projektuesi ne vitin 2010 *"A.V"*
Ref. raportit "për rikonstruksionit të urës së matit", kjo urë është ndërtuar në vitn 1930, në 1995 janë bërë ndërhyrje për ta përforëcuar dhe ritur aftësinë mbajtëse për përballimin e ngarkesës N13 dhe T60.
Në teremat e referëncës është kërkuar që aftësisa mbajtëse e strukturës të arihet me ngarkesë N 18 dhe T 80. Gjendja e urës është e demtuar …. Lidhur me aftësinë mbajtëse "vërehet së mënyra e konstruimit të elementeve të ndryshëm mbajtës janë tërrësisht të papranueshme në konceptet e sotme të armimit" …. Në projekt është analizuar e gjithë struktura dhe është aritur në arsyetim, *"Që forma e re është si një guacke që mbështjell pjesët e vjetra dhe trarët e harkut të zëvendësohen me të rinj"*. C'ka do te thotë që në vetvete ura do bëhet nga e para, përfitimi i së cilës është vetem pamja arkitektonike.

- Autoriteti Kontraktues, që nga 2009 derri në 2016 me perdorimin e Termave "rikonstruksion dhe urë e re", nuk kane aritur të kuptonin që vete projekti për (rikonstruksioni) i cili është projektuar është një urë e re "ngjitur dhe nën urën e vjetër". Duke qënë që sipërmarrësi ka patur të vështirë zbatimit e punimeve në këtë mënyrë, si edhe vonesa në kohë të fondeve, kanë aritur të kalonin në një variant tjetër që e quajne urë të re, me distancë aksiale 10.95 m. Vlera e kontratës nuk ka ndryshuar. *Sipërmarrësi ka shpenzuar **1,053,000 lekë** për urën e vjeter e cila është vlera **e situacionit të parë për Dhjetorin 2012** këto punime janë braktisur. Këtë fakt e ka pohuar vetë sipermarrësi dhe të cilat janë të dokumentuara edhe të paguara nga AK.* Kjo situatë ka ardhur dhe pasi AK është në kundërshtim me ligjin nr. 8402, date 10/09/1998 "Për Kontrollin e disiplinimit të punimeve të Ndërtimit" (i ndryshua), me nenin 6, *"Oponenca teknike për projektet e ndërtimit qo të bëhet për të gjitha llojet e ndërtimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 miljon lekë ...."*. Në këtë procedure nuk gjendet asnjë dokumentacion i tille.
Vlera **e situacionit të parë për Dhjetorin 2012 qe eshte 1,053,000 lekë** "për urën e vjeter" është shpenzuar nga fondet publike, në keto kushte përbën **dëm ekonomik** ngarkohen me përgjegjësi; Sipërmarrësi i punimeve JV "AA" dhe mbikëqyrësin JV "LE" & "IN".

4.1.7. Komente të subjektit të audituar.
Mbikëqyrësi i punimeve JV "LE" & "IN" me shkresë nr. 5790, datë 13.7.2017 ka bërë sqarim se ... *punimet provizore të kryera si pastrim terreni, gërmim dhe transport dheu, ndërtim rrugë provizore dhe kthim në gjendjen e mëparshme etj, të situacionuara dhe të likuiduara në vitin 2012, i shërbejnë dhe kantjerit të ri,* i cili me argumentet e paraqitura hollësisht në akt konstatim dhe projektraport, nuk qëndron.

ARRSH në ""Observacionet" e paraqitura ka përfshirë dhe ato të BOE "JV "AA", të cilat përgjithësisht përsëriten të njëjtët argumente si ato të mbikëqyrësit të punimeve, por me shtesën që BOE e pranon se projekti i parë është i pazbatueshëm prej tij.
Pavarësisht sa më sipër, me argumentet e paraqitura hollësisht në akt konstatim dhe projektraport, "vërejtja" (sqarimi) i BOE "JV "AA" sh.p.k., nuk qëndron.

5. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar e kontrollit dhe vlerësimi i auditit të brendshëm.

Auditimi i Brendshëm është një veprimtari e pavarur që i jep siguri objektive dhe i ofron këshillim për menaxhimin e projektuar për të shtuar vlerën e për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit e të qeverisjes.

Auditi i kësaj pike të programit iu referua Ligjit Nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të lartë të shtetit"; Ligjit nr. 9720, dt. 23.04.2007, "Për auditin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 212, datë 30.03.2012, "Për miratimin e kritereve për ngritjen e Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik.", Manualit të Auditimit të Brendshëm të botuar nga Njësia e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik; Ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2012, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"INTOSAI GOV 9100 "Udhëzime për Standartet e Kontrollit të Brendshëm në Sektorin Publik".

Autoriteti Rrugor Shqiptar që prej miratimit të strukturës dhe organikës së tij me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 97, datë 7.2.2012, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Rrugor Shqiptar" nuk ka parashikuar strukturën e Auditit të Brendshëm. Mungesa e kësaj strukture është në kundërshtim me Ligjin nr. 9720, dt. 23.04.2007, "Për auditin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar, Kreu V, Neni 17, ku citohet se *"Të gjitha njësitë shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme duhet ose të krijojnë njësitë e auditit të brendshëm, ose të kenë audituesin e brendshëm ose të kontraktojnë shërbimin e auditimit."*
Referuar rastit, në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2012, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin". Kreu II, Neni 8, Përgjegjshmëria Menaxheriale, pika 8, germa "dh", në mënyrë eksplicite përcakton se është përgjegjësi e menaxherit të njësisë publike rregullimi dhe funksionimi i auditit të brendshëm dhe garantimi i pavarësisë funksionale të tij.
Kjo mangësi është evidentuar edhe më parë gjatë auditimit të kryer nga shoqëria "Ernst & Young Albania", përgjatë vitit 2015. Me shkresën nr. 6402/3, datë 30.09.2015, "Mbi zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të Auditimit të "Ernst Young Albania", janë përcjellë gjashtë rekomandime të profilit organizativ, midis tyre edhe krijimi i njësisë së Auditimit të Brendshëm Brenda datës 15.10.2015.

Nga ana e ARRSH, me shkresën nr 9267, datë 12.11.2015, është hartuar një relacion për projekt-VKM mbi disa ndryshime më vendimin nr. 97, datë 07.02.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Rrugor Shqiptar"; duke kërkuar të shtohet në strukturë njësia e Auditit të Brendshëm dhe Sektori i Financës të kaloj nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme në varësinë e Drejtorisë së Planifikimit të Buxhetit. Në këto kushte, ushtrimi i funksionit të nëpunësit zbatues nga drejtori i Shërbimeve të Brendshme konsiderohet në kundërshtim me udhëzimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

Ndryshimet në funksion të përmirësimit të performancës dhe organizimit të ARRSH, janë marrë në konsideratë jashtë afatit të vendosur nga rekomanduesi "Ernst & Young Albania". Me Vendimin nr. 12, datë 11.1.2017, Këshilli i Ministrave vendosi për disa ndryshime në Vendimin nr. 97, datë 7.2.2012, duke reflektuar ndryshimet e propozuara në Projekt-VKM e iniciuar në 12.11.2015.

Aktualisht, në njësinë e Auditit të Brendshëm është emëruar një specialist i transferuar nga pozicioni specialist në Sektorin e Planifikimit të Buxhetit në njësinë e AB.
Praktikisht kjo strukturë është jo funksionale; e justifikuar nga ARRSH me faktin e procedurave burokratike nga DAP për plotësimin e vendeve vakante në njësitë shpenzuese publike.
Me shkresën Nr. 1537, datë 9.3.2017, Departamenti i Administratës Publike ka emëruar z. Sami Gjeta, në pozicionin e specialistit në Sektorin e Auditimit të Brendshëm në Autoritetin Rrugor Shqiptar, kategoria e pagës IV-a.

Sipas organikës dhe strukturës së miratuar me VKM nr. 12, datë 11.1.2017, është përcaktuar se Sektori i Auditit të Brendshëm është i përbërë nga dy specialist dhe një përgjegjës sektori. Rrjedhimisht, sektori i AB me një specialist e ka të pamundur të ushtroj funksionet e parashikuara në Ligjin Nr. 9720, dt. 23.04.2007, "Për auditin e brendshëm në sektorin publik", neni 17, pika 1, ku përcaktohet se: "Njësia e auditit të brendshëm përbëhet nga

drejtuesi dhe nga audituesit e brendshëm, që i raporton drejtpërdrejtë titullarit të organizatës përkatëse".

Struktura e pa plotësuar dhe mungesa e përgjegjësit të sektorit shmang filtrin e kontrollit të cilësisë për vlerësimin dhe rishikimin e raporteve të auditimit.
Duhet të ndërmerren masa menjëhershme për plotësimin e strukturës së Auditit të Brendshëm, me qëllim përmbushjen e kërkesave ligjore.
Pagesa e specialistit në një strukturë jo funksionale, konsiderohet jo eficente.

Theksojmë se mungesa e njësisë së Auditit të Brendshëm ndikon negativisht në shqyrtimin e efektivitetit të proceseve dhe dhënien e rekomandimeve në funksion të suportit në vendimarrje dhe mirëqeverisje të institucionit. Funksionimi i kësaj njësie në kapacitet të plotë dhe në parametrat e përcaktuara në ligj, ka një ndikim pozitiv në rritjen e përgjegjshmërisë menaxheriale dhe proceseve operacionale të ARRSH. Gjithashtu, vlerësojmë të menjëhershme përditësimin e rregullores së institucionit me qëllim reflektimin e ndryshimeve në strukturë dhe organikë; hartimin e "Kartës së Auditimit", në respektim të Nenit 4, të Ligjit Nr. 114/2015, 'Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik".

Nisur nga gjetjet e këtij auditimi, për përmirësimin e gjendjes, janë dhënë rekomandimet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. *Gjetja nga auditimi.*
Në praktikën e ARRSH, në vazhdimësi, konstatohet se nisen punime për vepra, rrugë të reja, në mungesë të plotë të fondeve për realizimin/përfundimin e tyre.
Në këtë situatë, ARRSH ka lidhur kontrata dhe ka kryer/pranuar kolaudimin e punimeve, për disa nga zërat e punimeve të parashikuara në preventivin përfundimtar të objektit, ndërkohë që veprat/rrugët, nuk janë përfunduar (kryesisht janë kryer punime gërmimi dhe mbushje, por nuk janë realizuar shtresat asfaltime).
Në mungesë të fondeve për përfundimin e punimeve, objektet e *"kolauduara",* por të pa përfunduara, braktisen duke shkaktuar dëme ekonomike të parikuperueshme në zërat e punimeve për shtresat rrugore, duke rriskuar njëkohësisht sigurinë rrugore.
Aktualisht evidentohen disa kontrata të punëve publike të rëndësishme të filluar prej vitesh, të cilat janë të kolauduara por objektet nuk kanë përfunduar si "Librazhd - Qafë Stude, Loti 3", "Qafë Thanë - Lin Pogradec, Lot 2", "Rruga e Arbrit, dalje Ura e Vashës - Bulqizë, Lot 3", " Shtesë kontrate e rrugës së Arbrit, dalje Ura e Vashës - Bulqizë, Lot 3", "Rruga e Arbrit segmenti Ura e Brarit - Hyrja e Tunelit Qafë Murriz", "Rruga Kuçovë - Belsh - Cërrik" etj, me sinjalistikën dhe elementët e sigurisë rrugore, në të cilët nuk është marrë asnjë masë për përfundimin e tyre.

Për këtë rekomandojmë:
ARRSH në mungesë të fondeve të mos nisë procedura të reja prokurimi, por të përcaktojë prioritete dhe në funksion të tyre të gjejë fondet e nevojshme, për përfundimin e rrugëve sipas

projekteve fillestarë, me të gjithë elementët e nevojshëm për të shmangur dëmet ekonomike të parikuperueshme në zërat e punimeve dhe për të rritur sigurinë rrugore.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

2. *Gjetja nga auditimi.*
Në kontratën e zbatimit të tenderit me objekt *"Implementimi i sistemit të menaxhimit të trafikut",* me fond limit 53,667,299 lekë, i zhvilluar gjatë vitit 2015, sipas termave të referencës dhe preventivit ishte përcaktuar vendosja e sensorëve të detektimit të automjeteve në 17 akse rrugore kombëtare. Nga verifikimi i bërë në 4 pika (Vorë – Fushë Krujë, Vorë-Durrës, Rrogozhinë – Elbasan, Plepa – Rrogozhinë) ku ishin instaluar pajisjet dhe sensorët ne trup të rrugës, u konstatua se pajisjet ishin vendosur sipas specifikimeve teknike dhe sensorët funksiononin normalisht, duke bërë identifikimin e mjeteve që kalonin në rrugë.
Në kontratë është parashikuar që të gjitha pajisjet të kryejnë transferimin e të dhënave në kohë reale nga akset në një sistemin qendror, por nuk është parashikuar dhe vendosur furnizimi me internet në vendet ku janë instaluar sensorët. Ky fakt bën që të dhënat të merren manualisht në çdo aks dhe jo të kalojnë dhe përpunohen në kohë reale në sistemin qendror të ARRSH, ku administrohet programi kompjuterik për këtë qëllim.

Për këtë rekomandojmë:
Autoriteti Rrugor Shqiptar të marrë të gjithë masat e nevojshme për furnizimin me internet, përfshirë dhe pajisjet eventuale të nevojshme digjitale, me qëllim që të dhënat e trafikut të transferohen/përpunohen në kohë reale në sistemin qendror kompjuterik të instaluar në ARRSH.

Menjëherë

3. *Gjetja nga auditimi.*
Në preventivin e paraqitur nga projektuesi për objektin*"Plotësimi rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësim të sigurisë rrugore -vazhdimi, Loti 1"* Aksi Rrogozhinë-Kapshticë L=179.7 km, u konstatua se të paktën për 15 zëra punimesh të rinj me çmime njësi të larta si "Tabelë plotësuese 240x60 cm" me çmim njësi 60,250 lekë/copë, "Tabela te medha informative 200x150 cm" me çmim njësi 97,200 lekë/copë, "Tabela te medha informative 200x200cm" me çmim njësi 162,000 lekë/copë, *"Tabela te medha informative 250x250cm"* me çmim njësi 202,499 lekë/copë, "Vijëzim shirita gjatësor me gjerësi 15 cm i ndërprerë Termoplastike (spray)" me çmim njësi 200 lekë/ml, "F.V Konstruksion Metalik i Zinguar Flamur" me çmim njësi 900,000 lekë/copë, "Amortizator goditje" me çmim njësi 2,800,000 lekë/copë, "F.v tregues plastik" me çmim njësi 350,000 lekë/copë, "F. Bashkuese me gomë për lidhje cepat e urave (400 mm)" me çmim njësi 110,000 lekë/ml, "F.Bashkuese me gomë për lidhje cepat e urave (600 mm)" me çmim njësi 160,000 lekë/ml, "F.v Pulsant tek me Panel Diellor" me çmim njësi 73,500 lekë/copë etj, nuk janë paraqitur referenca të qarta në lidhje me çmimet e materialeve të analizës së çmimit, të cilat shërbejnë si bazë për llogaritjen e fondit limit.

Për këtë rekomandojmë:
Autoriteti Rrugor Shqiptar të dërgojë në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, analizat e çmimeve për të gjithë zërat e punimeve të rinj të hasur në praktikë, përfshirë dhe ata të cilët janë trajtuar hollësisht në këtë projektraport, për të bërë rivlerësim/konfirmim/saktësim të tyre nga organi i specializuar, në zbatim të kërkesave të përcaktuara në VKM Nr. 514 date 15.8.2007 "*Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit*".

Sektori i projekteve dhe preventivëve në Autoritetin Rrugor Shqiptar, për të gjithë preventivët e përgatitur nga projektues të jashtëm dhe të brendshëm, të bëj verifikimin e plotë të analizës së çmimeve të zërave të punimeve që nuk ndodhen në manual, nëse ato janë në përputhje me formatin e analizës së manualit të çmimeve në fuqi. Për zërat e punimeve të cilët nuk ndodhen në manual, megjithëse projektuesit kanë paraqitur çmimet njësi sipas arsyetimit të tyre, Sektori i Projekt preventivave në ARRSH, të marrë në konsideratë çmimet njësi që rezultojnë më të ultë, nga krahasimi i tyre me çmimet të zërave të punimeve, të cilët ndodhen në preventivët e kontratave të ngjashme të realizuara më parë në ARRSH tri vitet e fundit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

4. *Gjetja nga auditimi.*
Në DST të objektit "Implementimi i sistemit të menaxhimit të trafikut", është kërkuar nga ofertuesit që të paraqesin një vërtetim nga Autoriteti Rrugor Shqiptar, nëpërmjet të cilit të konfirmohet nëse OE pjesëmarrës *është fitues dhe/apo ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nënkontraktor, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura në proces për t'u lidhur, sipas LPP, në çastin e hapjes se ofertave*, i ka përfunduar punimet fizike në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës.
ARRSH, për operatorin ekonomik "MA" sh.p.k ka lëshuar një referencë punimesh në të cilën është specifikuar se shoqëria "MA" sh.p.k në bashkëpunim me tre OE të tjerë, po kryen zbatimin e kontratës të objektit "Ndërtim Rruga Unaza e Re e Tiranës, segmenti Komuna e Parisit – Shkolla Teknologjike" me vlerë 689,180,547 lekë më TVSH, realizimi i të cilës deri datën e zhvillimit të tenderit është rreth 49 për qind.
Nga ky vërtetim konstatohet qartë se OE pjesë e Bashkimit të operatorëve ekonomikë, nuk e përmbush kriterin e DST, pra që të ketë përfunduar punimet fizike në masën 70% të kontratës, në zbatim me nenin 26 të VKM Nr. 914 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar.

Për këtë rekomandojmë:
Autoriteti Rrugor Shqiptar në vërtetimet që lëshon për operatorët ekonomikë të cilët nuk kanë realizuar 70 për qind të punimeve fizike të kontratave të mëparshme, të saktësojë në momentin e lëshimit të tyre, nëse për këto vërtetime, nuk zbatohet kushti i plotësimit të punimeve në masën 70 për qind, në përputhje me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014" i ndryshuar.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

5. *Gjetja nga auditimi.*
Gjatë periudhës objekt auditimi nuk janë hartuar pasqyrat financiare të konsoliduara për Autoritetin Rrugor Shqiptar, por në çdo vit ushtrimor janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, të ndara pasqyrat financiare individuale të ARRSH dhe për Drejtoritë Rajonale, në kundërshtim me pikën 5, kapitulli I të *"UMF nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre si dhe njësive të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj", i ndryshuar,* në të cilin është përcaktuar se .... *Ministritë dhe Institucionet e tjera Qendrore , përveç pasqyrave financiare individuale, hartojnë përmbledhësen e Pasqyrave Financiare vjetore 2006 për të gjitha institucionet e vartësisë së tyre dhe e depozitojnë atë në Drejtorinë e Kontabilitetit në Ministrinë e Financave brenda datës 20 Prill 2007.*

Për këtë rekomandojmë:

ARRSH të marrë masat e nevojshme për të pasqyruar në kontabilitet dhe në bilancin kontabël përmbledhës të vitit 2017 gjatësinë e akseve rrugore konform përcaktimeve të "Kodit Rrugor" në programin "Web Gis", në mënyrë të hollësishme të paraqesë gjatësinë dhe vlerën respektive të çdo aksi rrugor, me qëllim që ARRSH të disponojë të dhëna për koston e 1 km rrugë sipas kategorive të mësipërme. Këto të dhëna duhet të konsiderohen jo vetëm si tregues i rëndësishëm për programimin e shpenzimeve të institucionit, por lidhen edhe me për përmbushjen e objektivit të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", përgjegjësitë menaxheriale dhe të strukturave administrative për planifikimin, zbatimin, kontrollin e shpenzimeve të fondeve publike për hartimin e projektit, preventivit dhe të fondit limit për projektime, ndërtime apo supervizime sipas kontratave të lidhura me bazë performance të mirëmbajtjes rutinë të akseve rrugore.

Menjëherë

6. *Gjetja nga auditimi.*
ARRSH për periudhë objekt auditimi nuk ka kryer veprimet kontabile për mbylljen e llogarisë 202 dhe 231, respektivisht për vlerat prej 206,814,512 mijë lekë dhe 697,368 mijë lekë në debi të llogarisë 213 me qëllim pasqyrimin e vlerës totale të aktiveve në programin "Web Gis" sipas kategorive të përcaktuara në "Kodin Rrugor", mangësi e cila ka ardhur si rrjedhojë e mosmiratimit të inventarit të segmenteve rrugore nga MTI.

Për këtë rekomandojmë:
Marrjen e masave për miratimin e inventarit të akseve rrugore nga MTI, me qëllim mbylljen e llogarive 202 dhe 231 në shumuar respektivisht prej 697,368 mijë lekë dhe 206,814,512 mijë lekë, në debi të llogarisë 213, "*Rrugë dhe rrjete rrugore*" të përfunduara dhe të kolauduara.

Menjëherë

7. *Gjetja nga auditimi.*
Për periudhën objekt auditimi janë lidhur 83 kontrata gjithsej, me objekt "Mirëmbajtje rutinë dhe dimërore me performancë" me gjatësi 3,796 km. Nga verifikimi i kryer në zërat e punimeve të paraqitura në situacionet e mirëmbajtjes së akseve rrugore konstatohen se disa prej zërave kryesorë janë të pamatshëm, pasi njësia e matjes së tyre (volumet e punës) janë përcaktuar me njësinë "muaj" dhe jo me volumin e punimeve m^3, m^2, ose metër linear. Kjo mënyrë matje, nuk pasqyron realisht volumin e punës së kryer por krijon mundësi për përfitim të padrejtë nga shoqëritë kontraktuese. Në vlerën prej rreth 4,200,000 mijë lekë gjithsej të këtyre kontratave, rreth 25 % të saj e zenë kontratat me volume të pamatshme.

Për këtë rekomandojmë:
ARRSH të marrë masat e nevojshme prej momentit të lidhjes së kontratës, që në çdo rast ato të lidhen me zëra punimi të pamatshëm, në zbatim të VKM Nr. 723, datë 22.11.2006 " Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", kapitulli "Standardet dhe rregullat kontabël" pika 2.2 "Rregullat e përgatitjes së dokumentave justifikuese, në të cilat të përshkruhet qartë të dhënat lidhur me emërtimin e saktë për shërbimet që do të kryhen, sasitë e faturuara dhe çmimin e faturimit për njësi.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

Dëm ekonomik i shkaktuar është **202,536,373 lekë** gjithsej, nga i cili:

B.I. I arkëtueshëm 41,025,862 lekë, për të cilin kërkohet të kontabilizohet dhe të ndiqet në rrugë ligjore arkëtimi i tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, si më poshtë:

1. Operatorit ekonomik "VV" sh.p.k. vlerën **25,520,880 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e përfituar për punime të pakryera, në tenderin me objekt objekt "*Sistemim asfaltim rruga Librazhd - Qafë Stude, Loti 3*" (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 61-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2. Bashkimit të operatorëve ekonomikë "AG" sh.p.k & "HA" sh.p.k vlerën **6,711,032 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e përfituar për punime të pakryera, në tenderin me objekt *"Ndërtim i rrugës Lushnje -Berat, Loti 3"* (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 64-69 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3. Operatorit ekonomik "GP" sh.p.k. vlerën ***3,391,526* lekë**, e cila përfaqëson vlerën e përfituar për punime të pakryera, në tenderin me objekt *"Ndërtim i segmentit rrugor Lushnjë-Berat, Lot 2"* (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 57-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4. Operatorit ekonomik "IT" sh.p.k. vlerën **2,100,000 lekë,** e cila përfaqëson pagesën e bërë nga ARRSH, operatorit ekonomik "IT" sh.p.k. në cilësinë e Kontraktorit në tenderin me objekt "Studim fizibiliteti i aksit rrugor "Skrapar-Përmet-Korçë", për një zë pune/shërbimi me emërtimin "Matje trafiku në terren" me vlerën prej 2,100,000 lekë, për të cilin mungon njësia e matjes, sasi dhe çmimin për njësi. Dokument bazë për likuidimin e këtij shërbimi ka shërbyer oferta e fituesit të tenderit dhe jo situacioni për punën/shërbimin e kryer në fakt, në kundërshtim me VKM nr. 783, datë 22.11.2006 " Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", kapitulli "Standardet dhe rregullat kontabël" (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 21-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5. Bashkimit të operatorëve ekonomik "RRR" sh.p.k. vlerën **1,483,302 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e për punime të parashikuara në preventiv, por të pakryera, në tenderin me objekt objekt "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" "Shtesë kontrate" me fond limit 173,498,482 lekë, i zhvilluar në vitin 2016.
Në preventivin e ripunuar të kontratës bazë, në pjesën e dytë me emërtim "Ura e Sulovës" në zërin "punime të ndryshme" është parashikuar zëri i punimeve "*prishje struktura ekzistuese prej betoni*" me vlerë 1,483,302 lekë (njëlloj si në kontratën bazë të pa ripunuar), e cila sipas mbikëqyrësit të punimeve dhe specialistit të ARSH që ndjek realizimin e kontratës, ende nuk është kryer.
Parashikimi i zërit të punimeve për prishjeve të *"strukturave të betonit ekzistuese*", e në vijim likuidimi tyre, ndërkohë që do të ndërtohet një urë e re në një aks tjetër rrugor, është i gabuar (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 30, 33-35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6. BOE "AL" sh.p.k. sh.p.k. dhe mbikëqyrësit të punimeve subjektit ***"LE" & "IN"*** vlerën **1,053,000 lekë**, ose nga 526,500 lekë/seicili, e cila përfaqëson vlerën e punimeve të kryera/shpenzuara për objektin "Rikonstruksioni i Urës së Matit".
Midis ARRSH në cilësinë e investitorit dhe JV "AA" sh.p.k. në cilësinë e kontraktorit, është lidhur kontrata nr. 4227/5, datë 22/10/2012 me objekt "Ndërtim Ura e Matit" Burrel, me vlerën 210.101,083 lekë.
Për efekt të zbatimit të kësaj kontrate janë kryer punime me vlerë 1,053,000 lekë.

Në vijim, është bërë amendim i kontratës, është ndryshuar, *modifikuar tërësisht, nga rikonstruksion i objektit "Ndërtim i Urës" së Matit në ndërtimin e një Ure të Re, paralel me ekzistuesen që do të rikonstruktohej sipas projektit të mëparshëm, por me të njëjtën kosto.*
Në këtë situatë, kryerja e shpenzimeve prej 1,053,000 lekë, për efekt të projektit të mëparshëm, për rikonstruksionin e objektit "*Ndërtim Ura e Matit*" Burrel, i cili u braktis, përbën dëm ekonomik (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 84-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7. Bashkimit të operatorëve ekonomikë **"GJ" sh.p.k. & "AR"** sh.p.k **vlerën 766,122 lekë e cila përfaqëson vlerën e punimeve të pakryera në tenderin me objekt "**"Ndërtim Kanali i Cukës-Butrint , Lot I" (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

B.II. Dëm ekonomik, pa mundësi arkëtimi në vlerën 161,510,511 lekë, nga i cili:

B.II.1. Vlera *144,309,026 lekë,* në procedurën e e tenderit me objekt "*Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" "Shtesë kontrate"* me fond limit 173,498,482 lekë, i zhvilluar në vitin 2016 , për të cilin është lidhur shtesë kontrate nr. 7244, datë 14.9.2016 me Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë (BOE) "RRR" sh.p.k.
ARRSH në vitin 2015 ka zhvilluar tenderin me objekt "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan – Banjë loti 3" me fond limit 980,844,927 lekë. Tenderi është fituar nga Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë (BOE) "RRR" sh.p.k. me fond limit 949,840,681 lekë.
Në preventivin e objektit të paraqitur nga BOE fitues, në kapitullin e II është përcaktuar kryerja e punimeve me emërtim *"Zgjerimi i urës së Sulovës"* me fond limit 118,348,975 lekë.
Në vijim, në zbatim të vendimit të Këshillit Teknik të ARRSH nr. 47, datë 8.7.2016 janë hartuar "preventivi i ripunuar" i kontratës bazë të projektit "Riveshje dhe sistemim asfaltim rruga Elbasan - Banjë loti 3" me fond limit 949,840,681 lekë (i njëjtë me fondin limit të fituar në tender) dhe preventivi "Shtesë punime" për nën objektin me emërtim "Ura e Sulovës", me fond limit 173,498,900 lekë.
Me këtë vendim/veprim Këshilli Teknik i ARRSH, nuk ka zbatuar projektin fillestar, sipas të cilit është parashikuar që zgjerimi i "urës" së Sulovës, të punojë si urë më vete i pavarur nga ura ekzistuese, por ka pranuar/ndryshuar/cenuar thelbësisht projektin fillestar, duke parashikuar/ndërtuar, në një aks të ri rrugor, *një urë të re në Sulovë, me dy korsi* ... e shoqëruar me dëm 144,309,026 lekë në buxhetin e ARRSH (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 26-33 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

B.II.2. Vlera 9,892,114 lekë, në tenderin me objekt "Ndërtim Kanali i Cukës-Butrint , Lot I".
B.II.3. Vlera 7,309,371 lekë në tenderin me objekt "*Ndërtim i segmentit rrugor Lushnjë-Berat, Lot 2".*

Vlera *17,201,485 lekë* gjithsej për të dy rastet, përfaqëson penalitetet e pa llogaritura dhe vendosura nga ARRSH, operatorëve ekonomikë, për shkak të vonesave/shtyrjeve në dorëzimin e punimeve brenda afatit të përcaktuar në kontratën lidhur midis palëve *"(trajtuar më hollësisht në faqen nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

C. MBI PËRDORIMIN PA EFEKTIVITET, EFICENSË DHE EKONOMICITET TË FONDEVE PUBLIKE

ARRSH në vitin 2016 ka zhvilluar tenderin "Shërbim konsulence" me objekt "*Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e korridorit Veri Jug dhe lidhja me qytetin"* me vlerë 106,409 mijë lekë, në të cilin është shpallur fitues OE "GGG" sh.p.k. me të njëjtën vlerë.
ARRSH ka kryer më parë një studim projektim për të njëjtin qëllim, i cili prej vitit 2011 është në proces zbatimi, për të cilin vlera e kontraktuar është 1,902,021 mijë lekë, kurse vlera e likuiduar 734,821 mijë lekë, ose rreth 39 për qind e vlerës së kontraktuar.
Në këtë situatë, pra kur prej vitit 2011 po zbatohet/ndërtohet "By Pass perëndimor, Shkodër", i cili ka objekt/qëllim të njëjtë me tenderin me emërtim "Studim Projektim plotësim By Pass Shkodër si pjesë e korridorit Veri Jug dhe *lidhja me qytetin*", të realizuar në vitin 2016, kryerja e këtij "Studim projektim ..." në vitin 2016, qëllimi i tij, rezulton me mbivendosje, për rrjedhojë dhe studimi/ investimi i ri rezulton i panevojshëm.
Nën këtë arsyetim fondi limit prej 88,674 mijë lekë përbën shpenzim pa efektivitet dhe eficencë për institucionin (*trajtuar më hollësisht në faqen nr. 35-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Tabela e Shkurtimeve

Nr.	Shkurtimi	Emërtimi i Plotë
1.	KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
2.	ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
3.	AK	Autoriteti kontraktor
4.	KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
5.	KT	Këshilli Teknik
6.	VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
7.	INSTAT	Instituti i Statistikës
8.	DST	Dokumente Standarde të Tenderit
9.	APP	Agjencia e Prokurimit Publik
10.	Njësia e prokurimit	NJ. P
11.	LPP	Legjislacioni i Prokurimit Publik
12.	OE	Operator ekonomik
13.	BOE	Bashkim i operatorëve ekonomikë
14.	KVK	Kriteret e Veçanta të Kualifikimit
15	Sh.p.k.	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar